

**“IMPAKTI I BASHKIMIT EVROPIAN DHE ORGANIZATAVE
TË TJERA NDËRKOMBËTARE PËR PËRSOSJEN E
SHTETNDËRTIMIT DHE DEMOKRATIZIMIT TË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Irna Dobi (Peshkëpia)

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Juridike, me profil “E drejtë Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Numri i fjalëve: 52.589

Tiranë, korrik 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Me përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar nga unë, përveç materialeve të cituara dhe të referuara sipas udhëzimeve të Universitetit European të Tiranës.

Gjithashtu, ky punim nuk është prezantuar asnjëherë për vlerësim në institucione të tjera.

Firma. Irna Dobi (Peshkëpia)

E drejta e autorit 2016. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit

ABSTRAKTI

Ndryshimet që ndodhën në Evropë, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ristrukturimi i modelit të organizimit politiko-shtetëror të shteteve të dala nga regjimet diktatoriale në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, sollën nevojën e organizatave ndërkombëtare në këtë shtet-ndërtim të tyre. Shqipëria, shteti më i izoluar për gati 45-vjet diktaturë komuniste do të përballej që në fillimet e saj me ristrukturimin e organizimit politiko-shtetëror të sistemit demokratik.

Analiza e studimit doktoral do të fokusohet përdyshim mbi bazën e disa teorive analitike dhe krahasimore që dalin nga studime të shumta që argumentojnë impaktin që ka politika evropiane në politikën stabilizuese të vendit tonë, ku shumë studiues janë të shqetësuar për nivelin e zhvillimeve evropiane në shtetet aspirante. Debatet akademike sot përballen me një numër të madh studimesh në mënyrë eksplicite, duke shprehur shqetësimin e procesit evropianizues në institucionet e brendshme e duke paraqitur në këtë mënyrë mungesën konsistente nëpërmjet politikave të brendshme dhe kushtëzimeve evropiane.

Qëllimi i këtij studimi është të provojë më shumë struktura kompetitive duke argumentuar impaktin evropian në politikëbërjen e brendshme të vendit. Duke argumentuar, nëpërmjet një analize analitike, mekanizmat evropianizues siç janë: përfaqësja institucionale, strukturat e brendshme dhe oportunitetet për ndryshimin e tyre, ku secila prej tyre kërkon një përfaqëse dalluese, me qëllim që të argumentoj impaktin e brendshëm.

Studimi ka një metodologji sasiore dhe cilësore, analitike dhe krahasues për të konkluduar me analiza, të cilat pasqyrojnë impaktin që kanë strukturat evropiane në përsosjen e shtet-ndërtimit të vendit, duke bërë të mundur nëpërmjet mekanizmave nxitëse që Bashkimi Evropian të promovojë tek shtetet që kërkojnë të arrijnë një sistem demokratizimi institucional e në nivel evropianizues.

Analizat, gjatë këtij studimi, janë mbështetur në rezultate të dala nga studime, si edhe nga vëzhgimi individual i bërë nga literatura përkatëse e nga takimet me ekspertë të fushës së organizatave ndërkombëtare dhe të institucioneve shqiptare.

Rëndësia e këtij studimi qëndron tek impakti që kanë organizmat ndërkombëtare në nxitjen e kriterëve për të arritur suksesin e duhur, sikurse dhe risinë që sjell modeli institucional kroat për të arritur një administratë suksesi dhe një qeverisje të mirë në Shqipëri.

Fjalët kyçe: shtetndërtim, evropianizim, demokratizim, integrim, institucione, Organizata Ndërkombëtare.

ABSTRACT

Changes that occurred in Europe after the Cold War ended and the restructuring of the model of state political organization of countries emerging from dictatorial regimes in the countries of Central and Eastern Europe, raised the need for international organizations in their state-building. Albania, the most isolated country for nearly 45- years of communist dictatorship would face in its early restructuring of state-political organization of the democratic system. Study Analysis doctoral will focus obviously on several objectives analytical and comparative emerging from studies to multiple that argue the impact of EU policies on stabilizing policy of our country, while many researchers are concerned about the level of European developments in the aspirant countries. Academic debates today crosscating a large number of studies explicitly expressing concern about the European integration process in the domestic institutions representing in this way as lack consistent through internal policies and European constraints The purpose of this study is to prove more competitive structures arguing the European impact on domestic policy making in the country. Arguing through an analytical analysis mechanisms such as European integration, institutional approach, internal structures and opportunities to change them, each of which requires a distinct approach argue that the domestic impact.

The research methodology is quantitative and qualitative, analytical and comparative analysis to conclude with the impact that the European structures, enhancing the country's state-building enabling mechanisms through which the European Union promotes incentive to states that want to reach an institutional democratization in europeanization level. Analyses during the study are support the results derived from studies and from the individual survey of the relevant literature made of as well as meetings with experts in the field of international organizations and Albanian institutions.

The importance of this study lies in the impact that international organizations in promoting the criteria to achieve the necessary success and innovation as it brings the Croatian institutional model to achieve a successful reform in public administration and good governance in Albanian institutions.

Keywords: State-Building; Europeanisation, democratization; integration, Institutions; International Organizations;

DEDIKIMI

Me shumë mirënjohje, për prindërit e mi, bashkëshortin tim, për mbështetjen dhe kurajon që më kanë dhënë në këto vite, por ky studim në veçanti i dedikohet vajzës sime Evelin, e cila më dha forcën e madhe që të kontribuoj që vendi i saj nesër të jetë një vend edhe më i mirë.

FALËNDERIME

Falënderime të veçanta për bashkëpunimin, mbështetjen dhe sugjerimet profesionale të pakursyera gjatë rrugëtimit tim në të gjitha hapat e këtij punimi i takojnë udhëheqësit tim shkencor, Prof. dr. Ksenofon Krisafi.

Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët orientues që nëpërmjet këshillave të tyre bënë të mundur të më orientonin në këtë studim që nga stafet e organizatave ndërkombëtare si: OSCE, BE ku takimet me Znj. Ambasadore të Bashkimit European në Tiranë R.V. dhe Head of Mission i OSCE si edhe kolegë ekspertë të administratës publike shtetërore shqiptare më dhanë mundësinë të bëhej i mundur ky hulumtim.

Falënderim i veçantë i takon prindërve të mi e në veçanti babait tim, prof. Valier Peshkëpia, i cili ishte modeli dhe inkurajuesi i realizimit të rrugës sime shkencore.

Gjithashtu, falënderoj bashkëshortin dhe vajzën time për mirëkuptimin e tyre gjatë kohës së munguar.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë.....	2
Abstrakt.....	3
Dedikim.....	5
Falënderime.....	6

KAPITULLI I. HYRJA DHE BAZIMI TEORIK

1.1 Hyrje	13
1.2 Qëllimi dhe Objektivat e studimit.....	15
1.3 Rëndësia e studimit	17
1.4 Pyetje dhe Hipotezat kërkimore.....	19
1.5 Metodologjia dhe Metodat.....	20
1.5.1 Variablat e studimit.....	22
1.5.2 Kampioni dhe instrumentet e studimit	23
1.5.3 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave.....	24
1.5.4 Pjesa operative dhe konsiderime etike te studimit	25
1.6 Kufizimet e studimit.....	26
1.7 Përmbledhja dhe Përmbajtja.....	26

KAPITULLI II. TEORITË KRYESORE TË SHETENDËRTIMIT, KORNIZA TEORIKE

2.1	Analizat teorike mbi konceptin e shtet-ndërtimit.....	28
2.2	Rëndësia e shtet- formimit dhe impakti ndërkombëtar në këtë proces.....	30
2.2.1	Modelet e shtetndërtimit.....	31
2.2.2	Shtetndërtime të suksesshme.....	31
2.2.3	Modele të dështuara të shtetndërtimit.....	32
2.2.4	Përfaqset suplementare	34
2.3	Përpyqjet për të arritur një demokraci të mirë.....	36

KAPITULLI III. IMPAKTI ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE UNIVERSALE E RAJONALE NË PËRSOSJEN E DEMOKRATIZIMIT.

3.1	Vështrim i shkurtër mbi institucionet ndërkombëtare universale.....	43
3.2	Besueshmëria dhe personaliteti i organizatave ndërkombëtare.....	45
3.3	Tipologjia e organizatave universale.....	48
3.3.1	Rëndësia e politikave globale të Kombeve të Bashkuara (OKB) në përsosjen e demokratizimit të shteteve.....	49
3.3.2	Mekanizmat demokratizues të organizatës së Atlantikut të Veriut (NATOS).....	53
3.4	Tipologjia e institucioneve rajonale.....	56
3.4.1	Bashkimi Evropian operon si model suksesi.....	57
3.4.2	Këshilli Evropës.....	61
3.4.3	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSCE).....	62

KAPITULLI IV. IMPAKTI I MEKANIZMAVE EVROPIANE PËR PËRSOSJEN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE SHQIPËTARE.

4.1 Rëndësia e modelit evropianizues përtej BE-së.....	64
4.2.Mekanizmat e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë Evropiane.....	72
4.2.1 Mekanizmat Evropian për një demokratizim të institucioneve publike shqiptare.....	76
4.3 Qasja Evropiane mbi cilësinë e institucioneve publike	79
4.3.1 Rezultatet e modelit Evropian mbi “Qeverisjen e mirë Institucionale” të matura në Institucionet publike të Republikës së Shqipërisë.....	86
4.4 Rëndësia e Statusit Kandidat: arsyet e vonës së shtetit Shqipëtar.....	92
4.5 Efikasiteti dhe Performanca e Strukturave Kordinuese për procesin e Integritimit Evropian në Republikën e Shqipërisë	98
4.5.1 Rezultatet mbi monitorimin e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian (KKIE).....	99
4.5.2 Rezultatet e monitorimit të strukturave koordinuese të procesit të integritimit evropian: MIE, KNIE, KKNIE DHE GNP-ve.....	106

KAPITULLI V. RAST STUDIMI: NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE SHQIPTARE, KRAHASUAR ME MODELIN KROAT, NJË MODEL SUKSESI DREJT STRUKTURAVE EVROPIANIZUESE.

5.1 Vlerësimi i përgjithshëm i ndihmës ekonomike të institucioneve ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve institucionale.....117

5.2 Instrumentet kushtëzuese dhe fazat e një transformimi kompleks në Shqipëri.....120

5.3 Kushtëzimet evropiane për administratën publike shqiptare.....126

5.3.1 Rezultatet e vlerësimit sasior e cilësor nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbi procesin e reformave e kushtëzimeve në administratën publike shqiptare.....129

5.3.2 Përpunimi i të dhënave sasiore dhe cilësore mbi standardizimin e ekspertizës profesionale në institucionet publike shqiptare.....147

5.4 Tranzicioni i institucioneve kroate drejt përsosjes në strukturat evropianizuese.....150

5.4.1 Kushtëzimet evropiane në administratën publike kroate.....151

5.4.2 Ndërtimi i profesionalizmit bazuar mbi meritokracinë në Kroaci, një model suksesi.....159

5.5 Dallimet dhe ngjashmëritë e reformave institucionale midis të dy vendeve.....161

KAPITULLI VI. KONKLUSIONE.....165

6.1 Rekomandime.....175

6.2 Referenca/Bibliografia.....177

ANEKS I.....193

INTERVISTAT (Ship)

ANEKS II.....200

INTERVISTAT(Anglisht)

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BE - Bashkimi Evropian

EQL - Evropa Qëndrore dhe Lindore

HAE - Hapësira Administrative Evropiane

KEE - Komuniteti Ekonomik Evropian

KEQÇ - Komuniteti Evropian për Qymyrin dhe Çelikun

KKN - Komiteti Bashkërendues Ndërmnistror në Shqipëri

KNIE - Komiteti Ndërmnistror për Integrimin Evropian në Shqipëri

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

OECD - Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik

OKB - Kombet e Bashkuara

ONP - Organizata Ndërkombëtare e Punës

OSBE - Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë

OSHA – Organizata e Shteteve Amerikane

PESC - Shërbimi i Politikës së Jashtme dhe i Sigurisë së Përbashkët i Bashkimit Evropian

SGCI - Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit Ndërmnistror për Çështjet e Bashkëpunimit Ekonomik Evropian

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

TFBE – Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian

TKE – Traktati i Komunitetit Evropian

UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën

WEU - Bashkimi Evropiano Perëndimor

KS- Këshillin e Sigurimit;

AP- Asamblenë e Përgjithshme;

(ECOSOC); Këshillin Ekonomik dhe Social

KAPITULLI I

1.1 Hyrje

Ndryshimet që ndodhën, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ristrukturimit të modelit të organizimit politiko-shtetëror të shteteve të dala nga regjimet komuniste në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, e bënë të nevojshme rolin e misionin e organizatave ndërkombëtare në procesin e evropianizimit të tyre.

Shqipëria, shteti më i izoluar për gati 45-vjet, me regjim totalitar do të përballej që në fillimet e tranzicionit me ristrukturimin e organizimit politiko-shtetëror të një sistemi demokratik. Shqipëria ishte një shtet ku individit ishte lënë në harresë, me një shoqëri dhe me një ekonomi të prapambetur.

Marrëdhëniet me vendet evropiane ishin të kufizuara, po ashtu edhe me pjesën tjetër të shteteve të botës. Përpara shqiptarëve, në ato vite, shtroheshin dilemat e realizimit të një procesi demokratik duke pasur prioritet të menjëhershëm zgjedhjen e modelit të rindërtimit të vendit dhe punën për zbatimin e tij në praktikë.

Pjesë e nismave për identifikimin e modeleve u bënë një numër intelektualësh, akademikësh e politikanësh, të cilët u bënë pjesë e procesit të ndryshimeve të regjimit, nga ai komunist drejt vendosjes së vlerave demokratike në vend.

Ndryshimet demokratike që nisën në Shqipëri në fillim të viteve '90-të, e kushtëzuan klasën politike shqiptare për të vendosur urat lidhëse në fusha të ndryshme midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, një nga organizatat që kishte arritur të bashkonte shtetet dhe të hartonte politika të përbashkëta. Shqipëria, sot është drejtuar drejt qasjeve dhe zhvillimeve ekonomike, politike, sociale etj. që BE-ja dhe anëtarët e saj në këto 25-vjet kanë kontribuar në çështjen e shtetndërtimit.

Duke studiuar këtë proces, në këtë punim jemi fokusuar në mënyrë të veçantë në raportin që është krijuar midis sovranitetit të shteteve anëtare, dhe kemi analizuar institucionet publike në Shqipëri që kanë monitoruar e monitorojnë procesin e integritetit evropian. Tjetër çështje, objekt i këtij studimi, ka qenë ajo që ka të bëjë me dukuritë, se si u përballën me zgjerimin e BE-së, institucionet e shtetit anëtar (Kroacisë) dhe se si do të përshtateshin institucionet e vendit tonë

me anëtarësimin e ardhshëm në BE-në, si edhe me problematikat që ka hasur, veçanërisht se si do t'i zbatojë, realizojë drejtpërdrejtë normativat e BE-së dhe do të mbajë përgjegjësitë direkte eventuale.

Performanca e BE-së në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka tërhequr vëmendjen e studiuesve që nga fillimi të viteve '70-të, të shekullit të kaluar, kur u shfaqën studimet e para për Komunitetet evropiane, posaçërisht mbi konceptet e "pushtetit" (Duchene: 1972) dhe "aktorëve" (Sjöstedt: 1977). Studimet e shumta kanë trajtuar e shtjelluar në mënyrë analitike e gjerësisht se çfarë është e përfaqëson BE-ja, veprimtaritë, arritjet, problematikat dhe kontributet ndaj vendeve anëtare, përfshirë edhe Shqipërinë.

Rëndësia e saj gjatë viteve 1980 dhe 1990, kur BE-ja ndërmori zgjerimin më të madh, fokusi kryesor iu dha sidomos "zgjerimit". Në punim, procesi i zgjerimit është parë nën prizmin e zhvillimit të politikave evropiane dhe globale për shtetndërtimin.

Në këtë fokus, siç kanë nënvizuar në periudha të ndryshme kohore teoricienët e studiuesit e BE-së, rrugëtimin e dinamikën e zhvillimit të saj se "ndikimi pozitiv" që ka procesi i negociatave multilaterale të BE-së, (Underdal: 1994) për të tërhequr vendet aspirante, nëpërmjet pushtetit 'normativ' (Manners: 2002, 2006), "transformuese" (Börzel & Risse: 2009), dhe 'etik' (Aggestam: 2008): ka kërkuar cilësinë e qeverisjes, pra atë që është emërtuar "qeverisje më të mirë".

Pushteti "normativ" i BE-së ka qenë veçanërisht i popullarizuar si mjet për të vlerësuar, jo vetëm mirësjellje të veçantë ndërkombëtare të identitetit të BE-së për "atë që është", por edhe metodat e saj ndikuese, nëpërmjet vënies së vetos për çështje të caktuara ndërkombëtare (Manner: 2002: 242). Duke theksuar "ekzistencat e ndryshme, normat e ndryshme dhe politikat e ndryshme që ka ndjekur e ndjek BE-ja". Debati për pushtetin normativ ka qenë i dukshëm duke theksuar punën e veçantë të BE-së në "nëse çfarë mund të jetë normale" në marrëdhëniet ndërkombëtare "(Sjellje & Ehitman: 2003: 389-390); duke identifikuar veçanërisht atë që është parë si "impakti konceptual" i BE-së dhe "potenciali mbi lirinë e mendimit" në kuadër të sistemit ndërkombëtar (Manner: 2002: 238-9).

Fokusuar në "tipologjitë" e pushtetit të BE-së dhe të efekteve evoluese BE-ja është konceptuar si organizata me potencial më nxitës, në krahasim me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Ndikimi i BE-së në kuadër të negociatave shumëpalëshe ka filluar të tërheqë vëmendje (Van Schaik & Schunz: 2012, Schunz: 2010a, 2010b), përsëri duke reflektuar interes në rritje ndaj vendeve të BE-së, jo vetëm si prani ndërkombëtare, por edhe në aftësitë e saj për të realizuar rezultatin ndërkombëtar dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara. Gjatë gjithë kësaj analize, vëmendja ka qenë përqendruar kryesisht në disa objektiva që synonin analizën, thellimin e studimit.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi doktore është paraqitja e një panorame të qasjeve teorike, studimore, analitike e kërkimore. Duke sjellë në vëmendje rolin e rëndësishëm që ka për Shqipërinë marrëdhënia me BE-së dhe organizatat e tjera ndërkombëtare në periudhën kohore 1990 e, deri në ditët e sotme. Për të eksploruar këto marrëdhënie në disa dimensione kemi trajtuar, shtjelluar teorikisht zhvillimet në realitetin shqiptar të këtyre 25-viteve, në mënyrë krahasuese edhe me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit e më konkretisht me Republikën e Kroacisë.

Në punimin tim doktoral, kam synuar të bëj analizë gjithëpërfshirëse rreth zhvillimeve të Shtetit Shqiptar, si vendi më i varfër në vendet e regjimeve ish-komuniste, i cili është klasifikuar ndër më të vonuarit në procesin drejt demokratizimit dhe integritetit evropian.

Studimi, fokusohet në disa aspekte themelore që kanë të bëjnë me ecurinë e procesit evropianizues në vendin tonë.

Qëllimi kryesor i këtij studimi ka qenë shqyrtimi i realizimit të reformave evropiane nga institucionet shqiptare. Në fokus të analizës kanë qenë monitorimi i institucioneve dhe çfarë ndryshimesh ka kaluar administrata shqiptare nga modelet e vjetra tradicionale, drejt standardeve moderne për të parë, nëse impakti i marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare ka arritur të jetë i suksesshëm nëpërmjet sugjerimeve të tyre. Prandaj, në fokus të analizës së studimit janë pasqyruar disa problematika, siç janë:

1. Pasqyrimi i strukturës institucionale krahasuar me standardet evropiane. Për këtë, është analizuar impakti që kanë sjellë organizatat ndërkombëtare. Studimi është fokusuar gjithashtu edhe në hapat që ka kaluar Shqipëria, nga paradigma komuniste drejt modeleve evropiane.

2. Analizimi i arsyeve të një tranzicioni të gjatë institucional nga shtetndërtimi komunist drejt niveleve evropiane. Këtu, kemi analizuar atë që e quajmë faza e “paradigmës komuniste”, një periudhë që është karakterizuar nga një mungesë e procesit shtetndërtues, që e ka rankuar Shqipërinë ndër shtetet e dobëta, pa shtetndërtim të përfunduar.
3. Objektivi tjetër i rëndësishëm në studimin tim ka qenë arsyetimi në mënyrë analitike i “tranzicionit të vonuar” që vendi ynë ka kaluar. Për këtë, kemi analizuar shkaqet, motivet që kanë ndikuar në këtë shtetndërtim duke shtjelluar rolin e klasës politike dhe përpjekjet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Analiza është fokusuar në përpjekjet e ndërtimit të një demokracie liberale dhe ekonomie tregu, si edhe modelet që janë sugjeruar nga ndërkombëtarët në këto faza të implementimit të demokracisë funksionale.
4. Kemi analizuar rëndësinë e shtetndërtimit, nisur nga kushtet e krijuara dhe të lejuara në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
5. Për identifikimin e kësaj problematike, është gjykuar e nevojshme shqyrtimi i disa çështjeve, të cilat kërkonin përgjigje, duke filluar me mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të institucioneve tona në kuadër të kërkesave të reja evropiane, si edhe a kanë arritur ato të realizojnë në praktikë legjislacionin e ri.

Objektivat e studimit kanë synuar që nëpërmjet analizave, shtjellimeve dhe trajtimeve analitike të evidentohet roli dhe misioni që kanë organizatat ndërkombëtare si: BE, KiE, OSCE, etj., të cilat nëpërmjet politikëbërjes dhe strategjive të tyre kanë ndikuar në procesin e shtetndërtimit, drejt evropianizimit të Shqipërisë, konkretisht:

1. Kemi synuar pasqyrimin e shpërbërjes së vlerave të trashëguara të institucioneve komuniste drejt modelit institucional të “evropianizimit”, i identifikuar me vlerat dhe normat demokratike në rrugën e procesit shtetndërtues në Republikën e Shqipërisë.
2. Objektivi i rëndësishëm ka qenë arritjet e modelit qeverisës që BE-ja ka nxitur në shtetin shqiptar, nëpërmjet strategjive të saj, të cilat kanë bërë të mundur krijimin e kapaciteteve të favorshme për të ndërtuar një sistem demokratik. Promovimi i qeverisjes më të mirë me ndihmën e aktorëve ndërkombëtarë do të krijojnte kushtet e përshtatshme për qeverisje funksionale më të mirë në vend.

3. Në analizën tonë, kemi marrë si model sukse si përvojën kroate, e cila është karakterizuar nga përmirësime dhe standarde pozitive me strukturat institucionale dhe shtetërore.
4. Objektivi i rëndësishëm ka qenë edhe monitorimi i institucioneve në nivel legjislativi dhe ekzekutivi, të ngritura enkas për të çuar përpara procesin e integritetit evropian.
5. Objektivi i rëndësishëm kanë përbërë edhe fazat e nivelit të demokratizimit, nëpër të cilat kanë kaluar institucionet tona drejt përsosjes së mirëqeverisjes.

Aspektet e tjera themelore nga ku dalin konkluzionet e këtij punimi, kanë të bëjnë me faktin se si duhet të përshtatet administrata shqiptare, pra se si ajo duhet të aplikojë drejtpërdrejtë standardet e BE-në, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë direkte nga ana e saj.

1.3 Rëndësia e këtij kërkimi shkencor

Zhvillimet e sotme politike dhe ekonomike brenda kontinentit evropian, kanë krijuar një prirje paralele në zhvillimet e procesit të integritetit, duke përfshirë nga njëra anë shtetet qendrore të kontinentit evropian dhe në anën tjetër atë që shpesh është quajtur si periferia e Evropës, vendet e Ballkanit Perëndimor, ku përfshihet edhe Shqipëria. Manifestimet gjithëpërfshirëse të prirjes globalizuese, të shoqëruara me sfidat aktuale të fenomenit “evropianizim”, kanë treguar përkujdesje më të dukshme në interes të punëve të brendshme të Qeverisë së Shqipërisë.

Argumentet se Shqipëria duhet të realizojë shtetndërtim të suksesshëm qëndron në disa faktorë e konkretisht:

- Së pari, në kontrollimin e dhunës dhe vendosjen e legjitimitetit në institucionet shqiptare, prandaj në analizë, janë marrë mekanizmat monitorues mbi institucionet, ndërtimin e institucioneve të afta dhe përgjegjëse, funksion që lidhet me të mirën publike drejt procesit integruar të vendit;
- Së dyti, sfidat aktuale të shtetndërtimit vazhdojnë në shtete që kanë rregulla dhe zhvillim “normash”.

Nisur nga teoritë rreth shtetndërtimit, në kuadër të konsolidimit drejt procesit evropianizues, ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar në lidhje me mënyrën e mbështetjes së proceseve të shtetndërtimit. Mbështetja e ndërtimit të një shteti kërkon forcimin e institucioneve shtetërore të ligjshme dhe të qëndrueshme. Nisur nga ky fakt, risia e sjellë në këtë punim është në mbështetje të standardeve administrative evropiane, të cilat nxitin shtetndërtimin tonë, si edhe krijuan një test të fortë për procesin evropianizues shqiptar.

Shtetndërtimi dhe evropianizimi është perceptuar nga komuniteti ndërkombëtar që në vitin 1990 si një grup standardesh që realizohen nga aktorët kombëtarë e ndërkombëtarë për të reformuar dhe fuqizuar institucionet e shtetit drejt përsosjes.

Studimi është fokusuar në aspektet themelore të funksionimit të procesit në vendin tonë, aspekti i parë i analizuar dhe që ngriti bazat për realizimin sistemeve të modeluara në lidhje me zhvillimin e prezantimit të standartizimeve të BE-së. Në këtë vështrim, me rëndësi e veçantë është ajo që ka të bëjë me raportin që është krijuar me konceptin e sovranitetit të shteteve anëtare, si edhe analiza e ndërtimit të marrëdhënieve me administratat vendase.

Tjetër pikë e rëndësishme ka qënë ajo që ka të bëjë me dukurinë se si u përballën me zgjerimin e BE-së, institucionet e shteteve anëtare dhe se si u përshtatën administratat e vendeve ish-socialiste të Ballkanit, pas anëtarësimit e problematikave që ato hasën.

Në vitet e fundit, për shkak të krizës financiare ekonomike të BE-së dhe të rritjes së potencialit të drejtave të disa shteteve anëtare, procesi i zgjerimit është parë si i rrezikuar dhe që ka treguar shenjat e “lodhjes”. Anëtarësimi i Kroacisë në vitin 2013, riafirmoi angazhimin e Bashkimit Evropian për të nxitur përpara saj axhendën e zgjerimit, pavarësisht se është e kombinuar me një axhendë më këmbëngulëse duke i bërë rregullat e kërkesat e rrepta për vendet kandidate, edhe pse BE u përball me vështirësitë e zgjerimit të Rumanisë dhe të Bullgarisë në vitin 2007, si edhe me vështirësitë e hasura gjatë negociatave të pranimit me Kroacinë.

Pranimi i Kroacisë solli shpresë të rëndësishme për vendet e tjera të rajonit që kishin aspiruar e aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian. Shqipëria në kuadër të këtyre dinamikave ndërkombëtare dhe të aspiratave të saj për t’u bërë pjesë e Bashkimit Evropian është shoqëruar nga një varg problematikash e sfidash.

Ky studim, jemi të mendimit se ka çelur rrugën drejt krijimit të vlerave të reja mbi studimet akademike në këto fusha, si edhe do të inkurajojë studiues të tjerë të përfitojnë prej avantazheve të risisë që ka sjellë punimi im doktoral.

1.4 Pyetje dhe Hipotezat kërkimore

Me qëllim të identifikimit të kësaj problematike, nga studimi i literaturës, e kemi parë shumë të nevojshme shqyrtimin e disa çështjeve, të cilat kanë kërkuar përgjigje lidhur me mënyrën e funksionimit dhe organizimit të impaktit që kanë reformat evropiane. Pyetjet kërkimore janë përqendruar, si më poshtë:

- A kanë ecur reformat demokratike drejt një procesi evropianizimi të suksesshëm?
- A ka ndikuar faktori ndërkombëtar në përsosjen e reformave institucionale?
- A ka qenë BE-ja nëpërmjet strategjive të veta, për të realizuar një mirëqeverisje në Shqipëri?
- Çfarë qasje institucionale BE-ja është përpjekur të implementojë në vendin tonë?

Pra, këto dhe pyetje të tjera me natyrë kërkimore kanë qenë fokusi kryesor i analizës së studimit, për të bërë të qartë rritjen e kapaciteteve të ndërtimit të Shtetit Shqiptar në rrugën e evropianizimit.

HIPOTEZAT

Punim ka tri hipoteza kryesore të cilat në vetvete janë të ndërlidhura me njëra- tjetrën duke na mundësuar vërtetimin e tezave teorike.

1. **Hipoteza1:** e pasqyruar në studim dhe që mendojmë se është vërtetuar është: “Elitat politike nëpërmjet instrumenteve të saj politike reformojnë institucionet, pushteti politik kombëtar nuk i ka justifikuar mekanizmat ndërkombëtare në zgjidhjen e rritjes profesionale së kapaciteteve institucionale”.
2. **Hipoteza 2:** Kushtëzimet dhe mekanizmat evropiane si promotor reformash tek shtetet candidate kanë arritur të luajnë rolin vektor për realizimin e reformave institucionale.

3. **Hipoteza 3:** Efektet pozitive dhe negative që kanë shoqëruar institucionet shqiptare në këto vite tranzicioni kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së profilizimit të punonjësve(specialist) kombëtarë, sipas standardeve evropiane.

1.5 Metodologjia dhe metodat e studimit

Metodat janë të varura nga teoritë, ndërsa teoritë ndërlidhen nga hipotezat dhe pyetjet kërkimore, të cilat së bashku kanë sjellë interpretimin respektiv të analizuara në studim. Pikërisht në varësi të hipotezave dhe pyetjeve kërkimore në studim kanë dominuar këto metoda ndërdisiplinore:

1. Analitike;
- 3 historike;
4. Studimore;
5. Intervistuese (sasiore dhe cilësore);
6. Krahasese.

Përshkrimin e metodave konkrete të përdorura në këtë punim e kemi analizuar si më poshtë:

Metoda “Analizë interpretuese”, është zbatuar në këtë punim, kryesisht duke synuar interpretimin e dispozitave të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo metodë i referohet studimit në kapituj të ndryshëm, duke tentuar të nxjerrë në pah anët e dobëta apo mangësitë në funksion të hipotezës apo pyetjeve kërkimore.

Nga prizmi i metodës “**historike**”, kjo metodë krijoi kushtet e përshtatshme për grumbullimin e duhur të informacionit.. Historiku i shkollave teorike të shtetndërtimit apo të evoluimit historik që kanë kaluar institucionet ndërkombëtare e hodhi vështrimin mbi dijenitë e mëparshme.

Metoda “**krahasese**”, është perceptuar si proces i konstatimit të ngjashmërive dhe dallimeve mes dukurive të ndryshme apo të njëjta. Kjo metodë ka vlerën e vetë në këtë studim duke konstatuar përparësitë apo mangësitë konkrete të asaj çfarë sjellim. Kjo metodë është e rëndësishme në studimin tonë se ka sjellë risi në analizën e reformave.

Një tjetër **metodë** e përdorur në këtë studim është “**triangulimi**”¹, që në thelb ka të bëjë me matjen e të njëjtit tregues në mënyra të ndryshme e konkretisht:

Së pari, është treguesi teori-analizë që është matur, sipas formave skematizuese;

Së dyti, e njëjta logjikë matje është aplikuar në nivel institucional;

Së treti, është matur nëpërmjet përfaqësuesve të institucioneve kombëtare- ndërkombëtare në nivel të vendit të marrë në analizë.

Metoda e “**triangulimit**” në këtë studim është e ndërthurur me metodën e intervistës/anketimit në derivate me metodën cilësore (kualitative), e cila ka pasqyruar argumentet dhe ka vërtetuar tezat teorike që janë të lidhura edhe me hipotezat, ndërsa metoda sasiore (kuantitative) e referuar është plotësuese vetëm në disa aspekte të studimit. Mund të theksohet se përqasja e këtyre dy metodave është sa e ndarë aq dhe e ndërthurur midis njëra-tjetrës.

Nënvizojmë se studimi ka realizuar “**përpunimin e literaturës**” duke përdorur logjikën interpretuese, nëpërmjet qasjes kërkimore të **hinkës**².

Së pari, për të pasqyruar dhe përdorur saktë konceptet teorike të studjuesve të ndryshëm dhe duke u përpjekur se si këto teori janë vënë për zbatim në rastin shqiptar;

Së dyti, për të kuptuar dhe përdorur saktë modelet e implementuara në shtete të ndryshme dhe se si të përshtateshin në realitetin shqiptar, jemi fokusuar në literaturën përkatëse dhe te autorët më në zë të fushës në të dy pjesët e Evropës;

Së treti, për të kuptuar përthyerjen teorike në rastin shqiptar dhe specifikat përcaktuese të modelit që ka shfaqur Shqipëria, duke u fokusuar në autorët më domethënës shqiptarë dhe botimet zyrtare të kohës që hedhin dritë mbi problematikën.

Në këtë metodë të rëndësishme kemi mësuar shumë nga përpjekjet dhe puna që kanë bërë të tjerët, pra rishikimi i “**Literaturës**” si **metodë** ka qenë e rëndësishme për të kuptuar :

¹ Metoda e **triangulimit** është një metodë përmes verifikimit të të dhënave në myrë të kryqëzuar. Kjo metodë i referohet aplikimit dhe kombinimit të disa metodave hulumtuese në studimin e të njëjtit fenomen

² Qasja kërkimore e “**hinkës**” konsiston në mënyrën e përpunimit të literaturës nga definimi i problemit drejt përfitimit të produktit. Kategoritë e metodës “hinkë” përshkruajnë kërkime si diçka që mund dhe duhet të ndodhë në çdo fazë të një ciklit të kërkimit dhe të përshkruajnë se sa afër ju jeni për problemin ose zgjidhjen.

Nevojën e njohurive ekzistuese mbi subjektin e kërkimit. Kjo metodë kërkimi është aplikuar kryesisht në dy kapituj:

a) Kapitulli teorik- Teoritë kryesore të shtetndërtimit ku metoda “**Rishikim i Literaturës**” krijoi mundësinë për të sqaruar tezat teorike të shtetndërtimit. Është shumë e nevojshme për kërkuesin, ashtu edhe për lexuesin të kuptojë natyrën teorike e veçoritë që paraqet fenomeni dhe në rastin konkret modelet e shtetndërtimit që kanë qenë edhe objektivi i vetë punimit;

b) Kapitulli mbi historikun e institucioneve ndërkombëtare, ku metoda e rishikimit të literaturës paraqitet me vlerë për këtë kapitull pikërisht për qasjen që ky i fundit ka kryer në shtjellimin e vlerave që kanë Organizatat ndërkombëtare në procesin e demokratizimit drejt qasjes evropianizuese të shteteve. Këto momente janë paraqitur si vlera të veçanta për krijimin e mekanizmave të rëndësishëm dhe me shumë vlefshmëri për implementimin e reformave tek shtetet kandidate.

Punimi doktoral, ka *natyrë longitudinale*³, që ka ndihmuar për krijimin e një metodologjie koherente dhe që punimi tashmë ka formatin e studimit shkencor.

³ Kërkimi shkencor me natyrë “longitudinale” kupton: një metodologji koherente ku formati metodologjik mund të shtrihet në kohë dhe të përdoret në vitete e ardhshme.

1.5.1 Variablat e studimit

Në këtë punim, variablën e pavarur e përbën cilësia, respektivisht modeli teorik i organizatave ndërkombëtare e më konkretisht i BE-së për të realizuar impaktin e saj nëpërmjet standardeve, në mënyrë për të përfunduar me realizimin e shtetndërtimit.

Ndërsa, variabël të varur, janë institucionet shqiptare, të cilat përdorin strategjitë e reja bashkëkohore, për të nxitur implementimin e reformave, në mënyrë që të arrijnë procesin evropianizues.

1.5.2 Kampionimi dhe instrumentet e studimit

Studimi është mbështetur në rëndësinë e institucioneve në kuadër të evropianizimit të vendit. Përzgjedhja e fokus grupit është e rastësishme, numri i të intervistuarve është zhvilluar si në nivel të përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare duke filluar nga Delegacioni i BE-së në Tiranë dhe me Drejtuesin e Misionit në OSCE, dy ekspertë nga programi SMI III, të cilët janë intervistuar mbi zhvillimet e procesit të integritimit në Kroaci dhe se si u transformuan institucionet atje.

Gjithashtu, në studim janë përfshirë edhe problematikat e ndërtimit të institucioneve shqiptare dhe si po modernizohen ato në kuadër të zbatimit të ligjit të ri të statusit të nënpunësit civil, duke arritur me propozime konkrete mbi risinë që duhet të ketë kryesisht përzgjedhja e ekspertëve të administratës.

Me qëllim të evidentimit të problemit duke u fokusuar në produktivitetin e organizmave ndërkombëtare kemi përdorur këto instrumente:

- Diskutime me ekspertë të fushës;
- Intervista me përfaqësues të Delegacioneve të Organizatave Ndërkombëtare;
- Vizita në institucionet.

Për të marrë përgjigje konkrete në lidhje me zhvillimet e problematikës, janë përdorur teknikat e intervistimit me stafet në mënyrë për të mbledhur informacionin teorik dhe praktik të funksionimit të tyre e konkretisht:

- Mënyrën e organizimit të bashkëpunimit midis institucioneve dhe organizatave;
- Ndikimin e rekomandimeve të ndërkombëtarëve tek institucionet përkatëse;
- Objektivat e realizuara nga institucionet shqiptare;
- Zbatimi praktik për informimin e qytetarit;
- Aftësimin profesional të stafëve të përzgjedhura në kuadër të evropianizimit të vendit;
- Monitorimin e Këshillit Kombëtar të Integritetit, si model suksesi që vjen nga Kroacia.

Në përpjekje për të ndriçuar mënyrën e funksionimit të koncepteve teorike lidhur me implementimin praktik të procesit, janë zhvilluar intervista të tipit:

- a) të kombinuara (të hapura dhe të mbyllura) bazuar në përpunimin statistikor;
- b) me anë të përshkrimeve cilësore.

1.5.3 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

U hartuan 4 formate intervistash në formë pyetësori me pyetje të ndryshme dhe të njëjta duke iu drejtuar grupeve të ndryshme ekspertësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Pyetësorët u pilotuan para se të finalizoheshin duke u bazuar në literaturë, instrumente të aplikuara më parë në studime të ngjashme.

Pyetësori u realizua duke mbledhur të dhënat demografike të përdorura në ravijëzimin e profilit të administratës publike shqiptare. Përveç nivelit arsimor, të ardhurave, qeverisjes së mirë, profesionalizmit, kjo pjesë përfshiu edhe pyetjet mbi rëndësinë e përparësive të reformës në institucionet publike, si një nga ndjeshmëritë kryesore në këtë fushë kërkimi, si edhe monitorimin e institucioneve të reja të ngritura enkas për procesin e integritetit evropian.

Pjesa e dytë e intervistave mblodhi të dhëna mbi perceptimet e administratës publike, për rolin dhe misionin e saj në shoqëri, si edhe opinionet mbi departamentet relevante e prirjet reformuese. Perspektiva krahasuese me sektorët e tjerë të shoqërisë është përdorur për të relativizuar opinionet ndërkombëtare, të ndara nga përgjigjedhënësit shqiptarë.

Pjesa e tretë ka pasqyruar faktorët kryesorë ndikues që kanë luajtur rol në formësimin e administratës publike në Republikën e Shqipërisë.

Në pjesën e katërt, janë parashtruar informacionet mbi perceptimet dhe përvojat që janë të lidhura me ekspertizën e stafëve. Nëpërmjet kombinimit të qasjeve individuale dhe opinioneve mbi perceptimet e përgjithshme të administratës publike, u synua objektivitet më i madh për të matur qëndrimet e opinionet të liderëve ndërkombëtarë mbi institucionet publike shqiptare dhe ato kroate.

1.5.4 Pjesa operative dhe konsiderime etike të studimit

Ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë kanë qenë të njohur në mënyrë të detajuar me kërkesat dhe sfidat e procesit të integritetit të Shqipërisë, ndërsa specialistët, drejtorët e drejtorive, ministrat kanë dhënë opinionin e tyre mbi rezultatet e punës së kryer.

Gjatë zhvillimit të pyetësorit intervistues, jemi përpjekur të bindim ekspertët të jenë sa më racionalë dhe të na japin përgjigje sa më të sinqerta, në mënyrë që rezultatet të dalin sa më konkrete. Gjatë dy viteve të fundit kemi siguruar materialin, të cilin e kemi përdorur vetëm për qëllime studimi. Ekspertët, specialistët, studiuesit kanë përcjellë vijimisht ecurinë e procesit të integritetit në institucionet tona.

Gjatë kësaj kohe, kemi zhvilluar diskutime me disa ekspertë ndërkombëtarë që merren me zhvillimet, sa politike aq edhe teknike të procesit të integritetit të Shqipërisë, me qëllim që të fitonim baza më të forta për identifikimin e problemit dhe për të na ndihmuar në pasqyrimin e gjendjes rreth produktivitetit të procesit.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer individualisht. Vetadministrimi u zgjodh si qasja më e mirë për të shtuar privatësinë e intervistuesve dhe për të minimizuar shkallën e refuzimit të përgjigjeve.

Anonimiteti e konfidencialiteti u siguruan dhe gjetjet përfundimtare do të mbeten anonim, si një gjest kortezie për ndihmesën e tyre.

1.6. Kufizimet e studimit

Për të parë produktivitetin e reformave që organizmat ndërkombëtare impaktojnë për nxitjen e kapaciteteve demokratike e evropianizuese në institucionet tona publike kemi evidentuar edhe disa kufizime, konkretisht:

- A) Mos komunikimi ndërministror i stafeve të administratës publike;
- B) Kufizim tjetër është mungesa e bashkëpunimit të informimit të punës së ekspertëve në administratën publike;
- C) Faktorë të shumtë kanë ndikuar në mos përgjigje të intervistes ose të lënë për gjysëm;
- D) Të intervistuarit janë ekspertë të institucioneve tona dhe kanë pasqyruar problematikën në komunikimin ndërministror, si edhe hezitimin për dhënien e informacionit për punën e tyre;
- E) Punimi ka dhënë opinion personal lidhur me mekanizmin e mos funksionimit të këtij procesi.

1.7 Përmbledhja dhe Përmbajtja

Studimi është i organizuar në gjashtë kapituj e konkretisht :

Kapitulli i parë, përshkruan metodologjinë e studimit. Në këtë kapitull, janë përkufizuar koncepte e metoda kërkimore, për të shqyrtuar korrelacionin midis mbështetjes dhe rezistencës ndaj risive të integritetit evropian. Metodologjia e përdorur është bazuar në metodën ndërdisiplinore, si edhe në mënyrën e përpunimit të intervistave.

Kapitulli i dytë, përmban shqyrtimin e literaturës, lidhjen me studime të tjera. Në të është paraqitur situata teorike e lidhur me përkufizimin e koncepteve bazë e ato janë trajtuar në pjesën më të madhe me anë të metodës historike. Në këtë kapitull, janë analizuar më gjerësisht shkollat rrymat, konceptet teorike të shtetndërtimit, duke iu referuar disa toricienëve më të spikatur të literaturës evropiane.

Në **kapitullin e tretë përshkruhet** ecuria teorike e fushës së studimit. Për këtë, është theksuar roli dhe misioni juridiko-politik që kanë organizatat ndërkombëtare në përmirësimin e funksionimit institucional të shteteve, duke përmirësuar nëpërmjet mekanizmave të tyre nxitës, rindërtimin e shtetit.

Në vijimësi, janë shtjelluar qasjet bashkëkohore që kanë sjellë këto organizata duke bërë dallimin midis rolit të organizatave me tipologji universale dhe ato rajonale. I është dhënë rëndësi organizatave me karakter rajonal, edhe për shkak të pozicionit gjeografik të shtrirjes së tyre.

Kapitulli i katërt, përmban rezultatet e dala nga pyetësi dhe intervistat cilësore e sasiore në kuadër të reformave institucionale që kanë monitoruar procesin e integritetit evropian. Janë ilustruar nëpërmjet grafikëve dhe tabelave qasjet e progresit të bërë nga institucionet publike të shtetit shqiptar. Interesi ynë thellohet në interpretimin e rezultateve aktuale të situatës, në të cilën është gjendur ndërtimi i administratës qendrore në vend. Rezultatet e dala në fund të këtij kapitulli, janë paraqitur për të pasqyruar progresin e institucioneve.

Kapitulli pestë, ka përshkruar gërshetim gjetjesh, prurjesh, edhe përmes interpretimit e krahasimit të analizave midis dy vendeve, Shqipëria, vendi kandidat dhe Kroacia, vendi anëtar i BE-së. Në vijim, është paraqitur interpretimi i performancës së institucioneve tona, duke nxjerrë në pah opinionin kombëtar e qasjen që ka sjell opinionin ndërkombëtar për të nxitur progresin në vend. Në vijim, është pasqyruar interpretimi sasior i rezultateve të dala nga intervistat, duke u përmbysur me diskutimin për rezultatet specifike të progresit.

Në kapitullin **gjashtë**, janë pasqyruar, në mënyrë të finalizuar, konkluzionet dhe rekomandimet të mbështetura në rezultatet e studimit tonë.

KAPITULLI II.

TEORITË KRYESORE TË SHETENDËRTIMIT, KORNIZA TEORIKE

2.1 Analizat teorike mbi konceptin e shtetndërtimit.

Modeli teorik në këtë kapitull ka analizuar teorinë dhe qasjet në kuadër të shtetndërtimit. Koncepti i shtetndërtimit është një term i përdorur shumë në ditët e sotme për të identifikuar problematikat që kanë trashëguar shtetet gjatë ndryshimeve, nga regjimi totalitar drejt sistemit demokratik. Në disa shkolla teorike termi i shtetndërtimit ka qenë përdorur për të pasqyruar funksionimin e shtetit ligjor dhe e shtetit të së drejtës.

Ky koncept, ka lidhje me krijimin e shteteve demokratike në Evropën Perëndimore. Charl Tilly ka përshkruar avantazhet që i shoqërojnë shtetet drejt procesit shtetndërtues, siç ka nënvizuar ai: “Shtetndërtimi provon emergjencën e shtetit mbi kontrollin dhe konsolidimin e territorit, ndershmërinë, kohëzgjatjen për të pasur institucione permanente të decentralizuara dhe shtet autonom që ushtron pushtet të plotë mbi një popullsi të caktuar”(Tilly,1975).

Ka dy qasje kryesore teorike të përcaktimeve të shtetndërtimit:

Së pari, ndërtimi i shtetit është parë nga disa teoricienë si një aktivitet i ndërmarrë nga aktorë të jashtëm (e vendeve të huaja), të cilët janë përpjekur për të ndërtuar, ose rindërtuar institucione të dobëta, pas konfliktit ose të shtetit të dështuar. Kjo shkollë e “Marrëdhënieve ndërkombëtare ekzogjene” e sheh ndërtimin e shtetit si veprimtarinë e një vendi në raport me një tjetër.

Së dyti, teoria e ndjekur nga disa parime të zhvilluara nga vendet e OECD në 2007 në mbështetje të shteteve konfliktuale, si edhe të atyre me demokraci të kufizuar që ka synuar të identifikojë “ndërtimin e shtetit” si një zonë që ndihmon për zhvillimin e demokracisë.

Referuar vendeve donatore mbi përkufizimet, në ndërtimin e shtetit, kjo tezë është përkrahur nga studiuesit e shkencave politike. Kjo pikëpamje ka argumentuar se vendet evropiane nuk mund të realizojnë ndërtimin e shtetit jashtë kufijve të tyre, ata mund të ndikojnë vetëm, nëpërmjet mbështetjes ose të pengojnë proceset. (Fritz dhe Menocal, 2007)

Nëpërmjet qasjeve teorike dhe analizave ka pasur bindje më të gjerë lidhur me sugjerimet se si të mbështeteshin proceset e shtetndërtimit, të cilat ende nuk ishin implementuar. Disa kanë besuar se duke mbështetur ndërtimin e shtetit kanë kërkuar nxitjen e institucioneve të ligjshme dhe të qëndrueshme. Disa kanë pranuar se strategjitë e aplikuara, ende nuk janë realizuar plotësisht. Disa nga rastet e mbështetura, për të realizuar procesin e shtetndërtimit, të ndërmarrë deri më tani, kanë qenë të suksesshme.

Diskutimi ka sjellë në qendër të analizës qasje të ndryshme, si edhe koncepte teorike të shtetndërtimit. Shtetndërtimi i është referuar disa veprimeve të ndërmarra nga aktorët kombëtarë e ndërkombëtarë për reformimin, forcimin e kapaciteteve, legjitimitetin e institucioneve të shtetit ku ato janë seriozisht të dëmtuara. (Fritz & Menocal 2007:13).

Gjatë viteve, koncepti i shtetndërtimit ka ndryshuar dukshëm. Qëllimet kryesore të ndërtimit të shtetit kanë përfshirë "afrimin e sigurisë, vendosjen e sundimit të ligjit, afrimin efikas të mallrave dhe shërbimeve përmes institucioneve funksionale formale shtetërore, si dhe gjenerimin e legjitimitetit politik për të caktuar institucione shtetërore të reja që po ndërtohen"(Fritz & Menocal 2007:13).

Sot, edhe pse fokusi nuk është vënë vetëm në ndërtimin apo forcimin e institucioneve formale e kapaciteteve shtetërore, komuniteti ndërkombëtar tani është më i vetëdijshëm se shteti nuk mund të izolohet dhe se marrëdhëniet shtet-shoqëri janë të domosdoshme për proceset e shtetndërtimit. Kjo do të thotë se ndërtimi i shtetit nuk është vetëm në lidhje me qasjet "top-down" të institucionit të forcuar (dmth duke u fokusuar në aktorët shtetërorë ose elitave kombëtare), por në lidhje me qasjet "poshtë-lart", si edhe lidhjen e shtetit me shoqërinë, duke punuar përmes shoqërisë civile. (Menocal 2011: 1719).

Sipas Alan Whaites, shtetndërtimi është "procesi përmes të cilit rriten aftësitë e tij për të funksionuar". Qëllimet e së ashtuquajturës "funksionalitet" mund të ndikohen nga faktorë të tillë si: prioritetet e qeverisë dhe mund ose nuk mund të vënë theksin në fusha të orientuara për të mirën publike. Pra, ndërtimi i shtetit është një term neutral vlerash e ai zhvillohet në të gjitha shtetet, nëse ato janë të pasura apo të varfër, elastike apo të brishta.

Të gjitha shtetet janë përpjekur për të përmirësuar strukturat e tyre dhe kanë rritur kapacitetet e tyre, por ajo që është e rëndësishme të evidentohet është se anëtarët e komunitetit ndërkombëtar, kolektivisht ose individualisht, nuk kanë 'krijuar' ndërtimin e shtetit jashtë kufijve të tyre. Ndërtimi i shtetit është një proces kombëtar, rezultat i marrëdhënieve shtet-shoqëri që mund të preken nga forcat e ndryshme të jashtme të tilla si: tregtare, media apo ndihma, por që është në radhë të parë i formuar nga dinamika vendase. (Whaites 2008: 4).

2.2 Rëndësia e shtetndërtimit dhe impakti ndërkombëtar në këtë proces

Në milleniumin e ri, procesi i shtetndërtimit, është bërë një nga përparësitë ndërkombëtare, sidomos pas rënies së regjimeve komuniste në Evropën Lindore. Përpara politikës së jashtme ndërkombëtare janë shtruar shumë sfida me vendet me tranzicion të gjatë drejt procesit të konsolidimit të demokracive.

Donatorët kanë ndikuar në procesin e shtetndërtimit, duke dhënë një angazhim më të gjerë dhe më kompleks sesa në punën e tyre tradicionale për ngritjen e kapaciteteve dhe sfidave të tjera zhvillimore në shumë mjedise “normale”.

Në formulimin e thjeshtë, shtetformimi është kuptuar nga komuniteti ndërkombëtar që në vitet 1990 dhe i është referuar një varg veprimeve të ndërmarra nga aktorët kombëtarë e ndërkombëtarë për të krijuar reforma dhe për të forcuar e institucionet shtetërore ku ato janë, seriozisht të dëmtuara ose që kanë munguar. (Caplan 2005).

Qëllimet kryesore të impaktit ndërkombëtar në kuadër të procesit të shtetndërtimit kanë përfshirë:

- a) ofrimin e sigurisë;
- b) vendosjen e sundimit të ligjit;
- c) ofrimin efikas të mallrave dhe të shërbimeve themelore përmes institucioneve funksionale zyrtare shtetërore;
- d) gjenerimin e legjitimitetit politik për të organizuar institucione shtetërore apo rindërtimin e tyre. (Brinkerhoff, 2007).

Siç mund të nxirret, nga sa parashtruam më sipër, procesi i shtetndërtimit dhe i qeverisjes janë terma të lidhura ngushtë për të arritur një proces të suksesshëm evropianizimi. Ndërkombëtarët nga njëra anë, ashtu edhe shteti shqiptar nga ana tjetër, kanë ndarë shqetësimin në lidhje me çështjet e mësipërme, veçanërisht se si të bënin institucionet të punojnë më mirë. Në shumë mënyra, shtetndërtimi është detyrë e brendshme e shtetit. Shtetndërtimi është proces gjithëpërfshirës, prandaj përpjekjet e shtetit shqiptar në mënyrë të vetëdijshme duhet të realizonin më qartë reformën politike të ndërtimit të institucioneve.

2.3 Modelet e shtetndërtimit

Ka modele të ndryshme dhe qasje në ndërtimin e shtetit që kanë shpjeguar se përse disa vende kanë menaxhuar shtetndërtimin më mirë se të tjerët. Dy modele të kundërta, të cilat kanë pasqyruar kompleksitetin:

- a. përgjegjshmërinë e shtetndërtimit;
- b. shtetndërtimet jopërgjegjëse.

2.3.1 Shtetndërtime të suksesshme

Sipas modelit shtetndërtim i “suksesshëm” nuk ka ndodhur në një fazë të caktuar të zhvillimit të vendit. Ai është rezultat i një game të gjerë të politikave dhe të faktorëve jopolitikë që kanë ndodhur në çdo shtet. Përgjegjshmëria e shtetndërtimit përfshin tri fusha të detyrueshme të progresit, konkretisht:

- a. zgjidhje politike;
- b. funksionet e mbijetesës;
- c. funksionet e pritshme (Whaites 2008: 6).

Në mënyrë që shtetndërtimi të jetë i suksesshëm duhet që zgjidhjet politike të jenë vendimtare. Siç e ka theksuar edhe Whaites (2008) marrëveshjet politike janë “të thella, ndërmjet elitave që sjellin kushte për t’i dhënë fund konfliktit”. Marrëveshjet politike ndodhin për shkak të interesit

vetjak. Për të pranuar një zgjidhje politike shteti nuk mund të përballojë të jetë statik, por duhet të absorbojë ndryshimet shoqërore. (Whaites 2008: 7).

Fusha e dytë e progresit për shtetndërtim të suksesshëm është "një sërë funksionesh themelore thelbësore për mbijetesën dhe forcën e kornizës institucionale të shtetit". (Whaites 2008: 7). Whaites ka theksuar se të gjitha proceset e suksesshme për ndërtimin e shtetit duhet të zhvillojnë kapacitetet në lidhje me tri zona:

- a. sigurinë (të jetë në gjendje për të kontrolluar përdorimin e dhunës);
- b. të ardhurat (për të mbledhur fonde, veçanërisht nëpërmjet taksave);
- c. ligji (aftësinë për të sunduar përmes ligjeve) (Whaites, 2008: 8).

Fusha e tretë dhe zona e fundit e progresit thelbësor është realizimi i një niveli të "pritshëm" të funksionalitetit. Funksionet e pritshme të shteteve të suksesshme janë përpjekur për t'u mbajtur me kërkesat dhe ofrimin e mallrave e shërbimeve bazë (Whaites 2008: 9). Këto pritje, janë me fjalë të tjera përpjekjet e qeverive të përgjegjshme për të kryer çështjet që janë të rëndësishme për qytetarët dhe aktorët e jashtëm (të tilla si donatorë) (Whaites, 2008: 12).

Lidhur, me sa parashtruam më sipër, suksesi është evidentuar në Republikën e Kosovës, ku ndikimi i faktorit ndërkombëtar në procesin shtetndërtues ka evoluar me nota pozitive.

2.3.2 Modele të dështuara të shtetndërtimit

Me vendimmarrje politike, struktura shtetërore bëhet më e fortë, sepse ka krijuar një rrugë drejt shtetndërtimit të suksesshëm. Në të kundërt, disa vendimmarrje të "institucionalizuara" më shumë se të tjerat, do të thotë se kanë zhvilluar dhe kanë mbështetur institucionet formale. Vendimmarrjet e gabuara kanë shkaktuar shtete jo efektive, shtypëse dhe të korruptuara. Ajo që kemi nënvizuar është se disa vendimmarrje politike janë mbështetur në interesin vetë ose në besimin e elitave kryesore që ata i përkasin dhe në arsyen, se përse shpesh modelet e shteteve të dështuara kanë sjellë pasoja serioze në elektorat.

Natyra e strukturës së shtetit dhe rregullat politike mund kenë bërë shtetndërtime jofunksionale, të këqija. Struktura institucionale që u ndërtua keq politikisht ka sjellë pasoja në procesin e marrëveshjeve politike me prirje problematike e ka krijuar një demokraci të dobët.

Një problematikë që ka qenë e rëndësishme për të gjitha modelet e shteteve të dështuara ishte çështja e ideologjisë, ku disa vendimmarrje politike janë drejtuar nga besimi apo vizioni ideologjik që kanë pasur për shtetin apo për kombin. Në këto modele, shtetet janë karakterizuar nga mos stabiliteti, si edhe nga strukturat e dobëta apo nga krizat ekonomike ose nga konflikte të shpeshta.

Shumë shtete kanë shfaqur shenja të të dyja modeleve të suksesshme apo të dështuara të shtetndërtimit e kjo ka ndikuar edhe nga rezultatet e trashëgimisë historike e gjeografike të shteteve. Rëndësia e të dyja modeleve ka qëndruar tek natyra e vendimmarrësve politikë që janë dominantë në mënyrën e funksionalitetit të shtetit, konkretisht:

E rëndësishme është të kuptohet se si qeveritë janë formuar dhe kanë operuar, që ka përfshirë procesin elektorale, parlamentin, partitë politike, kabinetet dhe drejtuesit e shtetit (Whaites 2008: 11-14). Modelet e sugjeruara që kanë çështje prioritare dhe që bazohen në tri çështjet e shtetndërtimit janë:

a.vendimmarrjet politike;

b.mekanizmat e mbijetesës;

c.pritshmëritë janë një marrëveshje e madhe. (Whaites,2008).

Në këtë mënyrë, kemi sjellë në vëmendje si shembull përpjekjet e ndërkombëtarëve që janë bërë në Bosnje-Hercegovinë për të arritur sukses në përsosjen e shtetndërtimit të këtij vendi.

2.3.3 Përqasjet suplementare

Të përshkruash dhe të implementosh strategjitë e shtetndërtimit është e rëndësishme të marrësh në konsideratë të gjitha dimensionet e ndryshme teorike. Kemi marrë disa përjasje të tjera, për të cilat kemi menduar se është e nevojshme t'i marrësh në vlerësim. Përjasjet që kanë plotësuar teorinë e Whaites dhe që i kanë dhënë kuptim të detajuar procesit shtetndërtues janë shpjeguar nga autorë të ndryshëm dhe për këtë u jemi referuar: Ashraf Ghani, Clare Lockhart dhe Michael Carnahan, të cilët kanë argumentuar se mungesa e sovranitetit institucional është çështje fundamentale e një shteti të dështuar.

Sipas tyre, “operimi i një sistemi aktual ndërkombëtar mund të bëhet orientim drejt një modeli ku bashkëpunimi mes sovranitetit bëhet qëllimi liderëve kombëtarë dhe partnerëve ndërkombëtarë” (Ghani, Lockhart, Carnahan 2005: 13).

Aktorët e komunitetit ndërkombëtar kanë operuar në drejtime dhe me prioritete të ndryshme ku fokusi i çështjeve politike të Kombeve të Bashkuara apo organizatave të tjera si: NATO u janë përgjigjur çështjeve të institucioneve ndërkombëtare me mbështetje financiare dhe me zhvillimin e agjencive të përqëndruara në çështjet e zhvillimit social.

Çdo organizatë ka kulturën dhe veçantinë e vet, si edhe stimujt e rregullat e operimit. Gjithashtu, rëndësia që demokratizimi luan rol sinjifikativ në procesin e shtetndërtimit është mënyra e vetme për mbijetesën e shtetit. Tranzicioni drejt demokracisë është kompleks. Të ndërtosh demokracinë në një shtet është një sfidë e madhe për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm.

Aftësia për të ndërtuar institucione të suksesshme dhe një proces demokratik kërkon arritjen e disa niveleve mbrojtëse. Procesi i demokratizimit në një shtet kërkon nivel demokratik dhe institucione legjitime të shtetit, me qëllim që të parandalojë situatën, duke u fokusuar në alternativën e rritjes së shtetndërtimit demokratik. (Wolff 2011: 1779-1780).

Shtetndërtimi është një proces shumëdimensional ku vëmendje të veçantë ka procesi efektiv politik, nëpërmjet të cilit qytetarët dhe shteti mund të negociojnë kërkesat e ndërsjella, pritshmëritë dhe detyrimet. (Menocal 2011: 1719)

Whaites ka argumentuar se shtetndërtimi është marrëdhënia midis shtetit dhe shoqërisë. Koncepti i shtetndërtimit është kaq kompleks dhe duke iu referuar teorisë së Whaites mbi modelin e shtetndërtimeve të suksesshme dhe të dështuara, vendimmarrjet politike janë të rëndësishme për të arritur progresin e funksionalitetit. Argument dallues midis shtetndërtimit të suksesshëm dhe të dështuar është i thjeshtë, pasi sipas tezës së Whaites, është se çdo vend përballë me sfidat e veta historike dhe me nivelin e përgjegjshmërisë, apo me mos përgjegjshmërinë me kalimin e kohës.

Sipas tezave teorike të mësipërme kemi konstatuar, se çfarë shteti ka përparësi dhe çfarë e ndikon procesin shqiptar. Një përpjekje e madhe është përqëndruar tek siguria, por nëse mungesa e ligjit në anën tjetër mungon, ajo do të ketë një impakt në sigurinë e jetës duke rritur krimin. Një faktor kyç i shtetndërtimit shqiptar është të rritë të ardhurat dhe kjo mund të bëhet kryesisht nëpërmjet taksimit. Në vend që të mbledhësh taksa, shteti duhet të kishte fituar besimin e qytetarëve dhe kjo të shihej si legjitime. Modeli i shtetit është shoqëruar nga mungesa e transparencës dhe nga mos përgjegjësia, si edhe nga çështjet e korrupsionit që kanë penguar këtë mundësi për të rritur të ardhurat. Është e qartë se rritja ekonomike është një shtyllë e shtetndërtimit dhe procesi cilësor i shtetndërtimit do të nxiste rritjen ekonomike dhe kjo do të forconte në mënyrë të ndërsjelltë procesin e shtetndërtimit.

Funksionet pritëse kanë qenë gjërat e thjeshta që qytetarët kanë pritur nga qeveria e tyre, konkretisht si:

- shërbimi i kërkuar në (shëndetësi, arsim, drejtësi etj);
- mirëqenia ekonomike;
- punësimi dhe të drejtat sociale.

Qeveria duhet të ishte përgjegjëse, duhej të përpiqej t'i përmbushte këto kërkesa. Disa nga kërkesat duhej të arriheshin nga shteti përgjegjës. Ajo që është e rëndësishme për t'u parë në këto teori është që të gjitha këto dimensionë, pra vendimmarrjet politike dhe funksionet e pritshme të mbijetesës, kanë qënë të ndërlidhura e duhej të merrnin vëmendje të barabartë në mënyrë që shtetndërtimi të konsiderohej si proces i përgjegjshëm.

Komuniteti ndërkombëtar mundëj gjithashtu, së bashku me shoqërinë civile të inkurajonte këto marrëdhënie në shoqëri që do të ishin vlerë e madhe për shtetndërtim në vendin tone, i cili të ishte proces i suksesshëm dhe i përgjegjshëm. Aktorët e shoqërisë civile mund të ndihmonin në heqjen e hendekut midis shtetit dhe shoqërisë. Ajo mund të jetë ende një pengesë, në qoftë se qasjet e tyre nuk janë nga poshtë-lart.

Komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmonte për të stimuluar ndërtimin e shtetit të përgjegjshëm shqiptar duke e ndihmuar atë nga rreziku i mos përgjegjshmërisë nga ana e klasave politike. Mungesa e përgjegjshmërisë mund të ketë pasur arsye e kjo mund të jetë, një shkak drejt dështimit të shtetit siç ka nënvizuar (I, Lockhart dhe Carnahan)

2.4 Përpjekjet për të arritur një demokraci të mirë

Demokracia cilësore është demokraci e mirë. Duke filluar nga përcaktimi i përmendur më parë dhe nga nocionet aktuale të cilësisë, e kemi konsideruar cilësi ose demokraci të mirë, përfaqësimin e strukturës institucionale të qëndrueshme. Demokracia e mirë është para së gjithash e legjitimuar gjerësisht dhe që kënaq plotësisht qytetarët (cilësia në terma të rezultatit).

Kur insitucionet kanë përkrahjen e plotë nga shoqëria civile, ato mund të ndjekin vlerat e një sistemi demokratik. Në të kundërt, institucioni shtyn objektivat e veta dhe shpenzon energji në kërkimet drejt konsolidimit dhe në ruajtjen e legjitimitetit të tyre, duke kapërcyer edhe pragun për demokracinë. Një dukuri që e bën demokracinë të mirë janë vetë qytetarët që kanë fuqinë të kontrollojnë dhe të vlerësojnë sjelljet e veprimet e qeveritarëve, zbatimin e ligjit në fuqi. Efikasiteti i vendimeve të ndërmarra nga qeveria, përgjegjësitë politike dhe përgjegjësitë e zgjedhjeve zyrtare, duhet të jenë në lidhje me kërkesat e shprehura nga shoqëria civile.

Duke iu referuar çka përmendëm më lart, kemi parashtruar 5 dimensione të mundshme, në të cilat demokracia e mirë ka qenë në qendër të analizës. Dy dimensionet e para kanë qenë proceduriale, megjithëse kërkonin përshtatje të përmbajtjes. Këto përmasa kryesore i përkasin rregullave, ku dimensionin e parë procedural është përgjegjësia. Dimensionin e parë përmban reagimet ose korrespondencat e sistemit të dëshirave të qytetarëve dhe të qeverisë në tërësi. Të dy dimensionet kryesore janë me natyrë të pavarur e konkretisht:

- E para, është respekti i plotë për të drejtat, të cilat janë të zgjeruara nëpërmjet arritjes së shtrirjes së lirisë;
- E dyta, është zbatimi i politikës institucionale, e cila identifikohet me 5 dimensione, por në analizën e më poshtme janë të përpunuara në tri çështje :
 1. Analiza analitike synon studime të ndryshme në cilësinë e demokracisë, si atë të Altman dhe Perez-Linan (2001) dhe Lijphart (1999), ndërkohë që të dy studimet janë gjithashtu të bazuara në tregues të përfshirë nga disa prej elementëve të diskutuara më lart. Ata nuk e kanë konsideruar gjithçka të tyre dhe pasoja e analizës është e limituar. Altman dhe Perez-Linan kanë shtjelluar tre aspekte që përputhen me konceptimin e Dahl's te poliarkia
 - 1.1. të drejtat civile;
 - 1.2. pjesëmarrja
 - 1.3. konkurrimi.

të cilat i përshtaten dimensionit të pavarur, i treguar edhe më parë.

2. Analiza e tij i afrohet asaj të Beetham (Spec, 1999), i cili ka theksuar kombinimin e nevojshëm kualitativ dhe masat cilësore në analizat e përgjithshme të fenomenit. Disa ndryshime kanë dalë menjëherë, në përfundimim e demokracisë së mirë.
3. Institucionet dhe mekanizmi i demokracive përfaqësuese janë objektet kryesore të analizës së cilësisë demokratike. Kjo nuk është për të shmangur demokracinë e drejtëpërdrejtë, si shprehja më e lartë e cilësisë demokratike, por për të vërtetuar eksperiencën laike të përfaqësuesve demokratë dhe potencialin e tyre të vërtetë për përmirësimin e situatës. Nëse analiza, duhet të përqendrohet në demokracitë përfaqësuese, atëherë përgjegjësia është tipar kryesor në eksperiencën e përfaqësimit të demokracisë - bëhet dimension kryesor i vërtetë, si në grantet e qytetarëve edhe të shoqërisë civile në përgjithësi, fokus grup i kontrollit të insitucionit politik. Ky tipar ka lehtwsuar vështirësitë, të cilat objektivisht egzistojnë, kur përbëjnë vështirësi të drejtëpërdrejtë në demokracinë përfaqësuese. Le të ndalemi më konkretisht:

Llogaridhënia është e bazuar në dy supozime nga tradita liberale që ka nxjerrë në pah ndërlidhshmërinë e të gjitha dimensioneve që janë shpjeguar më lart :

a) Supozimi i parë është, nëse qytetarët kanë dhënë mundësinë për të vlerësuar përgjegjësinë e qeverisë në termat e kënaqësisë së nevojave dhe të kërkesave të tyre. Në fakt, ata duhet të jenë të aftë të zotërojnë drejt e saktë nevojat e tyre.

b) Supozimi i dytë, ka qënë se qytetarët, vetëm ose si pjesë të një grupi, janë gjyqtarët e vetëm të nevojave të tyre personale dhe asnjë palë e tretë nuk mund të vendosë për nevojat e tyre.

Nuk mund t'i linim këto supozime të papërmendura. Ato duhet të shpallen dhe të merren në llogari që nga fillimi. Është e gabuar ta konsiderosh secilën nga ato, si një zgjedhje të thjeshtë ideologjike. Është e rëndësishme të njohësh që demokracitë perëndimore kanë ndjekur një trajektore të një demokracie të lirë dhe çdo analizë konkrete e cilësisë së demokracisë duhet ta llogaritë këtë dhe të drejtohet drejt barazisë.

- 1 Liri dhe barazi, edhe pse shpesh keqkuptohen, janë të lidhura ngushtë edhe në përgjegjësi. Në të vërtetë, zbatim i lartë i lirisë për qytetarët dhe shoqërinë civile, qëndron në sferën e mekanizmave përfaqësues. Veç kësaj, rregulli efektiv i ligjit është gjithashtu i domosdoshëm për një demokraci të mirë. Rregulli i ligjit është i gërshetuar me lirinë në respekt të gjithë atyre që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi sanksionojnë të drejtat dhe krijojnë kushtet për realizimin e tyre konkret. Kemi shpjeguar se konceptet: **liri, barazi dhe përgjegjësi** në fakt janë të paarritshme, nëse respekti për ligjin nuk është efektiv dhe nuk është zbatuar nga qeveria e administrata. Këto janë çështje themelore të nevojshme për të vendosur e për të realizuar politikat cilësore të demokracisë.
- 2 Subjektet kryesore të demokracisë janë: qytetarët, komunitetet territoriale dhe varietetet e formave në bashkëpunim me vlerat e përbashkëta, me traditat ose qëllimet. Në këtë kuptim, mundësia për një demokraci të mirë egziston, jo vetëm në rast të një territori të përcaktuar me një popullsi specifike të kontrolluar nga institucionet shtetërore nën qeverisjen demokratike, por gjithashtu për një entitet më të gjerë. Qëllimi kryesor ka qënë që subjektet e lartpërmendura të jenë në zemrën e një demokracie, në të cilën proceset më kryesore janë ato që punojnë në rrugë të drejtë dhe jo anasjelltas. Në këtë mënyrë, transferimi i analizave të dimensioneve nga niveli ndërkombëtar tek niveli kombëtar është i mundur dhe procesi është i

komplikuat e pa vështirësi. Çelësi i suksesit është të mbajë në mënyrë konstante karakteristikat e çdo dimensionit.

- 3 Nevoja për të kapur kompleksitetin e pandashëm në nocionin e “cilësisë”, ku demokracia motivon e ndihmon përdorimin e pesë dimensioneve të përmendura më lart.
Aanaliza ka pasqyruar disa tregues që kanë zbuluar se në çfarë shkalle secili dimension është i pranishëm, jo vetëm në shtete të ndryshme, por edhe në modele të ndryshme të një demokracie të mirë. Këto të dhëna jo empirike duhet gjithashtu të mundësojnë ndjekjen përfundimtare të rritjes së një demokracie cilësore.
- 4 Dimensionet themelore të cilësisë së demokracisë, kanë qënë të lidhura me kushtet thelbësore për egzistencën e tyre. Dimensionit i parë procedural ka përcaktuar rezultate të rëndësishme për aplikimin dhe përbërjen e tij sipas rregullave. Dimensionet e dyta janë në lidhje me ndërthurjen midis të dhënave të brendshme dhe të jashtme. Egziston një literaturë e gjerë e këtyre dy dimensioneve, ku secili dimension është analizuar i lidhur me tre aspekte:
 - a. përfundimin empirik;
 - b. problemet e implementimit;
 - c. kushtet kryesore.
- 5 Zbatimi i ligjit nuk është vetëm zbatim i normave ligjore. Ato duhet të njohin epërsinë kryesore të ligjit, që është Ciceronian *legume servi sumus* dhe sjell së fundmi kapacitetin, edhe nëse do të ishte e limituar, që t’i bëjnë autoritetet të respektojnë ligjet, të cilat duhet të ishin joprapaveperuese, universale, të qëndrueshme dhe të qarta. Këto karakteristika janë përfundimtare për çdo çështje civile dhe kërkesat themelore për konsolidimin e sistemit demokratik. (Morlino, 1998).
- 6 Edhe pse zbatimi i ligjit është i ruajtur dhe i respektuar në forma, variante dhe në shkallë të ndryshme, ne mund të identifikojmë një numër të karakteristikave e të kritikave të veçanta në analizën e “demokracisë së mirë”.

Këto janë:

- Aplikacioni *erga omnes* të sistemit legal, gjithashtu në nivelin super kombëtar, duke siguruar të drejtat dhe barazinë e qytetarëve;
- Mungesën e nivelit lokal të dominuar nga krimi i organizuar;
- Mungesa e korrupsionit në politikë, administratë dhe degët ligjore;
- Egzistencën e sistemit vendor, të centralizuar, qytetari burokratike dhe të konkurrueshme, produktive e aplikime kombëtare që ligjërohen e pranojnë përgjegjësitë në raste gabimi;
- Egzistenca e policisë efikase që forcon dhe respekton të drejtat dhe liritë e siguruar nga ligji.

Gjithçka u përmend më sipër, qëndron në aplikimin produktiv të ligjit dhe në zgjidhjen e drejtë. Të dhënat e përshtatshme janë analizuar rast pas rasti duke përdorur të dyja teknikat:

a. cilësore,

b. sasimore.

Në qendër të analizës kemi shtruar pyetjen se cilat janë kushtet fundamentale që kanë lejuar, së pakti zhvillimin e moderuar të shtetit ligjor?

Dimensionet e ndryshme të demokracisë kanë sugjeruar e sugjerojnë se përhapja e vlerave liberale e demokratike e veçanërisht niveli i elitës, po ashtu edhe egzistenca e traditave burokratike, legjislativë dhe ekonomike kanë nënkuptuar rëndësinë për veprimtarinë e tyre, çka janë kushtet e nevojshme për zbatimin e shtetit ligjor e demokratik.

Sido qoftë, këto kushte egzistojnë në shumë pak shtete dhe janë shumë të vështira për t'u krijuar. Si pasojë, është gjithashtu e vështirë të kultivosh dhe të rritësh këtë dimension të cilësisë demokratike në një shtet.

Dimensioni i dytë i cilësisë së demokracisë që konsiderohet, është detyrimi i liderëve që zgjidhen nga zgjedhjet politike, të cilët duhet të përgjigjen për vendimet e tyre politike, kur ato kërkohen nga qytetarët. Schedler (1999:17) ka sugjeruar që llogaridhënia ka disa tipare kryesore:

a. informacioni;

b. justifikimi;

c. dënimi/kompensimi.

Informacioni, akti politik ose llojshmëria e akteve nga një politikan ose organi politik (qeveria, parlamenti etj), e kanë pasur plotësisht të mundur të ndërmerrnin përgjegjësitë e duhura e të nevojshme.

Justifikimi i është referuar arsyeve që kanë drejtuesit qeveritarë për aktet ose për vendimet e tyre.

Dënimi/kompensimi, janë pasoja nga kushdo tjetër duke ndjekur vlerësimin e informacionit, e justifikimit, të aspekteve të tjera dhe të interesave politike. Të tria këto cilësi kërkojnë që duhet të egzistojë dimensionin publik që të jetë i karakterizuar nga pluralizmi, pavarësia dhe pjesëmarrja e aktorëve kolektivë.

Të japësh informim të saktë të procesit politik, duke i pasqyruar ato në momentet e informacionit, justifikimit dhe vlerësimit, politikanët kanë mundësi të manipulojnë në një mënyrë që të shfajësojnë veten e tyre nga çdo përgjegjësi konkrete. Edhe shtetet e Evropës gjejnë vështirësi në sigurimin e llogaridhënies për shkak të ekzistencës së dimensionit mbikombëtar të krijuar nga Bashkimi Evropian. Shembulli më i përshtatshëm, se si qeveritë në këto shtete shmangin përgjegjësinë, është taktika e “fajit të zhvendosur”.

Përgjegjësia politike për çdo vendim jo popullor i marrë nga qeveria është ndryshuar nga niveli evropian, edhe nëse ata e konsiderojnë një çështje të qartë si: përpunimi i administratorëve nacionalë ose riorganizimi i shteteve financiarisht që mund të përballonin problematikat e deficitet e gjera kombëtare. Qeveria ose administratorët kombëtarë justifikojnë veprimet e bëra në një opozitë publike të gjerë duke qartësuar se marrëdhëniet ishin forcuar nga koalicionet kundërshtarë në Këshillin e Ministrave të Bashkimit Evropian, në Këshillin Evropian dhe nga kryeministrat e shteteve, ose nga votat e Parlamentit Evropian.

Metoda më produktive për evidentimin e dimensioneve ndaj reagimeve ka qenë ekzaminimi i legjitimitetit të qeverisë, ka qenë ë perceptimi i qytetarëve për reagimet, ndaj realitetit. Kjo ka

çuar në procesin fundamental të konsolidimit të demokracisë (Morlinno 1998), por në mënyra të ndryshme.

Në fakt, disa dinamika që kanë krijuar mundësinë për konsolidimin demokratik në shumë shtete, si :

- pranimi jo kritik i institucioneve në vend;
- bindjet e lehta për alternativa më të mira;
- kujtesat negative të së shkuarës;
- nuk janë më të përshtatura me terminologjinë legislative etj.

Element kyç ka qenë mbështetja e institucioneve demokratike dhe besimi se këto institucione janë sigurimet e vetme për lirinë dhe barazinë. Është i përhapur në çdo nivel social nga elitat. Përhapja e sjelljeve të favorizuara të institucioneve të demokracive egzistuese dhe aprovimi i veprimtarive të tyre, kanë sugjeruar rezultate, në mënyrë indirekte tek shoqëria civile.

Në analizat e tyre nuk kanë hezituuar Pharr dhe Putnam (2000) të përdorin termin e “demokracisë së cënuar” dhe së bashku kanë theksuar rënien e aftësisë së aktorëve politikë për të vepruar në lidhje me interesat dhe dëshirat e qytetarëve. Në analizat e tyre ata kanë pasqyruar dhe argumentuar rënien e fazave të demokracisë të shtetesh të papërgjegjshme.

Kapitulli III

Impakti Organizatave Ndërkombëtare Universale e Rajonale në Përsosjen e Demokratizimit.

3.1 Vështrim i shkurtër mbi institucionet ndërkombëtare universale

Evoluimi i kombit-shtet modern dhe krijimi i sistemit të së drejtës ndërkombëtare, i mbështetur mbi një numër në rritje të bashkësive territoriale të pavarura e sovrane, në mënyrë të paevitueshme nxiti çështjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Forma e parë domethënëse e bashkëpunimit ndërkombëtar të organizuar është Paqja e Vestfalisë në vitin 1648, e cila i dha fund konfliktit 30-të vjeçar të Evropës Qendrore dhe zyrtarisht themloi sistemin politik të Evropës, mbështetur në shtetin komb sekular.

Organizatat (ose institucionet ndërkombëtare) tashmë janë bërë të domosdoshme. Në botën e globalizuar ato thjeshtojnë bashkëpunimin përgjatë kufijve shtetërorë, duke i hapur rrugë identifikimit, diskutimit dhe zgjidhjes së vështirësive në shumë sfera, duke filluar prej ruajtjes së paqes e duke vazhduar me zgjidhjen me mjete paqësore të shqetësimeve ekonomike, mjedisore, të të drejtave të njeriut etj. Ky dimension i sistemit juridik ndërkombëtar ka lejuar krijimin relativisht me shpejtësi të rregullave të reja, modeleve të reja të drejtimit, si edhe të mekanizmave bashkërendues.

Organizatat ndërkombëtare (ON) kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare. Veprimtaria e shteteve në këto organizata po bëhet gjithmonë e më shumë faktor i rëndësishëm i krijimit të normave të së drejtës zakonore në marrëdhëniet ndërkombëtare. Shembull tipik në këtë drejtim është OKB, nëse mbajmë parasysh numrin e madh të vendeve anëtare në këtë organizatë, fushën e gjerë të veprimtarisë dhe interesit të saj edhe pse, jo çdo praktikë e saj domosdoshmërisht ka çuar në krijimin e normave të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Në këtë kontekst duhen analizuar gjithmonë elementët e “detyrimit për zbatim” dhe “*opinio iuris*”- shih burimet e DNP).

Nga ana tjetër edhe normat e DNP kanë ndikuar në punën e ON-së për këto arsye :

- Së pari, këto norma kanë shërbyer si bazë për të orientuar punën e institucioneve ndërkombëtare;
- Së dyti, këto norma kanë luajtur rol në parandalimin e sjelljeve që bien ndesh me të drejtën ndërkombëtare.

Në të shkuarën organizatat ndërkombëtare janë përkufizuar nëpër statute thjesht si “organizata ndërqeveritare”, me qëllim që të vinin në dukje se karakteristika kyçe e grupimeve të tilla ishte se anëtare të tyre ishin shtetet (Konventën e Vjenës, 1975-1986) Megjithatë, Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare në nenin 2 të Draft Neneve për Përgjegjësinë e Organizatave Ndërkombëtare i është referuar “çdo organizatë të themeluar me marrëveshje ndërkombëtare, apo tjetër dokument, që administrohet (njihet) nga e drejta ndërkombëtare dhe që ka personalitet juridik”, ndërkohë që parashikohet se anëtarë të një organizate ndërkombëtare, përveç shteteve mund të jenë edhe entitete të tjera (që nuk kanë fituar ende statusin e shtetit).

Pra, e rëndësishme është që të dallohen organizatat ndërkombëtare prej organizatave private jo-qeveritare si dhe prej shoqërive ndërkombëtare publike. Organizatat ndërkombëtare mund të kenë anëtarësi të gjerë, të hapur, apo universale (siç janë OKB, apo agjencitë e specializuara), por mund të kenë edhe një numër anëtarësh të kufizuar, ose të mbyllur (siç janë psh Bashkimi Europian apo OSBE. Si ka nënvizuar prof. Ksenofon Krisafi, lidhur me hyrjen në organizatat e mbyllura se “...nuk mjafton vetëm paraqitja e kërkesës formale, as edhe vetëm shprehja e gatishmërisë e dhënia e garancive nga ana e shtetit kërkues për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet e përcaktuara në aktin themelues. Kërkohet edhe plotësimi i disa kushteve të tjera, siç është marrja e pëlqimit paraprak nga të gjithë shtetet e tjera anëtare, sepse ata nuk mund të jenë të interesuar për hyrjen e shteteve të tjerë, të cilët kur vendosën themelimin e organizatës, gjykuan nga objekti i veprimtarisë së saj, nga përfitimet që do të realizonin si dhe nga rrethi i shteteve pjesëmarrës. Shtetit kandidat, mund t’i kërkohet gjithashtu plotësimi i një apo disa kushteve specifike. Kjo është rruga që duhet të ndjekin edhe shtetet e tjera që dëshirojnë të bëhen anëtarë të BE-së”. (K.Krisafi, 2015:203)

Organizatat mund të krijohen për ushtrimin e funksioneve mjaft të gjera, ose thjesht për ushtrimin e një numri të kufizuar funksionesh, në varësi të parashikimeve të Statuteve të tyre.

Nëse një grupim do të ketë apo jo statusin e organizatës varet prej faktit, nëse ajo plotëson kriteret e sapopërmendura.

Shteteve që aspirojnë për t'u pranuar në organizatat ndërkombëtare mund t'u duhet një punë e madhe për të kapërcyer formalitetet dhe procedurat e nevojshme për pranim.

Veçanërisht të vështira dhe të komplikuar janë procedurat për të arritur pranimin e një shteti në Bashkimin Evropian. Edhe pse parimisht është i hapur për çdo shtet evropian që respekton parimet e përcaktuara nga neni 6-të, i variantit të konsolidimit të Traktatit mbi Bashkimin Evropian, parashikohet kalimi i një faze paraprake, gjatë së cilës shteti përkatës duhet të demonstrojë se është i aftë të respektojë atë që quhet “*acquis communautaire*”.

“Procesi i anëtarësimit mbështetet në Strategjinë e paraanëtarësimit, e cila përmban edhe instrumenta të tillë si : ndihma ekonomike dhe teknike. Anëtarësimi varet nga përparimi i arritur nga vendi kandidat, i cili matet rregullisht dhe ndiqet nga Komisioni”. (K.Krisafi, 2015:203)

3.2 Besueshmëria dhe Personaliteti i Organizatave Ndërkombëtare

Organizatat ndërkombëtare mund të shfaqen si subjekte me personalitet juridik të pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo nënkupton që këto organizata kanë të drejta dhe detyrime, si dhe nuk funksionojnë të kushtëzuara prej kufizimeve të sistemeve të brendshme të së drejtës. Sidoqoftë, jo çdo akt themelimi i organizatave ndërkombëtare ka krijuar subjekt të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përgjithësisht, në aktet e themelimit të ON-ve vendet anëtare shprehen, nëse ON gëzon personalitet juridik të pavarur. Megjithatë, ka edhe akte themelimi në të cilat vendet themeleuese nuk janë shprehur, nëse organizata në fjalë gëzon apo jo statusin e subjektit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në këtë rast, kur në aktin e themelimit nuk gjendet ndonjë rregullim lidhur me statusin e organizatës, çështja e personalitetit juridik të saj bëhet objekt i interpretimit. Interpretimi zakonisht mbështetet në elementë të tillë si mandati, qëllimi dhe veprimtaria e organizatës.

Personaliteti juridik në marrëdhëniet ndërkombëtare, sidoqoftë nuk duhet ngatërruar me të qenit subjekt në marrëdhëniet e brendshme. Në disa akte themelimi ka parashikime të shprehura, në të

tjerat të nënkuptuara, që u mundësojnë ON-ve të drejta për të blerë, për të shitur, apo për të marrë me qera një pronë, të lidhin marrëveshje, apo të ngrenë padi në gjykatat e brendshme. (statutin e FMN, BNRZH) Kështu psh, nëse do t'i referohemi nenit 104 të aktit të themelimit (Statutit) të OKB-së do të vërejmë, se organizata gëzon personalitet juridik në territoret e vendeve anëtare, përsa nevojitet, në interes të kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së qëllimeve të saj. Ky parashikim nënkupton, se vendet anëtare të organizatës janë të detyruara të njohin personalitetin juridik të kësaj të fundit në sistemet e tyre të brendshme të së drejtës. Mënyra se si realizohet kjo ndryshon nga shteti në shtet në varësi të veçorive të sistemeve të tyre të brendshme.

Këtu shtrohet pyetja, nëse ato vende, të cilat nuk janë anëtare të një organizate ndërkombëtare janë apo jo të detyruara ta njohin, ta pranojnë atë (organizatën) si subjekt të pavarur në sistemet e tyre të brendshme. Praktika e ndjekur deri më tani varion. Kështu psh ka vende, të cilat në mënyrë të heshtur (psh. duke hyrë në marrëveshje me organizatën) pranojnë personalitetin juridik të saj, ose e pranojnë atë në mënyrë indirekte me anë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Shumë organizata kanë nevojë të veprojnë në territoret e shteteve të caktuar dhe në këtë kuptim ato kanë nevojë që personaliteti juridik i tyre të njihet jo vetëm në të drejtën ndërkombëtare, por edhe në sistemet e brendshme të shteteve në fjalë, me qëllim që ato të kenë mundësi të ngrenë padi, të mbrohen dhe të kryejnë të tjera veprime juridike. Kjo mund të arrihet në forma të ndryshme.

Në disa raste është kompetencë e gjykatave të brendshme, të cilat duke interpretuar legjislacionin e brendshëm, ose të drejtën ndërkombëtare të konkludojnë lidhur me këtë çështje. Në çdo rast, nëse një organizatë, sipas së drejtës ndërkombëtare është pranuar si subjekt, kaq do të mjaftojë për t'a njohur atë si të tillë edhe në të drejtën e brendshme. Pra, nëse shtetet gëzojnë tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve të njohura shprehimisht prej së drejtës ndërkombëtare publike, “të drejtat dhe detyrimet e çdo entiteti që konsiderohet Organizatë do të varen prej qëllimeve dhe funksioneve të parashikuara në formë të shprehur, apo të nënkuptuara në aktet e tyre të themelimit dhe të zhvilluara në praktikë”. Se për çfarë kompetencash dhe personaliteti juridik

bëhet fjalë në mënyrë precize, pra, do të varet praktikisht nga analizimi i kujdesshëm i vetë organizatës, përfshirë lidhjen që ekziston midis këtyre kompetencave dhe personalitetit juridik me qëllimet dhe detyrat e shprehura të asaj organizate.

Krijimi i ON-ve me personalitet juridik ndërkombëtar ka sjellë si rezultat krijimin e një subjekti të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare që ndryshon dhe veçohet prej shteteve themeluese. Ky fakt sigurisht bën që ON-të të kenë pasoja, nëse bëhen përgjegjëse për ndonjë shkak gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Sigurisht, në mënyrë më të qartë natyra e përgjegjësisë ka qenë e lidhur me rrethanat konkrete të çështjes dhe padyshim edhe prej analogjive të bëra me rregullat për përgjegjësinë ndërkombëtare të shteteve, duke pasur parasysh kushtet në të cilat do të shpallej përgjegjësia. Pra, shkurtimisht baza e përgjegjësisë ndërkombëtare është shkelja e detyrimeve ndërkombëtare dhe sigurisht detyrimet janë të ndryshme në varësi të situatave.

Ashtu si çdo shtet mban përgjegjësi përballë organizatës për shkeljet e kryera, ashtu edhe çdo organizatë mban përgjegjësi përballë shteteve për shkeljet e traktateve, ose parimeve apo normave të së drejtës zakonore ndërkombëtare. Përsëri mund të bëhet analogji përse i takon rregullave të atribuimit të përgjegjësisë së organizatave. Konkretisht, të gjitha sjelljet e organeve, apo zyrtarëve të organizatës gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (përfshirë këtu çdo lloj zyrtari, apo entitetesh të tjera nëpërmjet të cilave veprojnë organizatat) konsiderohen sjellje të organizatave, pavarësisht ku është i vendosur organi, apo zyrtari në hierarki, madje ky rregull vlen edhe për shkeljet e kryera në tejkalim të kompetencave.

“Përgjegjësia juridiko-ndërkombëtare ka përbërë njëkohësisht edhe një nga problematikat e rëndësishme të teorisë me praktikën ndërkombëtare në përgjithësi dhe një nga aspektet thelbësore të spektrit të gjerë të problematikës së subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, në veçanti. Rëndësia e saj qëndron në faktin se e drejta ndërkombëtare, mund ta kryejë rolin e vetë si rregullues i marrëdhënieve midis subjekteve të saj vetëm në kushtet e krijimit të një rregjimi të rreptë të ligjshmërisë ndërkombëtare”. (Krisafi,2015:344)

Është e rëndësishme përgjegjësia e shteteve për administrimin e mirë institucionale në momentin e përfshirjes në organizatat ndërkombëtare, por përgjegjësitë janë të përbashkëta edhe vetë organizatat janë përgjegjëse ndaj shteteve, nëse ato nuk respektojnë kompetencat. Kanë përgjegjësi ndërkombëtare përse organizata kishte dijeni për rrethanat e sjelljes në fjalë dhe përse kishte dijeni, se sjellja do të konsiderohej në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare publike po ta kryente ajo vetë.

3.3 Tipologjia e Organizatave Ndërkombëtare Universale

Organizatat (ose institucionet ndërkombëtare) tashmë janë bërë të domosdoshme. Në botën e globalizuar ato thjeshtojnë bashkëpunimin përgjatë kufijve shtetërorë, duke i hapur rrugë identifikimit, diskutimit dhe zgjidhjes së vështirësive në shumë sfera, duke filluar prej ruajtjes së paqes e duke vazhduar me zgjidhjen me mjete paqësore të shqetësimeve ekonomike, mjedisore, të të drejtave të njeriut etj. Ky dimension i sistemit juridik ndërkombëtar ka lejuar krijimin relativisht me shpejtësi të rregullave të reja, të modeleve të reja të drejtimit, si edhe të mekanizmave bashkërendues.

Një nga sfidat e sotme të organizatave ndërkombëtare është edhe klasifikimi i tyre, sipas tipologjisë operationale. Ajo që vihet re në terminologjinë e marrëdhënieve ndërkombëtare e që quhen fenomenet e universalizimit (që shfaqet tek OKB), atlantizimit (rasti tipik është NATO), rajonalizimit (një shembull është BE). Për t'u orientuar në numrin e madh të formacioneve që e quajnë veten organizata ndërkombëtare, për të saktësuar statusin juridik, për të përcaktuar qëndrimin ndaj tyre dhe trajtimin që duhet t'u bëhet, si dhe për qëllime studimi, doktrina i klasifikon ato në disa grupe. Një element plotësues që do të ndihmonte në klasifikimin, mund të ishte karakteri i organeve të tyre në kuptimin që disa kanë karakter hibrid, disa të tjerë janë të pavarur, të varur apo gjysmë autonome. (K. Krisafi: 2015, p. 260).

Rëndësia e këtij klasifikimi qëndron gjithashtu edhe në pozitën gjeografike të ushtrimit të juridiksionit të Organizatave Ndërkombëtare (ON), sikurse e analizon edhe profesor Ksenofon Krisafi dhe që, sipas këndvështrimit të tij, orientimi gjeografik rajonal ose universal i përbërjes

dhe i veprimtarisë, përfshirë këtu edhe karakterin heterogjen ose jo të anëtarësisë, kompleksitetin strukturor etj. (K. Krisafi:2015, p.260)

Por, të gjithë këta elementë janë parashtruar në analizën e studimit tonë duke shpalosur shumëllojshmërinë e funksionalitetit që kanë organizatat. Analiza teorike e rolit dhe e rëndësisë së OKB-së me karakter universal ka pasqyruar studimin teorik e analitik të potencialit të saj global, për të realizuar shtetndërtimin në shtetet e dobëta. Shpërndarja e vlerave demokratike dhe e qeverisjes së mirë, një nga parimet e funksionalitetit të OKB-së ka krijuar mundësinë e skenarit teorik për t'u implementuar në vendet e dobëta nëpërmjet organizatave ndërkombëtare.

3.3.1 Rëndësia e politikave globale të Kombeve të Bashkuara (OKB), drejt demokratizimit të shteteve

OKB u themelua pas Luftës II Botërore mbi bazën e planeve dhe të qëllimeve të shprehura gjatë konfliktit në fjalë (Shih Statutin e OKBse). Qëllimet e themelimit të OKB-së janë parashikuar në nenin 1 të statudit të organizatës, si vijon:

- 1.1 Të ruajë paqen dhe sigurinë botërore dhe për këtë qëllim të marrë masa efektive kolektive për parandalimin dhe evitimin e kërcënimeve ndaj paqes, eliminimin e akteve të tjera të agresionit dhe shkeljeve të tjera të paqes, si edhe të paqtojë/të zgjidhë me mjete paqësore mosmarrëveshjet ndërkombëtare, të cilat mund të shpien në cënimin e paqes, sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare;
- 1.2 Të zhvillojë marrëdhënie miqësore midis kombeve, mbështetur në respektin për parimin e të drejtave të barabarta dhe të drejtën e popujve për vetvendosje si dhe të marrë të tjera masa të përshtatshme për të forcuar paqen universale;
- 1.3 Të sigurojë bashkëpunim ndërkombëtar për të zgjidhur problemet ndërkombëtare me karakter ekonomik, social, kulturor, humanitar, si edhe për të promovuar e inkurajuar respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjithë, pa dallim race, seks, gjinie apo feje, si dhe të shërbejë si qendër për të harmonizuar veprimet e kombeve në arritjen e këtyre qëllimeve të përbashkëta.

Çështja se cili prej qëllimeve, sa më sipër, duhet të ketë përparësi është gjithmonë objekt i kundërshtive dhe i ndryshueshëm në mënyrë të vijueshme, duke reflektuar presionin e vazhdueshëm e ndryshimin e balancave brenda organizatës. P.sh. vendosja e theksit tek vetëvendosja dhe dekolonizimi, apo aparteidi shpunë në zgjerimin e anëtarësisë në OKB dhe në shuarjen e perandorive kolonizatore.

Statuti i OKB-së nuk është vetëm një traktat shumëpalësh, me anë të të cilit u themelua OKB-ja dhe u përcaktuan të drejtat e detyrimet e shteteve që e themeluan atë, por statuti gjithashtu është edhe kushtetuta e OKB-së, ku parashtrihen të drejtat dhe kufizimet e vetë organizatës. Në këtë dokument, njihet pavarësia dhe sovraniteti i vendeve anëtare. Sipas nenit 2(9) të Statutit të saj, OKB nuk mund të ndërhyjë në çështje, të cilat në thelb janë pjesë e juridiksionit të brendshëm të shteteve, me përjashtim të rasteve, kur duhen zbatuar masat, sipas Kapitullit VII të Statutit të Organizatës.

“Në varësi të karakterit të aktit themelues, disa organizata universaliste mund të jenë të mbyllura, në kuptimin që pranimi i shteteve të tjerë, nuk bëhet me shfaqjen e dëshirës apo formulimin e kërkesës për pranim, por me miratimin e shteteve të tjera anëtare. OKB-ja, e cila ka një karakter të tillë universalist, ku pranimi i shteteve si anëtare të saj kërkon plotësimin e disa kriterëve dhe kushteve”. (K.Krisafi:2015, p.265)

Nevoja e demokratizimit në nivel ndërkombëtar është e lidhur me tre fronte. Sistemi i themeluar i Kombeve të Bashkuara në vetvete për të shkuar përpara në masën e përmbushjes së mundshme demokratike. Potenciali i pasqyruar edhe në transformimin e atyre strukturave, të cilat kanë pasur mungesë demokracie. Pjesëmarrja e aktorëve të rinj në skenën ndërkombëtare është fakt i pranuar, duke u dhënë atyre mjete të dakordësuara të pjesëmarrjes në sistemin formal, deri tani të përealizuara kryesisht tek shtetet e dobëta dhe është detyrë e re e kohës sonë.

Ndër sfidat, e cila ka qenë për arritjen e kulturës së demokracisë ndërkombëtare. Kjo, jo vetëm që ka kërkuar shoqërinë e shteteve të angazhuar për parimet demokratike dhe proceset, por ajo gjithashtu do të kërkojë zgjerimin drejt shoqërisë civile ndërkombëtare, duke u përfshirë thellë në institucionet demokratike të shtetit.

Politika e Kombeve të Bashkuara ka ndikuar për të lehtësuar koordinimin në mesin e aktorëve ndërkombëtarë të angazhuar për ndërtimin e institucioneve drejt demokratizimit. Kombet e Bashkuara kanë një rrjet global komisionesh ekonomike, sociale dhe zyra në vende të ndryshme.

Politika e Kombeve të Bashkuara përfshin çështjet e së drejtave ekonomike, sociale, të sigurisë, politike, humanitare, njerëzore etj. Këto janë arsyt pse Kombet e Bashkuara janë aktive pothuajse në të gjithë gamën e çështjeve të rëndësishme për demokratizimin dhe ajo mund të ndihmojë në integrimin e këtyre çështjeve në përpjekje më të gjerë që lidh mjetet paqeruajtëse, lehtësimin e përpjekjeve, rindërtimin dhe zhvillimin. Vetë Kombet e Bashkuara janë përgjegjëse për shumë nga aktorët ndërkombëtarë të angazhuar në ndërtimin institucional drejt demokratizimit.

Në ndërtimin e institucioneve për demokratizimin, detyra e koordinimit në mes të aktorëve ndërkombëtarë është në thelb më komplekse dhe e vështirë, sesa në fushën e zgjedhjeve. Ndërtimi i institucioneve për demokratizim, përfshin një grup shumë më të madh dhe më të larmishëm aktorësh. Ai shtrihet drejt zonave të reja dhe me veprimtari më të gjerë ndërkombëtare, së cilës, ndryshe nga asistenca elektorale, i mungon struktura organizative.

“Koordinimi i aktorëve ndërkombëtarë është thelbësor për të shmangur këshilla kontradiktore nga konsulentët teknikë, apo vëmendje tepër e veçantë për aspekte të procesit të demokratizimit në dëm të të tjerëve. Kjo mund të çojë drejt çekuilibrit në mes të kapaciteteve të shtetit dhe institucioneve. Ndonjë ose të gjitha këto rezultate mund të dëmtojnë përpjekjet e përgjithshme për të konsoliduar demokratizimin. Kombet e Bashkuara shërbejnë për koordinimin e për ndërtimin e institucioneve duke forcuar koordinimin në kuadër të kornizës së vet organizative dhe në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara si një e tërë”. (B.Gali,2013)

“Komiteti Administrativ për Koordinim, strukturë e rëndësishme e OKB-së, e kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj, përbëhet nga drejtuesit ekzekutivë në të gjitha Programet e Kombeve të Bashkuara e agjencitë e specializuara, duke përfshirë Institucionet e Bretton Woods, punon për të nxitur një ndarje efektive të punës brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe për të nxitur iniciativat drejt objektivave të përbashkëta. Një pjesë e rëndësishme e kësaj përpjekjeje ka qenë edhe roli që ka struktura e Koordinator Rezident i Kombeve të Bashkuara, që ka

projektuar programimin e koordinimin efektiv, ndërmjet të gjithë aktorëve ekonomikë e socialë në nivel shteti”(B.Gali,2013)

Politika e Kofi Anan, u përqendrua për të ndërtuar praktikën e promovimit të demokracisë, bazuar në idenë se demokracia ishte më shumë se zgjedhje dhe se “institucionet, të drejtat dhe proceset janë të gjitha të rëndësishme për një demokraci të suksesshme”. (Finizio, 2013) Nën drejtimin e Kofi Anan koncepti i qeverisjes së mirë mori funksion qendror në procesin e demokratizimit, duke institucionalizuar një strukturë shumëdisiplinore, nëpërmjet agjencive në të qeverisjes së mirë, të hartuar mbi qasjet e ndryshme dhe përvojat e agjencive që kanë qenë të angazhuara në mbështetje të demokracisë.

Si rezultat i kësaj, “...në tetor të vitit 2000 Annan ka themeluar praktikën e ndihmës së demokracisë, e cila, ndryshe nga asistenca elektorale, përfshiu ndërhyrjen më të madhe të OKB-së në juridiksionin e brendshëm të shteteve”. (Finizio, 2013)

“Në kuadër të kësaj politike globale rëndësia e OKB-së si organizatë ndërkombëtare ka luajtur rolin e saj duke zgjeruar demokracinë në të gjitha shtetet e dobëta. Roli i saj ku përplasjet ndërmjet vendeve demokratike dhe jo demokratike nuk do të jenë të dobishme për avancimin e demokracisë në të gjithë botën, por zgjidhja e vetme për të promovuar demokraci globale do të jetë demokratizimi i OKB-së”.(Finizio, 2013)

Në këtë vështrim, ka qenë e rëndësishme të sillet në vëmendje ndërhyrja që ka kjo organizatë në kuadër të modelit teorik e që ka ndikuar në ndërtimin institucional tek shtetet me demokraci të cënuar, sikurse është ende Shqipëria. Analiza e impaktit të demokracisë që promovon OKB-ja, ka ardhur si udhërefyes që funksionin e saj operues e delegon nga politikat e saj me tipologji ndërkombëtare drejt atyre rajonale.

3.3.2 Mekanizmat demokratizuese te Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATOS)

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (ndryshe njohur si NATO) e krijuar në vitin 1949 për t'iu kundërpërgjigjur sulmeve të mundshme të ish-BRSS-së. Në këtë organizatë, u bashkuan SHBA, Kanadaja dhe 14 vende evropiane për mbrojtjen e Evropës Perëndimore. Vendet anëtare ranë dakord me anë të Traktatit të zhvillonin konsultime për integritetin territorial, pavarësinë politike dhe sigurinë e secilit prej tyre, kur do të vihej në rrezik (neni 4-ët, i statutit të NATO-s, 2003). Vendet kanë rënë dakord që çdo sulm ushtarak ndaj njërit, apo disa prej tyre, në Evropë, apo në Amerikën e Veriut do të konsiderohej sulm ndaj të gjithë vendeve anëtare (neni 5 i statutit të NATO-s, 2001.)

Aleanca është e përbërë nga Këshilli, i cili është organi më i lartë, ku janë të përfaqësuara të gjitha vendet anëtare (nenin 9 të statutit të NATOs) dhe nga konferenca parlamentare e NATO-s (njohur ndryshe si Asambleja e Atlantikut të Veriut) që vepron në cilësinë e autoritetit zyrtar të konsultimeve. Mbarimi i Luftës së Ftohtë solli një sërë ndryshimesh në organizatë. Në vitin 1997 u themelua Këshilli për Partneritet Euro-Atlantik, i cili ka aktualisht pesëdhjetë vende anëtare, përfshirë këtu shtete që më parë kanë qenë anëtare të Traktatit të Varshavës, si dhe ish-shtetet përbërëse të ish- BRSS-s, (Keshillin per Bashkepunim te Atlantikut te Veriut, I themeluar ne vitin 1991.). Programi i Partneritetit për Paqe (që u formua ne vitin 1994), me kalimin e kohes bashkoi Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik me vendet e tjera anëtare të OSBE-së në një kuadër bashkëpunimi, ky bashkim ka potencilin të përmirësojë mekanizmin e pranimit të shteteve të reja anëtare në NATO.

Partneriteti për Paqe është fokusuar në çështjet praktike të mbrojtjes e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe atij ushtarak, Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik është forumi, ku zhvillohen konsultime mjaft të gjera për çështje politike dhe të sigurisë. Vendet që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe nënshkruajnë një Dokument Kuadër, me anë të të cilit angazhohen se do vijojnë të ndërtojnë shoqëri demokratike dhe të respektojnë parimet e së drejtës ndërkombëtare publike, të përmbushin në mirëbesim detyrimet e Kartës së OKB-së, të respektojnë detyrimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të respektojnë kufijtë e tyre ekzistues (Partneriteti Euro-Atlantik 1994).

Në përgjithësi, theksojmë se në fillim të viteve '90-të të shekullit XX, zgjerimi i NATO-s ka qenë mjaft i pasigurtë, edhe pse duke arsyetuar në kohë dhe duke e ditur rezultatin e vërtetë mund t'i çojë studiuesit në përfundimin se procesi i demokracive të reja e "anëtarësimit në Aleancën e Atlantikut të Veriut kishte ka pasur dhe ka alternativa. Në përgjithësi, procesi i zgjerimit të Aleancës së Atlantikut të Veriut është inkuadruar brenda NATO-s dhe është drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nismëtari kryesor i zgjerimit të NATO-s ka qenë administrata Clinton, e cila erdhi në zyrë në vitin 1993 dhe gjatë gjithë procesit ka përfshirë zyrtarë të rëndësishëm të tilla si: James Goldgeier, Anthony Lake, Strobe Talbott, Richard Holbrooke, dhe Madeleine Albright.

Ideja e zgjerimit të NATO-s ka pasur shumë pak mbështetje brenda administratës amerikane në fillim. Një rol të rëndësishëm në promovimin e kësaj ideje ka luajtur kryesisht Anthony Lake. Ithtarët e zgjerimit të NATO-s u bënë mbizotërues në administratën e Klintonit në verë të vitit 1994 (Asmus 2002: 20-29). Megjithatë, mbështetja e zgjerimit të NATO-s në SHBA nuk ishte e kufizuar në administratën demokratike Klinton. Që nga viti 1994, të gjithë kandidatët presidencialë amerikanë dhane shanse reale për të pasuar këtë iniciative, me intensitet të ndryshëm, për te mbështetur politikën e dyerve të hapura të NATO-s (Rupp 2002: 352). Për më tepër, administrata e presidentit republikan George W. Bush, duke inkorporuar edhe mbështetje për zgjerimin e NATO-s në strategjinë e saj të jashtme të politikës (Meyer 2003: 85).

Në gjysmën e parë të viteve '90-të, NATO-ja ka qenë e orientuar drejt një politike zgjerimi, pra nga politika e bashkëpunimit me demokracitë e reja, të cilat u artikuluan nga themelimi i (Këshillit të Atlantikut të Veriut për bashkëpunim) të NACC dhe programi zhvillimit të Partneritetit për Paqe. Kjo politikë ka filluar në vitin 1995 mbi Zgjerimin e NATO-s. Nga pikëpamja e shteteve është përpjekur për të fituar anëtarësimin në NATO, pasazhe në lidhje me kërkesat për anëtarët e rinj ishin më të rëndësishme. Këto përfshinin krijimin e një sistemi të qëndrueshëm demokratik politik i cili do të përmbushë vlerat e përbashkëta zakonisht mbrojtura nga NATO-ja, garanci e kontrollit civil dhe demokratik mbi ushtrinë dhe sjelljen e transparencës në sektorin ushtarak, (2005).

NATO ka kontribuar me të vërtetë në stabilizimin demokratik të vendeve kandidate. Me të drejtë në literaturën bashkëkohore shkencore është nënvizuar fakti se zgjerimi i NATO-s ka pasur një efekt stabilizues në rajonin e Evropës, sepse ajo ka ndihmuar e ndikuar në konsolidimin e

sistemeve demokratike në shtetet postkomuniste në disa mënyra (shih Michta 2009; Waterman , Zagorcheva, Reiter 2002; Epstein 2005; pjesërisht Sjursen 2004: 702).

Ky ka qenë rasti, që mjediset e teorive mbi paqen demokratike kanë qenë të vlefshme. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i NATO-s do të ulë shanset e një shpërthimi konfliktesh të dhunshme në Evropë. Të gjitha këto qasje janë të bazuara në një propozim të përgjithshëm të institucionalizimit neoliberal që institucionet ndërkombëtare kanë ndikim në politikën e brendshme të pjesëtarëve të institucioneve ndërkombëtare (Epstein 2005: 67-73). Nga ana tjetër, ka autorë, të cilët nuk pajtohen me përfundimin lidhur me ndikimin pozitiv të zgjerimit të NATO-s dhe në konsolidimin demokratik të vendeve postkomuniste.

Dan Reiter ka theksuar se "Pse zgjerimi i NATO-s nuk ka përhapur Demokraci" (2001: 51-67). Reiter ka arritur në përfundimin se zgjerimi i Aleancës së Atlantikut të Veriut nuk ka rritur më tej demokratizimin e ndonjë vendi, I cili mund të merrej si kandidatë potencial për anëtarësimin e tij në NATO. Reiter identifikon tre mekanizma përmes së cilave NATO duhej teorikisht të ishte në gjendje për të mbështetur demokratizimin e vendeve kandidate. Këto janë "karrota dhe bastuni" si mekanizma anëtarësimi në NATO, si mjet për të rivendosur demokracinë në shtetin anëtar, në rastin e vendosjes së një regjimi autoritar, si edhe mbështetjen e demokratizimit nga Aleanca e Atlantikut të Veriut nëpërmjet zbatimit të parimeve mbi kontrollin ushtarak demokratik, gjatë transformimit të marrëdhënieve civile e ushtarake në vendet kandidate. (2001: 51-56)

Linja kryesore e argumentimit Reiter ka qenë që vendet kandidate të bëheshin më demokratike për shkak të faktit se shumica e qytetarëve të tyre, e elitave politike kanë zgjedhur këtë proces demokratizimi që ka filluar shumë më shpejt se debatet në lidhje me pranimin në NATO. Stabilizimi demokratik i shteteve kandidate, si rezultat i politikës së qëllimshme të NATO-s mund të identifikohet duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- Së pari, ka qenë e nevojshme për të përcaktuar grupin e duhur të kërkesave të NATO-s për shtetet kandidate, kur bëhet fjalë për të demonstruar cilësinë e demokracisë së tyre, e cila do të duhej ta përmbushte, nëse shtetet dëshirojnë të bëhen anëtare të NATO-s;
- Së dyti, nëse një grup i tillë shtetesh nuk ka ekzistuar, atëherë testimi i mëtejshëm i hipotezës së përmendur më lart do të bëhej i parëndësishëm, pasi kjo do ta bënte të qartë

se NATO-ja nuk ka për qëllim të ndjekë demokratizimin e vendeve kandidate. Përcaktimi i një grupi të tillë të kërkesave mund të konsiderohej si kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për rëndësinë që kanë shtetet kandidate.

“Shtrojmë pyetjen se si NATO ka mbështetur përhapjen e demokracisë”? Një mekanizëm, përmes të cilit NATO ka mbështetur demokracinë është përshkruar duke përdorur shembullin e Republikës Çeke dhe të Rumanisë nga Alexandra Gheciu (2005) në studimin e saj “Institucionet e sigurisë, si agjent i socializimit? NATO-ja dhe Evropa e Re ”.

Gheciu erdhi në përfundim se NATO kishte krijuar një mekanizëm të institucionalizuar të vlerave liberale e demokratike për t’u zbatuar në shtetet e tranzicionit. Aleanca e Atlantikut të Veriut, në këtë mënyrë, mori avantazhin e perceptimit si një nga simbolet e Perëndimit në shtetet në tranzicion, të cilat çuan në një rritje në perceptimin e legjitimitetit të NATO-s nga ana e këtyre shteteve. Kjo është arsyeja se përse NATO-ja ka qenë në gjendje të përdorë mësimdhënien dhe bindjen në shtetet në tranzicion, të cilat janë përpjekur për t’u bërë anëtarë të NATO-s.

Një nga mekanizmat e NATO-s për procesin e demokratizimit, është se ka marrë e merr pjesë në edukimin nëpërmjet seminareve etj., të cilat kanë qenë të orientuara, për të formuar elitat e reja politike, komunitetin e sigurisë me vlera liberalo-demokratike dhe për organizimin e sektorit të sigurisë mbi bazën e këtyre vlerave.

3.3 Tipologjia e Institucioneve Rajonale

Organizatat me karakter rajonal kanë luajtur një rol dominant në arenën ndërkombëtare siç është Evropa, terreni ku rajonalizimi ka njohur zhvillimin me të madh ndërkombëtar.

Fokusi i studimit tonë nuk qendron tek impakti që kanë sjellë organizatat me karakter universal. Një nga arsyet se përse studimi ynë është përqëndruar më shumë në impaktin që sjellin organizatat me karakter rajonal, ka ardhur edhe si rrjedhim i faktorit gjeografik ku vendi ynë shtrihet. Duke qenë se organizatat me karakter rajonal kanë përfshirë shtete që janë afër njëri-tjetrit dhe në këtë rast Bashkimi Evropian, si një organizatë me potencial rajonal, ka krijuar mundësinë e ndërtimit të sistemit demokratik te shtetet e dobëta nëpërmjet mekanizmave të saj kushtëzuese.

3.6.1 Bashkimi Evropian operon si një model suksesi

Themelimi i Komunitetit Ekonomik Evropian (pra, BE) në veçanti ka patur si qëllim të vendoste bazat për një Evropë të bashkuar, me integrim ekonomik e politik të mirëfilltë. Ajo është zhvilluar për të qenë një organizatë rajonale e mirëfilltë me përbërës domethënës ndërkombëtarë. Duke u ndërtuar si fillim në formën e tri komuniteteve ndërvepruese (Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut 1951, Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike 1957, Komuniteti Evropian Ekonomik 1957) kanë pasur si qëllim themelimin e tregut të vetëm të bashkuar, me tarifa të përbashkëta të jashtme, pa tarifa dhe kuota të brendshme, të cilat të promovonin lëvizjen e lirë të kapitalit e të fuqisë punëtore.

Akti i Përbashkët i Evropës (Single European Act) i vitit 1986 dhe Traktati i Bashkimit Evropian i vitit 1992 kanë sjellë ndryshime mjaft thelbësore. Traktati i Lisbonës, i vitit 2007, ka pasur si qëllim të orientojë qeverisjen e Bashkimit Evropian. Anëtarësimi në BE ka ardhur duke u ngritur në mënyrë progresive. Institucionet e BE-së përfshijnë kryesisht Parlamentin Evropian, Këshillin e Ministrave, Komisionin Evropian dhe Gjykatën e Drejtësisë (Organizatën për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, 1960)

Në fakt, janë miratuar shumë traktate në kuadër të Këshillit të Evropës, përfshirë në veçanti Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (miratuar në vitin 1950), por duke mos harruar as Kartën Sociale Evropiane të vitit 1961, apo marrëveshjet që merren me çështjet e kulturës dhe të edukimit. Duhet përmendur edhe traktatet për patentat, ekstradimin, migracionin, imunitetet shtetërore, ndalimin e terrorizmit etj.

Procesi i integrimit evropian ka ofruar vijimisht përvojë origjinale se si të rikonfigurojë strukturën e tij. Dizenjimi për një Evropë të re ka një fokus të ri, të drejtuar tek qytetarët, tek kthimi i fuqisë për shtetet. Zgjerimi i mëtejshëm i reformave të duhura të institucioneve në nivel me ato të BE-së dhe me politikat e saj. Kjo strategji duhet të konsiderohet si një debat serioz rreth procesit të integrimit evropian nga shtetet aspirante.

Në një kohë, kur të menduarit për të ardhmen politike dhe ekonomike të Evropës ka qenë një proces i domosdoshëm, John Gillingham ka argumentuar nëpërmjet një qasje teorike bindëse se gjendja e sëmurë e BE-së dhe një grup sfidash kanë merituar që të merren seriozisht nga pro evropianët, po aq sa edhe nga evroskeptikët. Duke vlerësuar arritjet e BE-së, jo më pak në promovimin dhe ruajtjen e demokracisë në vendet jodemokratike, Gillingham ka dënuar prirjen drejt centralizimit burokratik, i cili ka prodhuar një hendek gjithnjë në zgjerimin ndërmjet institucioneve e qytetarëve. Lëvizja drejt strukturave të burokracisë së Brukselit dhe transferimi i disa përgjegjësi të shteteve anëtare, si me të drejtë ka argumentuar e ka ndikuar, në mos shpërbërjen e BE-së e për më tepër, rindërtimin e themeleve të saj” (Geoffrey Owen)

Gillingham ka pasqyruar një portret bindës të Bashkimit Evropian, pas refuzimit të Traktatit Kushtetues. Ky studim në brendësi ka parashtruar zhvillimet e mëdha në Evropë dhe i ka vendosur ato në një perspektivë globale. Pasqyrimi me objektivitet i Evropës së re ka qenë arsye e rëndësishme për të nxjerrë më qartazi se çfarë nuk ka shkuar mirë me BE-në dhe se si ajo duhej të përcaktohej.

John Gillingham ka argumentuar nëpërmjet tezave të tij zhvillimet e dinamikën historike të BE-së dhe ka arritur në disa vlerësime:

-Krijimtarinë e “Evropës së Vjetër” e ka parë duke konstatuar në të fenome të “çuditshme”, se përse Evropa nuk ka ecur me shpejtësinë e nevojshme dhe pse ajo ka aq shumë më pak për të ofruar e kjo e krahasuar me ambiciet e SHBA-së. Shtrohet pyetja se cilat janë arsyet? Analiza e ka çuar autorin tek institucionet, në atë kuptim që institucionet e projektuara në vitet ‘50 të shekullit të kaluar për ta zhvilluar Evropën, tani sipas tij janë bërë problem. (Norman Stone, Ankara 2006)

Analiza e studimit ka ngritur disa pyetje e konkretisht :

- 4 Çfarë ka arritur Bashkimi Evropian sot?
- 5 Cilat janë pikat e forta dhe dobësitë e saj?
- 6 Cila është strategjia e re për të ecur përpara?
- 7 A ka shumë gjëra që mund të thuhet për arritjet e Bashkimit Evropian?
- 8 A është tregu i vetëm apo lëvizja e lirë e personave?

9 Është kapaciteti i Bashkimit Evropian për të marrë një pozicion kolektiv në negociatat ndërkombëtare, ku ajo ka shumë më tepër influencë se shtetet anëtare individualisht?

Këto janë sigurisht arritje të rëndësishme - për të mos përmendur objektivat e gjera të paqes dhe prosperitetit në një periudhë prej më shumë se gjysmë shekulli. Nga pikëpamja e sundimit të ligjit, ne shohim një Bashkim Evropian të bazuar në ligj, një union, ku shtetet anëtare kanë rënë dakord që të mos paraqitin konfliktet e tyre në asnjë formë të zgjidhjes tjetër, nga ato të përshkruara në Traktatet. Qytetarët mund edhe të kërkojnë të drejtat e tyre ligjore para gjykatave të Shteteve Anëtare.

Për të parë se çfarë Bashkimi Evropian ka arritur, ajo çfarë duket e dobishme për të parë në rolin e saj është tërheqja e pothuajse të gjithë vendeve të Evropës për t'u bashkuar. Modeli i saj implementues, është parë edhe nga rajone jashtë kontinentit evropian.

Kur gjashtë shtetet themeluese hartuan Traktatin e EEC mbi pesëdhjetë vjet më parë, ato kishin në vizionin e tyre ftesën për kombet e tjera të bashkohen me ta, duke zgjidhur kështu grupimin e burimeve të tyre për të ruajtur, forcuar paqen, lirinë dhe thirrjen për popujt e tjerë të Evropës, të cilët ndajnë idealin e tyre për t'u bashkuar në përpjekjet e tyre.

Komuniteti nuk ishte një klub i mbyllur, sipas preambulës së nenit të Traktatit të KEE-së, i cili ka nënvizuar se "Çdo shtet evropian mund të aplikojë për t'u bërë anëtar i Komunitetit, ka qenë përvoja origjinale e dhënë gjatë viteve". Praktikisht, çdo shtet evropian ka pasur ambicie për t'u anëtarësuar në Komunitet, sot Bashkimi Evropian. Historia e zgjerimit drejt BE-së është progresive.

Zgjerimi i parë: nga 6-9 shtetet ku Traktati EEC u nënshkrua në Romë. EEC ka filluar jetën me gjashtë shtete anëtare: Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda. Atyre iu bashkuan, pesëmbëdhjetë vjet më vonë, Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar. Duhet theksuar, se këto shtete u bashkuan për arsye kryesisht ekonomike, sesa për arsye politike apo ideologjike. Shtetet e reja anëtare duhet të pranoreshin në Komunitetin Ekonomik Evropian, duke pasur një shkallë më të lartë të zhvillimit të ekonomise dhe të sistemit të tyre politik.

Një shkallë e tillë e integritimit ekonomik, madje integrimi më shumë do të ishte politik, do të konsiderohej si një Komunitet që bazohej në shtetin ligjor, në shtetin e së drejtës në mënyrë të veçantë e në sistemin efektiv gjyqësor.

Çfarë është më e habitshme në lidhje me zgjerimin e pestë dhe të gjashtë, në krahasim me ato të mëparshme, është se, për shkak të gjendjes së vendeve aplikante, procesi i zgjerimit të vendeve të Evropës Lindore e Qendrore, ishte si një parakusht për transformimin e përgjithshëm të ekonomisë, sfidë kjo që do të thotë se në praktikë ishte një program poliedrik i reformës:

- a. i ekonomisë;
- b. i mjedisit;
- c. i sistemit politik.

Është e rëndësishme në kontekstin e tanishëm, transformimi që u zhvillua në aspektin e vlerave kushtetuese dhe ligjore. Kushtetutat e reja dhe gjykatat kushtetuese, janë themeluar për shkak të shqetësimeve për pavarësinë e gjykatave të rregullta. Pavarësia e gjykatave ka qenë parakushti më fundamental, sesa sundimi i ligjit.

Historia, se si perspektiva e anëtarësimit në Bashkimin Evropian ka prodhuar stimul të fuqishëm për të realizuar transformimet radikale midis kombeve fqinje.

Sa për botën e sotme, jashtë kontinentit evropian, shpresat se regjimet demokratike liberale në bazë të sundimit të ligjit të tregoheshin përtej kufijve të Evropës me zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike e të tjera janë ende për t'u plotësuar. Teknikat e krahasueshme kanë qenë më pak të suksesshme. Vendet, për shembull, janë të penguara, kur më pak vende donatore të “ndershme” janë të gatshme për të favorizuar regjimet diktatoriale për përfitime afatshkurtra për veten e tyre.

Punimi është përqendruar në pasqyrimin e analizës së zgjerimit progresiv të Bashkimit Evropian, sepse ka qenë dhe është pjesë e rëndësishme e historisë. Ka qenë pak e njohur dhe ishte përhapja e shtetit ligjor në të gjithë kontinentin evropian, i cili ka qenë i lidhur me vlerat e stabilitetit politik, të demokracisë e të paqes.

Kombinimi i paqes dhe i prosperitetit relativ, brenda një demokracie të qëndrueshme e të bazuar në sundimin e ligjit, e ka karakterizuar Bashkimin Evropian për pesëdhjetë vjet. Ajo ka provuar një subjekt tërheqës për të qënë e bashkuar.

Për të qënë pjesë e Bashkimit Evropian dhe e strukturave të tjera të rëndësishme ndërkombëtare shtetet kanë qënë të kushtëzuara nga kritere e standarde të ndryshme. Bashkëpunimi midis qeverive të vendeve anëtare në Bashkimin Evropian ka ndihmuar për të kapërcyer problematikat, vështirësitë e rritjes e të zhvillimit modern.

3.3.2 Këshilli Evropës

Këshilli i Evropës është themeluar në vitin 1949 për arritjen e një numri të madh qëllimesh e bashkëpunimi. Aktualisht Këshilli i Evropës numëron 47 vende anëtare. Këshilli përbëhet nga Komiteti i Ministrave, ku marrin pjesë përfaqësuesit e qeverive të vendeve anëtare. Asambleja Parlamentare është e përbërë nga deputetë të parlamenteve të vendeve anëtare dhe pjesa më e rëndësishme e punës së Këshillit të Evropës është përgatitja dhe përfundimi i traktateve e protokolleve (nenet 15 dhe 16 të Statutit të Këshillit të Evropës).

Këshilli i Evropës përfaqëson krerët e shteteve dhe të qeverive të shteteve anëtare të BE-së. Rëndësia e KiE është rritur vijimisht, edhe për shkak të ndihmesës së kryetarëve të shteteve për çështje të ndryshme evropiane. Këshilli Evropës përfaqëson një organizëm të veçantë, i krijuar nga vullneti politik i shteteve anëtare për të krijuar një instrument fleksibël, të aftë që të veprojnë lirisht jashtë skemave institucionale komunitare për menaxhimin e procesit të integritimit, si etapë e parë e negociimit me kryetarët e shteteve (E. Canaj, 2014)

Akti Unik Evropian është traktati që i ka dhënë Këshillit formalisht ekzistencën, ka përcaktuar mbledhjet dhe përbërjen. Traktati i Bashkimit Evropian, nga ana tjetër, i ka dhënë Këshillit të Evropës, një formulë të përgjithshme çka i ka besuar detyrën për t'i dhënë BE-së “..impulsin e nevojshëm për zhvillimin e saj” dhe përcaktimin “...e orientimeve politike të përgjithshme. Këshilli Evropian i jep BE-së shtysat e nevojshme për zhvillimin e tij dhe përcakton drejtimet e përgjithshme politike të tij. (E. Canaj, 2014)

3.6.3 Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSCE)

Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSCE) u themelua në vitin 1975 në vijim të Konferencës së Helsinkit të fuqive evropiane, përfshirë SHBA-në dhe Kanadanë. Akti Përmbyllës i Helsinkit nuk ishte një dokument me fuqi detyruese, por një dokument politik, që konsistonte në tri drejtime, si : çështjet e sigurisë në Evropë, bashkëpunimi në fushën ekonomike, në shkencë e teknologji, si edhe bashkëpunimi në fushat humanitare.

Në vetvete, Konferenca ishte një konferencë diplomatike me takime të rregullta, që kishin si qëllim të analizonin ecurinë e procesit e të zbatimit të aktit Përmbyllës të Helsinkit. Pas ndryshimeve që pësoi Evropa Lindore në fund të viteve '80 organizata filloi të merrte zhvillim. Statuti i Parisit për një Evropë të Re, nënshkruar në vitin 1990, parashikoi krijimin e një institucioni të përhershëm. OSBE është në thelb një institucion për parandalimin e konflikteve, me një Qendër për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, përgjegjëse për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë në zonën e OSBE-së. Gjithashtu, OSBE-ja monitoron zgjedhjet.

Përgjegjësia e përgjithshme për veprimet ekzekutive ushtrohet nga Kryetari në Detyrë, i cili asistohet prej Trojkës (e cila paraprin dhe pason Kryetarin). Komisioneri i Lartë për Minoritetet Kombëtare është caktuar në vitin 1992 dhe janë krijuar për më tej edhe një numër misionesh që ndihmojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Aktualisht kjo organizatë ka 56 vende anëtare. Në eventualitetin e pretendimit të impaktit demokratizues, që kanë organizatat ndërkombëtare, kemi të bëjmë me veprim normash të së drejtës ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare vendos nëpërmjet mekanizmave të organizatave të gjejë alternativa zgjidhjeje për ndërtimin e kapaciteteve institucionale qendrore të shteteve. Duke parë impaktin global të OKB-së që nga gjeneza e saj e deri tek politikat e reja globale vërejmë se karakteri universalist i jep potencialin e duhur për të krijuar mundësinë e shpërndarjes së demokratizimit në vendet në nevojë, por pavarësisht çfarë strukturash të konsoliduara ka OKB, mbetet ende një organizatë transatlantike.

Nga ana tjetër, BE-ja si organizatë me karakter rajonal, ka krijuar që nëpërmjet disa kushtëzimeve të realizojë mekanizmat e nevojshme drejt demokratizimit të sistemit politik e juridik në Republikën e Shqipërisë.

KAPITULLI IV

Impakti i Mekanizmave Evropiane Për Përsosjen e Institucioneve Publike Shqiptare

4.1 Rëndësia e modelit evropianizues përtej BE-së

Zhvillimet e sotme politike dhe ekonomike brenda kontinentit evropian, kanë sjellë prirje paralele të zhvillimeve të procesit të integritit, duke përfshirë nga njëra anë shtetet qendrore të kontinentit evropian, dhe në anën tjetër atë që shpesh është quajtur si periferia e Europës, rajonin e “Ballkanit Perëndimor” ku përfshihet edhe vendi ynë. Kjo terminologji që është përdorur nga qarqet diplomatike perëndimore është bërë për të të shmangur elitat politike të së kaluarës në përballjen e tyre me sfidat e reja evropiane.

Veprimtaritë gjithëpërfshirëse me prirje globalizuese, të shoqëruara me sfidat aktuale të fenomenit “evropianizim”, kanë treguar përkujdesje të dukshme në interes të çështjeve të, shtetit shqiptar, si edhe shkëputjen e tij nga ideologjia komuniste.

Ajo që shtrohet sot në kontekstin global dhe evropian mbi riidentifikimin e Ballkanit Perëndimor, është arsyetuar dhe konsideruar më shumë e lidhur me procesin e evropianizimit, si edhe me realitetin globalizues me të cilin vendet candidate dhe jo vetëm ato janë përballur.

Procesi i evropianizimit në realitetin shqiptar ka qenë i lidhur ngushtë në bashkëpunimin me Bashkimit Evropian dhe me institucionet e tjera ndërkombëtare. Në këtë kuptim, sfida kryesore e shteteve ka qenë dhe mbetet konsolidimi i demokracisë nëpërmjet bashkëpunimit midis grupeve partiake. Implementimi i reformave evropiane, ka kërkuar në të njëjtën kohë stabilizim institucional, ekonomik dhe politik të grupeve të interesit.

Integrimi evropian është vlerësuar nga të gjitha vendet e Ballkanit, edhe pse historia e tyre ka qenë e shoqëruar me fenomene të ndryshme. Një nga sfidat e tyre ka qenë dhe mbetet plotësimi i “Kritereve të Kopenhagenit”.

Në vështrim më të gjerë integrim do të thotë : solidaritet, të ndash bashkë të mirat dhe problemet apo sfidat. Procesi i Integritimit Evropian përfshin harmonizim dhe jo asimilim e vendeve candidate për në BE. Asimilimi nënkupton shkrirje në një të vetme, me forcë ose me dëshirë dhe ku nuk evidentohen tiparet dalluese të njërës pjesë ose të tjetrës.

Tipar karakteristik i integritimit është ruajtja e tipareve dalluese, sipas Ben Rosamond (Ben Rosamond, 2005) “...integrimi evropian është një proces pabarim, i thellë dhe i gjerë, i bashkëpunimit politik, ekonomik dhe i sigurisë ndërmjet kombeve, me synim kryesor ruajtjen e paqes”. (Ben Rosamond, 2005)

Duke iu referuar argumenteve të mësipërme nënvizojmë se duke e kuptuar dhe analizuar këtë botë globale nga këndvështrimi i sotëm kemi konstantuar ndryshimin historik që kanë kaluar kombet për të ardhur në kontekstin aktual në një sfidë të përbashkët, pra për të realizuar qëllimet e përbashkëta dhe konkurrencat e dyanshme. Kjo është perceptuar si një “faktor psikologjik”, i cili qëndron sot si një sfidë për implementimin e strukturave evropiane në çdo vend kandidat që aspiron të bëhet pjesë e BE-së.

Procesi i evropianizimit, sipas një numri të gjerë studiuesish, është se si në të shkuarën edhe sot po përballlet me dy fenomene ndërkombëtare të menjëhershme:

- Nga njëra anë, është faktori ekonomik, politik dhe social, ku prirja globale, karakterizohet në mënyrë universale e që e ka burimin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Në anën tjetër, është implikimi i institucioneve të ripërcaktuara dhe adoptimi i politikës evropiane. Në këtë mënyrë, evropianizimi shfaqet në forma të ndryshme nga globalizimi, duke afektuar në këtë mënyrë, jo vetëm shtetet anëtare të BE-së, por edhe vendet candidate potenciale të imponuara nga normat komunitare ndërkombëtare e modelet qeveritare, të cilat kanë shkaktuar ndryshime në politikën nacionale.

Ky standard evropian, i identifikuar nëpërmjet institucioneve, ndërton marrëdhënie ndërmjet përfitimeve përkatëse të një rajoni, duke bindur e pasqyruar shpenzimet, duke rritur në këtë mënyrë principet tek vetë anëtarët e BE-së. (Claudio M. Radaelli, 2004) “Termi “evropianizim” është perceptuar si i ndryshëm nga ajo e “integritimit evropian”, por duke iu referuar “backgroundit” të tij, ai ndikon në veprimtarinë politike, duke përhapur vlerat dhe benefitet e normave të përbashkëta, të rregullave e të identitetit.

Klaudio Radaelli (*Claudio M. Radaelli, 2003*), i cili jep një nga përcaktimet më përfshirëse të evropianizimit, sjell në vëmendje, duke argumentuar ndryshimet e mundshme që mund të sjellë evropianizimi, duke iu referuar procesit:

A. të ndërtimit;

B. të shpërndarjes;

C. të institucionalizimit;

D. të rregullave formale dhe informale;

E. të procedurave;

F. të paradigmave politike;

G. ndarja e besimeve dhe normave duke definuar dhe konsoliduar me përparësi procesin politik të BE-së;

Gj. përfshirjen e diskursit të brendshëm, identitetin, strukturat politike, si edhe politikat publike.

Në kuadër të këtij argumenti, është vënë re se ajo që karakterizon procesin e evropianizimit është dukuria shumëdimensionale e dinamika që ka përfshirë qeverisjen, institucionalizimin e debatin për çështje të natyrave të ndryshme. Në këtë mënyrë, shtetet janë përgjigjur në mënyra të ndryshme e në përputhje me strukturat e tyre ekonomike, politike.

Procesi i Evropianizimit është konceptuar duke marrë në vlerësim aspekte që lidhen me zhvillimin e qeverisjes institucionale, i cili është transformuar si një trup i vetëm vendimarrës. Evropianizimi, i parë si një ndryshim i kufijve të jashtëm, ka nënkuptuar transformimin e Evropës si një kontinent në një hapësirë të vetme politike. Duke parë konceptimin e evropianizimit që në fokus ka marrëdhëniet, midis rrjetit të anëtareve të unionit dhe vendeve kandidate për tu pranuar në BE-në, ky projekt politik ka synuar t'i japë BE-së rolin e një aktori të rëndësishëm ndërkombëtar, i aftë për të vepruar dhe funksionuar fort. (Olsen, 2002)

Dimensioni i saj ka bërë të mundur të meret me praktikën qeverisëse eksportuese dhe strategjitë evropiane. Të përcaktosh procesin e evropianizimit, ashtu sikurse e trajtojnë një grup autorësh si një term që ka një funksion dydimensional, ku në njërën anë qëndron niveli brendshëm i të ardhurave nëpërmjet implementimit të *Acquis communautaire* - dhe në anën tjetër, duke iu

referuar strategjive politike për të implementuar standardet e BE-së në shtetet kandidate. Një nga interpretimet e pranuar të evropianizimit është ai që inkurajon ndarjen boshtore midis procesit lart-poshtë dhe poshtë-lart.(Howell ,2002)

Përqasja lart-poshtë i është referuar kryesisht ndryshimit që kanë sjellë metodat e veçanta evropiane në politikat nacionale të shteteve. Në këtë mënyrë “integrimi evropian” e ka përcaktuar evropianizimin si një “ndryshim në sistemin e brendshëm”. Në përqasjen nga poshtë-lart të ndërtimit, synimi është i pari që influencon procesin e integritit evropian të vendeve të ndryshme. (Howell ,2002)

Në këtë vështrim, në atë çfarë argumentuam më sipër, interpretimi i evropianizimit është shtjelluar si një proces interaktiv e dinamik midis BE-së dhe problemeve të brendshme, ku institucionet evropiane janë duke ndryshuar e zgjeruar strukturën e brendshme të tyre. Në këtë mënyrë, evropianizimi mund të shikohet si një ndërlidhshmëri midis institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. BE-ja brenda saj, ka krijuar rrjetet horizontale e vertikale.

Mekanizmat evropianizuese janë të shumtë. Ato i janë referuar socializimit dhe metodave komplekse sociale të vendeve kandidate. Gjithashtu, i janë referuar edhe vlerave e normave të BE-së që ka ndjekur e ndjek logjikë pragmatike të konsekuencave, si edhe rregullimin administrativ e institucional në zhvillimin e politikave në kohë dhe në shtete të ndryshme.

Cilat janë përmbajtjet e qeverisjes së jashtme? Çfarë lloj evropianizimi promovon BE-në që të ndiqet ose të prodhohet përtej kufijve të saj? Ne thelb, ne kemi filluar me “analogjinë në familje”. Sipas këtij supozimi, politika është preferuar në një mjedis ndërkombëtar, që i ngjan ose të paktën duhet të jetë në përputhje me parimet e procedurat e tyre të brendshme. Qëllimet kryesore, si edhe instrumentet e evropianizimit kanë pasqyruar parimet e integritit dhe të qeverisjes në BE.

Me fjalë të tjera, procesi i evropianizimit është i lidhur me projektimin e jashtëm dhe është i varur nga zgjedhje të brendshme. Nga këndvështrimi i perspektivës nacionale që çdo shtet kandidat ka për t'u bërë pjesë e BE-së, çdo tipar e cilësi e mjedisit ndërkombëtar që është pasqyruar në BE është në të mirë të interesave politike dhe ekonomike të çdo vendi kandidat. Ky

është një mjedis që drejtuesit e BE-së e kanë njohur mirë dhe kanë ditur ta përdorin në funksion politikve që BE-ja ka ndjekur e ndjek ndaj vendeve aspirante. Kjo u jep atyre avantazhin mbi drejtuesit e vendeve kandidate që kanë aplikuar e duan te bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

Autorë të tjerë kanë theksuar vlerat e përbashkëta, normat e standardet e vendosura të BE-së, si burim i projektimit të jashtëm. Federika Bicchi ka vënë në dukje se politika e jashtme e BE-së është parë si sjellje reflektive, duke pasqyruar besimin, thellësisht të rrënjësuar se historia e Evropës është një mësim për të gjithë.

4.2. Mekanizmat e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë evropiane

Si është realizuar evropianizimi përtej kufijve të BE-së? Cilat janë mekanizmat dhe proceset përmes të cilave BE-ja ka shpërndarë rregullat e saj të qeverisjes në sistemin më të gjerë ndërkombëtar? Disa klasifikime të mekanizmit të evropianizimit janë sugjeruar në referencë të literaturës bibliografike, ku kemi propozuar dy tabela të thjeshta 2x2 me të cilin kemi ilustruar dallimin që ekziston midis mekanizmave të drejtpërdrejtë nga mekanizmat jo të drejtpërdrejtë. Ata kanë ndjekur logjikë racionale të pasojave nga ata, të cilët kanë ndërtuar mbi një logjikë të arsyeshme.

mekanizmat e drejtpërdrejtë	mekanizmat jo të drejtpërdrejtë
Kushtëzimi	pasojat e kushtëzimit

- Logjika e pasojave të Kushtëzimit (madhësia dhe besueshmëria e stimujve, kostot e pajtueshmërisë) Mishërimi (madhësia e tregut, legalizimi dhe centralizimi i rregullave) Logjika e arsyetimit
- Shoqërizimi/ imitimi (pasiguria, legjitimiteti, autoriteti i BE-së, identifikimi, rezonanca në BE, frekuenca dhe dendësia e kontakteve) janë tipare e cilësi. Të procesit të evropianizimit. Mekanizmat e drejtpërdrejtë janë ato, në të cilat BE-ja ka marrë një qëndrim proaktiv dhe qëllimisht kërkon të përhapë modelin e rregullat e qeverisjes përtej kufijve të saj. Në kontrast, mekanizmat e tërthortë, jo të drejtpërdrejtë, janë ato, në të cilat

edhe aktorët që s'janë të BE-së kanë rol aktiv ose thjesht prania e BE-së ka gjeneruar efekte të jashtme.

- Sipas logjikës së pasojave, evropianizimi ka proceduar përmes manipulimit të stimujve dhe ndryshimit të llogaritjeve kosto-përfitim në vendet e treta. Në të kundërt, sipas logjikës së përshtatshmërisë, evropianizimi është efekti i autoritetit të perceptuar dhe të legjitimitetit të BE-së, të modelit të saj të qeverisjes apo të normave dhe rregullave të saj.
- Kushtëzimi ka qenë e vijon të jetë një mekanizëm i drejtëpërdrejtë i procesit të evropianizimit, i cili është bazuar në manipulimin e llogaritjeve kosto-përfitim të aktorëve të tjerë të BE-së. BE-ja ka kërkuar të përhapë rregullat e qeverisjes së saj dhe vendosjen e tyre si kushte që aktorët e jashtëm duhet të përmbushnin, në mënyrë që të merrnin rezultatet e duhura dhe të shmangin sanksionet e BE-së;
- Llojet e marrëveshjeve kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga marrëveshjet e tregtisë për pranimin e traktateve, të dispozitave të aksesit në treg dhe ndihma financiare që ka ardhur nëpërmjet tyre. Sanksionet e BE-së janë përqëndruar në pezullimin ose në përfundimin e marrëveshjeve të tilla, megjithatë me mënyrat e saj të qarta BE-ja ka përdorur kushtëzimin me kahje pozitive. Në vend që të vendosë sanksione ndaj shteteve kandidate, ajo i mban ato në dhomën e pritjes për marrëveshjet e ndryshme, derisa ato të plotësojnë kushtet.
- Produktiviteti i këtij mekanizmi ka qenë i lidhur me madhësinë e ndihmave të BE-së, si edhe nga besueshmëria e kushteve të saj. Rezultatet e besueshmërisë kanë qenë të lidhura nga bisedimet e kontaktet me pushtetin qëndror. BE-ja ka qenë vijimisht më pak e varur ose e ineresuar për marrëveshje dhe se partnerët e saj aplikantë e kandidatë do të përfitonin ndihmën e nevojshme vetëm, kur kushtet (kriteret e standardet) të ishin zbatuar.
- Rritja e fuqisë është realizuar nëpërmjet ndikimit të tërthortë të BE-së në llogaritjet kosto-përfitim me aktorët e jashtëm. Në disa raste në kundërshtim me kushtëzimin, BE-ja nuk ka qenë proaktive në promovimin e modelit apo të rregullave të qeverisjes përtej kufijve të saj. Aktorët e jashtëm kanë ndjekur rregullat e BE-së, sepse injorimi ose shkelja e tyre do të kishte gjeneruar shpenzime neto. Firmat që kanë qenë të interesuara të merrnin pjesë në tregun e BE-së duhet të ndiqnin rregullat e procedurat e saj. Vendet, ekonomitë e

të cilave kanë qenë të lidhura ndjeshëm me BE-në duhet të hartonin, të përgatitnin rregulloret e tyre të brendshme, të cilat duhet të ishin në përputhje me rregulloret e procedurat e BE-së.

- Mekanizmat direkte që BE-ja ka implementuar janë përqëndruar kryesisht në kushtëzimet e procesit të evropianizimit. Nëpërmjet tabelës ilustruese (më poshtë) kemi analizuar shkurtimisht mekanizmat e modelit të qeverisjes së mirë evropiane që janë përhapur e janë zbatuar përtej kufinjve të saj.
- Le të ndalemi më konkretisht në këtë tabelë :

	Mekanizmat Direkte (BE)	Mekanizmat Indirekt (aktorët jo anëtar të BE-së)
Arsyeja dhe Pasojat	Kushtëzimet (madhësia dhe kredibiliteti i stimujve, kostot e pajtueshmërisë)	Funksionaliteti (rëndësia e rregullave dhe centralizimi)
Arsyeja dhe Përshtatshmëria	Socializim Implementimi Koncizitet, pasiguri, legjitimitet, autoriteti i BE-së, rëndësia dhe vazhdimësia e kontakteve me BE-në.	

Burimi: Autori

- Kushtëzimet direkte kanë qenë ato në të cilat BE-ja ka pasur rol proaktiv drejt një qëllimi që të shpërndajë rregullat dhe modelin e qeverisjes së saj përtej kufinjve;

Në të kundërt, mekanizmat indirekte që janë identifikuar me aktorët jo anëtarë të BE-së kanë luajtur rol aktiv në promovimin e efekteve të BE-së, si:

- **Evropianizimi**, sipas skemës së arsyes dhe përshtatshmërisë, është një model legjitim nëpërmjet rregullave, normave dhe qeverisjes evropiane;

- **Kushtëzimi** është një mekanizëm i drejtëpërdrejtë i evropianizimit, i cili është i bazuar në manipulimin e llogaritjeve kosto-përfitim të aktorëve të tjerë të BE-së;
- **Funksionaliteti** punon përmes ndikimit të tërthortë të BE-së në llogaritjet e kosto-përfitimit të aktorëve të jashtëm. Në kontrast me kushtëzimin, BE-ja promovon modele pro-aktive nëpërmjet qeverisjes së saj;
- **Socializimi** përfshin të gjitha përpjekjet e BE-së për të përhapur qeverisjen evropiane duke bindur aktorët e jashtëm nëpërmjet ideve dhe normave të tyre. Ky është një mekanizëm i drejtëpërdrejtë i evropianizimit të bazuar në logjikën e përshtatshmërisë;
- **Implementimi** punon në mënyrë të ngjashme, por pa një rol pro-aktiv të BE-së. Përkundrazi, BE-ja shërben si një model i qeverisjes, nëpërmjet të cilave aktorët e jashtëm janë matur;
- Aktorët joanëtarë implementojnë BE-në, sepse ata i njohin rregullat dhe politikat e BE-së si zgjidhje të përshtatshme për problemet e brendshme të tyre;
- Modeli i qeverisjes së mirë dhe mekanizmat evropianizuese për vendet kandidate është realizuar kryesisht nëpërmjet kushtëzimit;
- Aktivitetet kryesore të BE-së kanë qënë të përqëndruara në vendosjen e kushteve për anëtarësim, si edhe në monitorimin e progresit të kandidatëve në përputhje me rrethanat;
- Modeli i qeverisjes së mirë dhe mekanizmat evropianizuese për vendet kandidate ka qënë realizuar kryesisht nëpërmjet kushtëzimeve;
- Në sistemin ndërkombëtar shtetet kanë qënë të pasigurta dhe kanë pasur nevojë për të kërkuar dhe për të implementuar modele;
- Shtetet kanë pasur më shumë nevojë për të zgjedhur BE-në si modelin e tyre, duke zbatuar normat, kriteret e standardet e BE-së, kanë qënë e janë në kontakt të ngushtë me BE-në dhe në këtë mënyrë kanë gjetur qeverisjen e BE-së si modelin më të mirë për të qeverisur vendin e tyre.
- Anëtarësimi është ndihmesa më e madhe që BE-u ka ofruar vendeve joanëtare;
- BE-ja gjithashtu ka qënë e vendosur në zbatimin e kushteve të saj dhe kandidatët kanë pritur që të pranoheshin në të, vetëm pas përmbushjes së kërkesave;

- Kushtëzimi efektiv, ka rezultuar i suksesshëm në marrëdhëniet e vendeve candidate me BE-në.

4.2.1 Mekanizmat evropiane për demokratizimin e institucioneve publike shqiptare

Qëllimi kryesor i kushteve të BE-së për demokratizimin e suksesshëm kanë qenë që në përmjet institucioneve të shteteve candidate të realizonin standartet e kriteret e saj.

Rezultatet e demokratizimit të institucioneve të shteteve candidate, sipas BE-së janë të lidhura me dy kushte kryesore:


1. Mos zbatimi i standardeve dhe i normave të BE-së ka sjellë pasoja në reformat demokratike;
2. Institucionet e dobëta nuk kanë krijuar kushtet e nevojshme për integrimin e shpejtë të vendeve candidate në strukturat e BE-së.

Duke iu referuar këtyre kushteve kemi evidentuar se lidhjet midis shtetit dhe të institucioneve duhet të mbështeteshin mbi disa mekanizma që kanë të bëjnë me konkurrencën e ndershme dhe me përgjegjësinë politike. Konkurrenca demokratike do të siguronte kushtet për qeveritarët në detyrë, të cilët kanë kërkuar të rizgjidhen, të përqëndroheshin më shumë në krijimin e të mirave publike. Kjo do të ndikonte edhe në rritjen e performancës së shtetit.

Procesi zgjedhor dhe ndërtimi i institucioneve sipas standardeve e kriterëve të BE-së duhet të ishte objektiv i rëndësishëm në vendimmarrjet politike, si edhe në hartimin e legjislacionit përkatës. Sipas Hanna dhe Axel *Hadenius (Hanna,2008)*, të cilët kanë theksuar se impakti drejt demokratizimit të shtetit ka gjetur mbështetje për harmonizimin e procesit të demokratizimit me kapacitetet administrative dhe se demokracia duhet të ketë kohën e nevojshme për t'u zbatuar dhe për të ndikuar në gjendjen reale të shoqërisë.

Modeli impakti i modeleve të organizmave ndërkombëtare që kanë vepruar për rritjen e kapaciteteve shtetndërtuese në Republikën e Shqipërisë e kanë drejtuar vendin drejt një qasjeje sa vertikale aq edhe horizontale, të cilën skematikisht e kemi paraqitur, si më poshtë:

Kushtëzimet ndërkombëtare				
pjesëmarrja demokratike	Konkurrenca dhe përgjegjësia politike	Performance	Proceset zgjedhore	Ndërtimi i institucioneve, adoptimit të ligjeve



Mekanizmat kombëtare				
Të nxisë qyterarët për t'u përfshirë në vendimmarrje	Nxitja e elitave politike	Nxitja e debateve mediatike	Nxitja drejt transparencës dhe besueshmërisë qytetare	Nxitja drejt implementimit me standardet evropiane.

Burimi: Autori

Së pari, duke iu referuar skemës së mësipërme kemi ilustruar qasjen evropiane që ka ndjekur Shqipëria për të përmbushur kushtëzimet demokratike, nëpërmjet mekanizmave orientuese;

Së dyti, si institucionet vendimmarrëse në Republikën e Shqipërisë duhet t'i kishin zbatuar.

Kushtëzimet evropiane kanë krijuar mekanizmat nxitëse kanë krijuar impakte në strukturimin demokratik të institucioneve. Qasja në nivel institucional që ka realizuar vendi ynë nëpërmjet këtyre kushtëzimeve është horizontale. Kushtëzimet ndërkombëtare kanë vepruar në sektorë të ndryshëm e ato kanë pasur specifikat e veta.

Nëpërmjet ilustrimit të kësaj qasjeje poshtë-lart, e cila ka qenë një nga strategjitë e rëndësishme evropiane për shqipërinë në procesin shtet-ndërtues të saj, jemi përpjekur të sjellim në vëmendje rolin nxitës të ndërkombëtarëve për institucionet e vendit tonë. Duke e parë procesin në mënyrë kritike ajo që kemi konstatuar nga kushtëzimet e mekanizmat evropiane kemi kuptuar e theksuar se BE-ja e ka orientuar procesin shqiptar drejt pjesëmarrjes së elitave politike e intelektuale.

Ajo ka kërkuar që vendimmarrja mos të jetë radikale dhe të ndjekë vetëm qasjen lart-poshtë, por ka kërkuar që të gjithë aktorët të jenë pjesë vendimmarrëse e procesit të evropianizimit. Përfshirja në vendimmarrjet institucionale e shoqërisë civile, duhet të ishte një nga përparësitë e rëndësishme dhe në këtë mënyrë strategjitë kombëtare për zhvillimin demokratik, ekonomik, social, arsimor e ligjor do të ishin në nivel më të lartë profesional.

Kushtëzimet evropiane, standardet dhe kriteret e saj, për pjesëmarrje të gjerë demokratike të aktorëve të interesuar për procesin e evropianizimit në Republikën e Shqipërisë, do të nxitnin qytetarët për t'u përfshirë në vendimmarrje. Kjo do ta bënte procesin më demokratik, në funksion të qytetarit dhe do të kishte sjellë institucione më të mira.

Konceptet moderne për ndërtimin e institucioneve të shtetit ligjor e shtetit të së drejtës janë pjesë e rëndësishme e procesit të evropianizimit dhe ato janë të lidhura me strategjitë afatgjata të politikës në vendin tonë, të cilat kanë pretenduar të rritin kapacitetet e administratës publike në nivelet evropiane. Konkurrenca dhe përgjegjësia politike duhet të ishin përparësi në skenën politike, pasi vendi ynë ka qenë i karakterizuar për një kohë të gjatë nga mungesa e konkurrencës së ndershme politike, prandaj një nga mekanizmat e nevojshme për të arritur nivelin e përgjegjësisë është nxitja e përkrahja e elitave intelektuale në politikë.

Procesi nuk mund të mbetet vetëm në konturet e brendshme institucionale ku janë informuar vetëm një numër i caktuar drejtuesish apo individësh, por duhej të kërkohej e të synohej arritja e performancës më të lartë profesionale, nëpërmjet debateve e diskutimeve mediatike e veprimtarive të tjera për çështje të ndryshme që janë të lidhura me procesin evropianizimit ku qasja evropiane të kuptohej më mirë e në detaje nga e gjithë shoqëria dhe mos të krijoheshin keqkuptime për rëndësinë e këtij procesi.

Kushtëzimet për ndërtimin e institucioneve, përshtatjes së ligjeve kanë qenë nga çështjet më kritike të procesit të evropianizimit në vendin tonë, ku mekanizmat evropianë kanë qenë të shumtë si në ndihma ekonomike e politike. Në mënyrë që niveli i implementimit të ligjeve apo të rritjes së cilësisë profesionale të stafeve administrative të jetë në përshtatje me standardet evropiane, ky proces kështë ndeshur me vështirësitë e veta edhe pse progres-raportet kanë pasqyruar vlerësime pozitive për dinamikën e ecurisë së administratës publike. Çdo rast është

paraqitur si episod historik dhe ka qenë shoqëruar më tej me mënyrat e udhëzimit përkatëse për t'u institucionalizuar.

Për të treguar elementët thelbësorë të mekanizmave të demokratizimit në vendin tonë, kemi nënvizuar :

- a. hapat e produktivitetit që janë orientuar drejt në procesin e integritetit evropian;
- b. institucionet kanë zbatuar reforma të pjesshme ose sipërfaqësore, të cilat nuk kanë sjellë demokratizimin e nevojshëm të këtyre institucioneve.


Së pari, vendet anëtare kanë përcaktuar standardet e kriteret që janë të domosdoshme e të nevojshme për vendin kandidat, për të qenë "shtet evropian" i ri. Në këtë mënyrë, ky vend u përgjigjet kushteve demokratike dhe ka plotësuar hap pas hapi procesin e vështirë e kompleks të evropianizimit.

BE-ja është e përbërë nga shtete demokratike, të cilat kanë mirëqenie, shtet ligjor dhe në këtë mënyrë efekti e ndikimi saj për demokratizimin e jetën social politike, e në procesin e shtetndërtimit është i madh..

Së dyti, BE-ja e ka orientuar shtetin shqiptar drejt normave e standardeve dhe ka kërkuar që të gjitha institucionet e shtetit shqiptar të realizojnë transformimin demokratik të institucioneve, si element i rëndësishëm i procesit të evropianizimit.

Demokracia është autoriteti, standardi legjitim në BE dhe në këtë mënyrë ka siguruar norma të rëndësishme që vendet kandidate duhet t'i plotësojnë në një organizatë ndërkombëtare rajonale, e cila përfaqëson vlerat e normat e demokracisë, në mënyrë që të rritë zbatimin e kriterëve nga institucionet e vendit kandidatë.

Në këtë kuptim, demokracia përfaqëson një strukturë të qëndrueshme institucionale. Nëpërmjet skemës së më poshtme, kemi ilustruar procesin e demokratizimit dhe të kushtëzimeve të BE-së, të cilat janë propozuar për Shqipërinë:




Burim:Autori

Siç u përmend më lart, kemi ilustruar ciklin e procesit të orientuar nga BE-ja dhe organizatat ndërkombëtare për një proces të suksesshëm të evropianizimit në vendin tonë, përpunimin e mëtejshëm dhe qasjen drejt institucionalizimit të këtyre normave.

Raportet e BE-së me institucionet e shtetit shqiptar i kemi pasqyruar edhe në mënyrë grafike e skematike, të cilat krijojnë përfytyrim e kuptueshmëri për të gjithë dinamikën e procesit të demokratizimit e të reformave që janë kryer në institucione të ndryshme të shtetit në vendin tonë.

Kjo ilustrohet nëpërmjet kësaj skeme:




Burim:Autori

Pavarësisht, faktit se të intervistuarit kanë dhënë përgjigje të ndryshme, lidhur me faktin nëse elitat shqiptare janë pjesë vendimmarrëse në këtë proces evropianizimi, emëruesi i përbashkët i

argumentit qëndron se elitat shqiptare, intelektuale e politike, janë lënë jashtë këtij procesi. Punonjësit në administratën publike, të vjetër e të rinj, vijojnë të jenë të prekur nga rotacionet politike. Termin “elita”, ekspertët e institucioneve shqiptare e konsiderojnë ende shumë të cenuar edhe pse janë krijuar mekanizma të ndryshëm për të promovuar një pjesë të caktuar të elitave që janë pjesë e botës akademike, apo një grupi elitash që përpiqen ta japin kontributin e tyre si shoqëri civile. Vetëm një “elitë” e zgjedhur politikanësh, të cilët kanë mungesë të formimit të tyre intelektual e profesional, arsimimi e morali. Nga përgjigjet ka dalë në pah se vendimmarrja është e lidhur me interesat e botës së biznesit.

Në kuadër të kësaj dinamike evropiane për implementimin e reformave nga qeveritë e ndryshme të vendit tonë kemi analizuar, bazuar nga të dhënat sasiore e cilësore, progresin dhe regresin e nivelit të demokratizimit në institucionet tona. Më poshtë jemi ndalur tek ecuria dhe niveli që ka arritur demokratizimi. E këtë e kemi ilustruar në mënyrë grafike:

Grafiku 1. Realizimi i reformave




Burimi:SPS. V.20

Nga grafiku del qartë se 66.7% e ekspertëve të administratës publike kanë deklaruar se realizimi i reformave ka qënë pjesërisht i implementuar. 25% e tyre mendojnë se ato janë implementuar dhe vetëm 8.3% mendojnë se një pjesë e reformave nuk janë realizuar fare. Këto përfundime na kanë çuar në evidentimin e problematikës së realizimit të vlerave demokratike në ndërtimin e institucioneve.

Nga intervistimet që kemi realizuar me stafet administrave e politike të disa ministrive dhe përfaqësues të delegacioneve të organizatave ndërkombëtare të atashuara në Republikën e Shqipërisë, kemi evidentuar se mekanizmat që janë përdorur për vendin tonë kanë qënë mikse,

si rezultat i problematikave që kanë shoqëruar ndërtimin e formimin e kapaciteteve institucionale. Këtë probematikë e kemi pasqyruar edhe në diagramën e mëposhtme. Pyetja që u është drejtuar ekspertëve të administratës publike, në nivelin e ministrive, është bërë për të evidentuar, nëse kushtëzimet teorike evropiane kanë gjetur implementim praktik për të ndërtuar institucionet demokratike e për të formësuar kapacitetet e nevojshme profesionale.

Grafiku 2. Niveli i Demokratizimit




Burimi: SPS.V.2

Punonjësit e Ministrive janë përgjigjur në këtë mënyre:

- a) 16.7% mendojnë se kemi arritur të kemi një demokraci të suksesshme;
- b) 41.7% mendojnë se kemi demokraci të dobët dhe arsyet, se përse numri më i madh i të intervistuarve mendojnë kështu është për faktin se pikërisht dimensionet e funksionimit të demokracisë janë shumë larg plotësimit të fazave të demokratizimit;
- c) 33.3% mendojnë se kemi një demokraci të cenuar, sinjal ky se një pjesë e dimensioneve funksionale janë prekur dhe janë lëkundur bazat e shtetit demokratik.

Në kuadër edhe të analizës së mësipërme, intervistat dhe pyetësi na kanë ndihmuar që të evidentojmë progresin e reformave institucionale në vendin tonë gjatë disa viteve.

Grafiku 3. Progresi i Qeverisë Shqiptare



Burimi SPS.v. 20

Grafiku i mësipërm tregon se 66.7% e të intervistuarve mendojnë se Qeveria Shqiptare ka arritur progres në realizimin e reformave institucionale. Vetëm 25% mendojnë se kjo reformë është realizuar në mënyrë të pjesshme.

4.3 Qasja evropiane mbi cilësinë e Institucioneve Publike.

Kriteri i cilësisë institucionale është një çështje e rëndësishme e procesit të integrimit evropian. Ai është instrument i dobishëm për të realizuar këtë kusht evropian. Marrëveshjet e ndërsjella kanë çuar në konkurrenca stabilizuese mes BE-së dhe vendeve candidate. Është e arsyeshme që BE-ja të kërkojë konvergjenca institucionale, në mënyrë që BE-ja të jetë më e fortë ekonomikisht dhe politikisht e në këtë mënyrë, kostot e vendimmarrjes të prekin sa më pak vendet aspirante. Përveç përfitimeve të BE-së, kërkesa e cilësisë institucionale ka mundësuar një shtet më të fortë në mënyrë që të vendosë ligje të qëndrueshme demokratike e institucione më të forta.

Roli dhe ndihma financiare që është dhënë nga BE për të krijuar modelin qeverisës sa më konstruktiv, për krijimin e një infrastrukture demokratike, për të bërë anëtarësim të qetë të shteteve candidate në strukturat evropiane, ku demokracia dhe evropianizimi i institucioneve janë elemente kryesore për zbatimin e kriterëve politike për integrimin e një vendi, të përcaktuara nga BE-ja.

Nga pikëpamja teorike kriteret e paraadërimit që një vend aspirant kërkohet të krijojë është stabiliteti institucional. Ai garanton demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin e mbrojtjen e minoriteteve, ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si edhe kapacitetet profesionale për të përballuar trysninë konkurruese e forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Në këtë mënyrë, BE-ja i ka parë shtetet periferike të Ballkanit njësoj si çështje evropiane, duke ndërtuar strukturat e nevojshme evropiane homologe tek shtetet candidate. Ajo që e shqetëson BE-në, në kuadër të procesit të integrimit për këto vende, ka qenë promovimi dhe nxitja që ajo u ka kërkuar t'u bëjë shteteve për të implementuar standardet dhe kriteret, në mënyrë që të

shpejtojnë procesin. Arritja e këtij qëllimi ka qenë e lidhur me aftësinë dhe interesin e aktorëve që e kanë përbërë procesin.

Duke parë dinamikën e BE-së në rrafshin e procesit të integritetit, kemi argumentuar se ajo që i ka shqetësuar vendet anëtare të saj, të vjetra e të reja, ka qenë aplikimi i strategjive se për ndërtimin e Ballkanit është kërkuar një kohe më e gjatë, e krahasuar me atë të vendeve të tjera ish-komuniste të Evropës Qëndrore e Lindore. Përveç kësaj ndarjeje midis dy blloqeve ajo që ka shpresuar BE-ja është se zbatimi i mekanizmave institucionalë evropianë do të ishte produktiv, e realizueshme edhe për shtetet e reja.

Bashkimi Evropian ka kërkuar të promovojë modelin e qeverisjes së mirë në Ballkan, por ai shfaqet në mënyra të ndryshme dhe me rezultate jo të kënaqshme. Kjo ka ardhur si rezultat i problematikave të brendshme, me të cilat shtetet janë përballur. Dinamika e modeleve, të cilat janë promovuar nga BE-ja në raportet e saj me shtetet e Ballkanit janë fokusuar mbi elementët demokratikë liberalë e duke u mbështetur nëpërmjet dy qasjeve (European Commission, 2005):

1. Së pari, një qasje progresive për të prodhuar rezultate të politikës efektive e productive;
2. Së dyti, qasja të ishte përqëndruar tek ndërtimi demokratik i institucioneve, për një qeverisje funksionale e cilësore, ku qeverisja e mirë ka ardhur si rezultat i qasjeve të ndryshme.

Fokusi i këtij modeli ka në qendër të saj qeverisjen si fuqi politike, administrative dhe ekonomike për menaxhimin e punëve publike, duke bërë të mundur në këtë mënyrë një pushtet ekzekutiv funksional e ligjor.

Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe organizma të tjera ndërkombëtare, kanë qenë aktorë kryesorë në promovimin e një qeverisjeje të mirë që BE-ja ka promovuar tek vendet e Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm tek ata, sepse përfshirja e tyre ka mundësuar përmirësimin e menaxhimit të sektorit publik (European Commission, 2005: 85), ka zhvilluar kapacitetin profesional të një pushteti ekzekutiv efikas, ka krijuar kornizat ligjore për zhvillimin dhe për rritjen e transparencës.

Në anën tjetër, rëndësia e aktorëve ndërkombëtarë ka përfshirë aspektin ekonomik të qeverisjes. Ajo ka rritur transparencën qeveritare, efektivitetin e menaxhimit të burimeve publike dhe në këtë mënyrë ka krijuar mjedisin e qëndrueshëm për veprimtaritë e sektorit privat etj.

Dy studiues, Nelson dhe Eglinton (Nelson, dhe Eglinton. 1992) në analizat e tyre mbi ndihmesën e qeverisjes së mirë që BE-ja ka promovuar e kanë vënë theksin pikërisht tek reforma administratës publike, forcimin e ekzekutivit dhe të institucioneve. Ajo që ka qenë e rëndësishme në këndvështrimin e një qeverisjeje të mirë është se shtetet kanë kërkuar të promovojnë dhe të parashtrojnë herë pas here se qeverisja e tyre është efektive, produktive, funksionale e me pirje bashkëkohore, por ende jo demokratike.

Në kuadër të kësaj analize ajo që BE-ja ka promovuar e është përpjekur të realizojë është pjesëmarrja e tyre në trajnime, për modernizimin e procedurave të kontabilitetit, të auditimit, si edhe përmirësim e menaxhimit të buxhetit dhe të shpenzimeve. Kjo formë e ndihmës ka qenë e bazuar dhe e drejtuar për uljen e varfërisë dhe për mundësinë e zhvillimit të ekonomisë e të shoqërisë.

Një qasje tjetër, e cila është përfshirë në promovimin e një qeverisjeje të mirë në ndihmën që ka dhënë për të realizuar procesin e integritetit në mënyrë të suksesshme ka qenë ajo se përveç efektivitetit të qeverisjes së mirë, duheshin edhe elementët demokratikë që do të legjitimonin veprimtarinë qeverisëse.

Neumayer (Neumayer, 2003:8) ka analizuar se kjo qasje ka ndihmuar për të argumentuar arritjet, është referencë për të pasur qeverisje të suksesshme e duke përfshirë në të respektin për politikën, të drejtat civile, të drejtat shëndetësore, sundimin e ligjit, sigurimin e shërbimit publik jo të korruptuar, si edhe përdorimin e burimeve publike në mënyrë të përgjegjshme e transparente.

Burnell (Burnell, 2000) ka kritikuar ndarjen dhe e ka konsideruar të “gënjeshhtërt” raportimin midis ndërtimit të kapaciteteve profesionale dhe ndërtimit të demokracisë. Ai ka deklaruar se administrata publike duhet të jetë e qëndrueshme, nëse ajo duhet të jetë demokratike.

Theksojmë se dimensionin politik, ekonomik e social për promovimin e një qeverisje të mirë, duhet të ishte bazuar pikërisht për promovimin e institucioneve demokratike, të tolerancës shoqërore, legjitimitetin e qeverisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të shtetit ligjor etj., Nën vizionin se roli i ekzekutivit, në vështrim më të gjerë, duhet të përfshinte menaxhimin e sukseshëm të sektorit publik duke kufizuar shpenzimet e panevojshme në fusha të ndryshme e duke krijuar një pushtet ekzekutiv të pavarur dhe të pakorruptuar.

Qeverisja e mirë që BE-ja ka kërkuar të promovonte është bazuar mbi sistemin politik e demokratik ku bashkëpunimi midis shteteve për respektimin e standardeve e kritereve të procesit demokratik e demokratizues duhet të jetë i ndërsjellë e funksional.

Realizimi i një qeverisjeje të mirë nga BE-ja nëpërmjet realizimit të ndihmës nga ana e donatorëve të ndryshëm ekonomikë, politikë e socialë që kanë ndërmarrë iniciativë në zhvillimin e reformave demokratike ka treguar se këto programe kanë rritur ndihmesën e tyre të drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave të stabilizimit dhe të aderimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Shpesh herë BE-ja është përballur me mungesë koherence si në nivel rajonal, edhe në nivel shteti për mos realizimin e kërkesave në kohën e caktuar. Kjo ka sjellë pasoja në realizimin e strategjisë së zhvillimit të vendeve kandidate, të cilët kanë aplikuar e kërkuar për të qënë pjesë e BE-së.

Modeli evropian nëpërmjet mekanizmave të tij evropianizues ka qënë përqëndruar kryesisht në zbatimin e rregullave të institucioneve të shtetit dhe të qeverisjes së saj tek vendet aspirante.

Risia, për të realizuar një qeverisje të mirë institucionale tek shtetet, të cilat janë në proces ndërtimi drejt qeverisjes demokratike e ka vënë BE-në të propozojë përparësitë bazë në nivelin e qeverisjes kombëtare, rajonale, lokale dhe në mbështetje të sfidave, me të cilat shtetet janë përballur. Çdo kriter apo standard është i rëndësishëm për forcimin e qeverisjes gjithnjë e më demokratike. Politikat evropiane në këtë drejtim kanë qënë:

- (a) shumë urdhëruese dhe kërkesat që shtetet anëtare të BE-së kanë miratuar masa të specifikuar në mënyrë që të jenë plotësuar kërkesat në përputhje me normat evropiane;
- (b) të mbyllura, për të ndryshuar mundësinë e strukturave të brendshme;
- (c) në formën e tyre më të dobët, pa ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë institucional,

- nëpërmjet skemës së mëposhtëme kemi ilustruar elementët dallues që e kanë bërë një shtet të realizojë një qeverisje të mirë evropiane, duke pasqyruar rezultatet se si ky model duhej të implementohej tek institucionet qendrore të vendeve kandidate.
- Qeverisja e Mirë është bazuar në 8 kritere, të cilat janë të lidhura me përfocimin e qeverisjes së shteteve kandidate, të propozuara nga institucionet e BE-së. Këto kritere kanë përbërë qeverisjen e mirë sikurse janë:

- a) pjesëmarrja;
- b) konsensus i orientuar;
- c) mbështetja;
- d) transparenca;
- e) përgjegjësia;
- f) efektiviteti;
- g) barazia;
- i) gjithëpërfshirja.

Këto janë kritere të rëndësishëm që kanë përbërë diferencën e konceptit nga termi **“qeverisje”** drejt **“qeverisje e mirë”**. Koncepti qeverisje nuk është i rri, ai është i vjetër sa gjithë njerëzimi, por thjesht **“qeverisje”** është nënkuptuar: një proces vendimmarrës dhe një proces, nga i cili vendimet janë implementuar ose jo.

Qeverisja ka qenë përdorur në kontekste të ndryshme si:


- qeverisja e korporatave;
- marrëdhëniet me jashtë;
- qeverisja kombëtare e lokale.

Qeverisja është një nga drejtimit kryesore të shtetit demokratik, Aktorë të tjerë që janë përfshirë në qeverisje janë të lidhur e të varur nga qeveria.

Kuptimi i **“qeverisjes së mirë”** ka përfshirë një varg mekanizmesh ku secila prej tyre ka historinë e vetë. Nevojat e reja të BE-së dhe mekanizmat që ka pasur në dispozicion kanë krijuar kushte dhe mundësi të reja për hartimin e politikave të reja të qeverisjes. BE-ja dhe Komisioni Evropian në veçanti, kanë shprehur angazhimin e tyre për hartimin e mekanizmave apo të alternativave të reja për format e qeverisjes së mirë.

Risia në sistemet politike ka qenë shpesh një mjet retorik apo strategjik, pra me fjalë të tjera, kur është fjala për çështje bazë të asaj që është e veçantë në lidhje me format e caktuara të qeverisjes nga BE-ja në krahasim me shtetet e tjerë, kemi sugjeruar e pasqyruar disa kriteret të “Qeverisjes së mirë” institucionale, të ilustruara edhe nëpërmjet kësaj skeme të mëposhtme, të cilat kanë pasqyruar rezultatet e mënyrave të implementuar në institucionet publike në vendet kandidate.

“Qeverisja e Mirë Institucionale”



Burimi: UNESCAP 2005

Nga parashtrimet e mësipërme nënvizojmë se qasja evropiane, për të realizuar cilësinë institucionale, në mënyrë që të arrijmë e të zbatojmë “qeverisje e mirë“ është kryesisht e vështirë, jo vetëm në shtetet me potenciale ekonomike e me sisteme demokratike të cenuara, por edhe në shtetet më të zhvilluara. Të realizosh një sistem te pavarur duhet të besosh dhe të kesh punuar fort për të realizuar kriteret e standardet e nevojshme.

Analizën argumentuese të studimit e kemi ndërthurur me analizën sasiore e cilësore që kemi zhvilluar tek disa institucione të Shtetit Shqiptar për të evidentuar, nëse ky kriter i cilësisë institucionale i orientuar e i modeluar nga BE-ja ka ndikuar në përmirësimin e qeverisjes në Republikën e Shqipërisë. Analiza që u kemi bërë intervistave na ka dhënë përgjigjen me specialistët e institucioneve, si edhe nga opinioni i ekspertëve të organizatave ndërkombëtare

që veprojnë në vendin tonë duke iu referuar “qeverisjes së mirë” do ta ilustrojmë e do të ndalemi më konkretisht në vijim.

4.3.1 Rezultatet e modelit evropian mbi “Qeverisjen e mirë Institucionale” të matura në Institucionet publike të Republikës së Shqipërisë

Analiza e zhvilluar në vijim jemi të mendimit se ka konfirmuar ecurinë dhe dinamikën e zhvillimit të modelit të “qeverisjes së mirë evropiane” për cilësinë institucionale të institucionet qendrore në Republikën e Shqipërisë, të bazura në 8 kriteret që kemi cituar më sipër, për të bërë të qartë, nëse procesi i reformave ka arritur të implementojë këto kriterë kyçe(ose jo).


Nga analiza që u kemi bërë të dhënave sasiore dhe cilësore të intervistave me stafet e administratës publike të institucioneve qendrore të pushtetit ekzekutiv dhe me ekspertët e organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Tiranë, në kuadër të zbatimit të reformave evropiane për të realizuar një “qeverisjeje të mirë” institucionale në vendin tonë ka dalë në pah, nëse Qeveria ka mundur të realizojë një qeverisje të mirë, funksionale e demokratike në kuadrin e sfidave evropiane, si edhe cilat prej kriterëve ajo ka realizuar konkretisht? Kjo është një pyetje së cilës të intervistuarit i janë përgjigjur si më poshtë:

1. Pjesëmarrja: ka nënkuptuar rëndësinë, relevancën dhe produktivitetin e politikave të BE-së, të cilat janë të lidhura me sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë në të gjithë zinxhirin e politikave, deri në implementimin e plotë të tyre. Pjesëmarrja e shtuar edhe me grupet e interesit, është bërë për të krijuar më shumë besim në arritjen e rezultatit përfundimtar nga institucionet e ndryshme të shtetit.

Pjesëmarrja është e lidhur me qeveritë qendrore për realizimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, për zhvillimin dhe për zbatimin e politikave të BE-së. Pjesëmarrja ka nënkuptuar edhe përfshirjen e grave e të burrave, të cilët kanë qenë e janë një faktor i rëndësishëm për qeverisjen e mirë. Pjesëmarrja ka qenë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet legjitimitetit të institucioneve që kanë përfaqësuar. Është e nevojshme të theksojmë se në përfaqësimin demokratik është e rëndësishme që të meren në konsideratë grupet e interesit në procesin e vendimmarrjes. Duke iu referuar konceptit evropian për

“qeverisjen e mirë” në qendër të studimit e të analizës kemi pasqyruar edhe se sa pjesëmarrës në vendimmarrje janë ndjerë grupet e interesit në institucionet e shtetit tonë.

a) Pjesëmarrje




Burimi:SPS.v.20

Kjo diagramë, pasqyron se pjesëmarrja në vendimmarrje e grupeve të interesit nuk është realizuar. 50% e tyre mendojnë se nuk ka pasur vlerësim as të specialistëve, as të elitave intelektuale për të marrë vendime dhe për të hartuar ligje në shërbim të interesave të vendit.

2. Zbatimi i ligjit: Për një “qeverisje të mire” është krijuar një strukturë ligjore, e cila duhej të zbatohet në mënyrë të paanshme, ku është kërkuar mbrojtja e plotë e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Zbatimi i paanshëm i ligjeve ka kërkuar pavarësi juridike dhe mos korruptimin e forcat policore. Duke e ilustruar atë me rezultatet sasore, të marra nga ekspertët e DAP-it kemi evidentuar rëndësinë që ka i zbatimit të ligjit për cilësinë e institucioneve në vendin tonë.

b) Zbatues i ligjit




Burimi:SPS.v.20

Në diagramën e mësipërme, kemi konstatuar se qeveritë e ndryshme politike në vendin tonë nuk kanë zbatuar ligjet, sepse 41.7% e të intervistuarve janë shprehur se i kanë shkelur ligjet dhe vetëm 33.3 % e të intervistuarve janë përgjigjur se ligjet janë zbatuar.

3. Transparenca: me këtë janë nënkuptuar që vendimet, të cilat janë marrë dhe zbatimi tyre është kryer në bazë të ligjeve dhe të akteve të ndryshme normative. Gjithashtu, është nënkuptuar se informacioni është i lirë dhe i disponueshëm dhe i arritshëm tek ata që janë prekur nga vendime të tilla e zbatueshmëria e tyre. Është nënkuptuar, se informacioni është siguruar në mënyra të kuptueshme edhe në media. Ja si është vlerësuar kriteri i Transparencës në institucionet tona:

c) Transparent



Burimi:SPS.v.20

Në diagramë, është pasqyruar se Qeveria nuk ka qenë transparente në realizimin e reformave, prandaj diagrama tregon se 41.7% e punonjësve të administratës publike janë shprehur se kriteri i “Transparencës publike” nuk është zbatuar. Vetëm 25% e tyre janë shprehur se qeveria ka qenë transparente në realizimin e reformave.

4. Përgjegjësia: “Qeverisja e mirë” ka kërkuar e kërkon që institucionet e ndryshme të shtetit në Republikën e Shqipërisë t’u shërbejnë më mirë qytetarëve dhe grupeve të interesit, brenda rrafshit të nevojshëm ligjor.

d) Përgjegjës

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Alternativa Jo	9	75.0	100.0	100.0
Të dhëna të humbura	3	25.0		
Total	12	100.0		

Burimi:SPS.v.20

Në këtë tabelë, jemi të mendimit se pasqyrohet qartë se qeveritë e ndryshme, të majta apo të djathta, në kuadër të implementimit të një "qeverisjeje të mirë", sipas kritereve e standardeve evropiane, nuk kanë qenë të përgjegjshme.

- Konsensusi i orientuar: "qeverisja e mirë" ka kërkuar e kërkon ndërmjetësim të interesave të ndryshme shoqërore për arritjen e konsensusit të gjerë në shoqërinë shqiptare. Ai është në interes të të gjithë komunitetit dhe mënyra se si ai duhet arritur ka kërkuar nga të gjithë aktorët e interesuar që të bëhen pjesë e tij, sepse vetëm në këtë mënyrë do të realizoheshin në vendin tonë standardet e kriteret e BE-së, pra procesi i evropianizimit. Ilustrimi i mëposhtëm pasqyron dinamikën e zbatimit të kriterit konsensus i orientuar nga strukturat e ndryshme të shtetit në vendin tonë.

dh) Konsensus i orientuar



Burimi:SPS.v.20

Në diagramën e mësipërme vërehet se 41.6% e të intervistuarve janë shprehur që nuk është realizuar konsensusi i orientuar për arritjen e interesave të shoqërisë, si edhe për realizimin e një “qeverisjeje të mirë” nën monitorimin nga institucionet ndërkombëtare për krijimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale e për institucione të qëndrueshme. Vetëm 33.3% e tyre kanë qenë të mendimit se është realizuar ky konsensus.

6. Barazia dhe përfshirja: shoqëria demokratike është e lidhur ngushtë me këtë kriter, sepse anëtarët e saj e ndiejnë se duhet të përfshihen dhe të kenë mundësinë të përmirësojnë vendimmarrjet e ndryshme.

e) Barazi dhe gjithëpërfshirje

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Alternativa Jo	9	75.0	100.0	100.0
Të dhëna të humbura	3	25.0		
Total	12	100.0		


Burimi:SPS.v.20

Pavarësisht se punonjësit e institucioneve qendrore kanë evidentuar mungesën e barazisë dhe gjithëpërfshirjes në proces, e kanë cilësuar këtë si një proces të gjatë dhe të rëndësishëm, siç është formimi i kapaciteteve profesionale, i cili ndër vite është shoqëruar me kriza dhe me problematika të ndryshme qeveritare.

7. Efektiviteti: “Qeverisja e mirë” ka nënkuptuar se procesi i ndërtimit të institucioneve ka qenë e është i lidhur me nevojat gjithnjë në rritje të shoqërisë. Ka qenë e nevojshme të përdorëshin burimet më të mira që kanë qenë në dispozicion. Koncepti i efektivitetit në rrafshin e “Qeverisjes së mirë”, gjithashtu duhej të përfshinte përdorimin e burimeve natyrore, si edhe mbrojtjen e mjedisit. Politikat duhet të ishin efektive në çdo kontekst kohor. Ka qenë e nevojshme që në bazë të objektivave të vendosura të kryehej vlerësimi

për ndikimin që përvoja e fituar e profesionalizmi të ndikonte pozitivisht për zbatimin e këtij kriteri dhe e të tjerëve. Efektiviteti ka qenë i lidhur edhe me zbatimin e politikave të vendosura nga BE-ja për marrjen e vendimeve më të përshtatshme.

f) Efektiv dhe eficientë




Burimi:SPS.v.20

Diagrama e mësipërme pasqyron se 50% e të intervistuarve kanë mendimin se Qeveria dhe institucionet e tjera nuk kanë realizuar qeverisjen efektive dhe eficiente. Vetëm 16.7% e tyre kanë menduar se ky proces është realizuar me sukses nga qeveritë e vendit tonë.

8. Mbështetja: është kriter i rëndësishëm i “Qeverisjes së mirë”, jo vetëm për institucionet publike, por edhe ato jo publike, për biznesin privat dhe organizatat e shoqërisë civile. Në përgjithësi institucionet apo organizatat që janë mbështetur janë ato që kanë luajtur rol nëpërmjet vendimmarrjeve të ndryshme. Mbështetja duhet të ishte shoqëruar nga transparenca dhe zbatimi i legjislacionit përkatës. Rolet në proceset legislative dhe ekzekutive duhet të ishin më funksionale. Secili nga institucionet e BE-së duhej të shpjegonte dhe të merrte përgjegjësinë për atë që ka bërë e bën në Evropë. Gjithashtu, ka qenë e nevojshme për veprimtari më bindëse, si edhe përgjegjësi nga shtetet anëtare të BE-së që ato të përfshiheshin dhe të ndikonin për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të BE-së në çfarëdo niveli në institucionet e vendit tonë.

g) Mbështetës



Burimi:SPS.v.20

Pavarësisht se si ka ecur procesi diagrama, tregon se qeveria e vendit tonë nuk ka qenë mbështetëse për grupet e interesit në mënyrë që të realizoheshin më shpejt reformat. Rreth 41.7% e të intervistuarve janë të mendimit se nuk është realizuar mbështetja nga forcat politike. Vetëm 33.3% mendojnë se ka pasur mbështetje politike për grupet e interesit në përmirësimin e kapaciteteve institucionale.

Çdo kriter është i rëndësishëm, por asnjëri prej tyre nuk mund të arrihet, nëse nuk shoqërohet nga kriteri tjetër. Zbatimi i këtyre kriterëve ka përbërë e përbën sfidën e madhe për procesin e evropianizimit në vendin tonë.

4.4 Rëndësia e statusit kandidat: arsyet e vonesës së Shtetit Shqiptar

Marrëdhëniet e BE-së me vendet candidate për anëtarësim kanë qenë një rast i rëndësishëm i evropianizimit të tyre përtej kufijve formalë të BE-së. Përpara procesit të anëtarësimit, duke filluar negociatat me anëtarët e ardhshëm, BE-ja është përqëndruar në parimet e përgjithshme të qeverisjes evropiane. Ajo është mbështetur në mënyrë të veçantë tek kriteret politike të lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektit për të drejtat e njeriut të përcaktuara nga traktati i Bashkimit Evropian, si kriteret e domosdoshme për anëtarësim.

Gjatë negociatave të zhvilluara për procesin e anëtarësimit u është kushtuar rëndësi e veçantë rregullave, kriterëve e standardeve, çështjeve të veçanta të qeverisjes evropiane. Bisedimet e zhvilluara kanë sugjeruar hapjen që nuk ka ekzistuar në procesin e pranimit. Rezultati themelor i negociatave, ka qenë në masën më të madhe i parapërcaktuar. Bisedimet për pranimin e

vendeve kandidate në BE janë përqëndruar kryesisht në procesin e përgatjes së legjislacionit përkatës, të shqyrtimit dhe të raportimit për zbatimin e tyre.

BE-ja ka shpjeguar për vendet aplikante, ka vlerësuar kufizimet e mangësitë e tyre dhe vijimisht ka monitoruar procesin e hartimit të ligjeve sipas standardeve e kriterëve të BE-së. Negociatat janë mundësia e vetme për zbatimin me sukses të procesit të evropianizimit në vendin tonë.

Mekanizmat evropianizimit të vendeve kandidate kanë qenë e janë të kushtëzuara, pra janë të lidhura me ato kriterë e standarde që BE-ja ka kërkuar e kërkon nga çdo vend që do të bëhet pjesë e saj. Veprimtaritë kryesore të BE-së janë përqëndruar në vendosjen e kushteve për anëtarësim e në monitorimin e progresit të vendeve kandidate. Dhënia e shpërblimit, e ndihmave konkrete ka qenë e lidhur në përputhje me rrethanat. Kushtet për kushtëzimin efektiv kanë qenë zakonisht të favorshme në marrëdhëniet e vendeve kandidate me BE-në. Anëtarësimi është “shpërblimi” më i madh që BE-ja ka ofruar për vendet jashtë bllokut të saj.

Kjo u ka dhënë atyre qasje të plotë dhe të drejta të barabarta në tregun e brendshëm, fondet, në institucionet vendimmarrëse, mjetet ligjore më të rëndësishme ekonomike e politike. Përveç kësaj, besueshmëria tek kushtëzimet ka qenë në përgjithësi e lartë. Ndërvlerësia ka qenë në favor të BE-së për shkak të ekonomisë së vendeve kandidate, të cilat kanë qenë e janë të një rëndësie më të vogël në BE, sesa tregu i BE-së kundrejt vendeve kandidate.

Në këtë mënyrë, BE-ja ka mundur të përballojë vendosjen e kushteve strikte, në raste të caktuara me disa përjashtime. BE-ja ka qenë e vendosur në zbatimin e kushteve të saj dhe vendet kandidate duhej të pritnin që të pranoheshin, vetëm pas plotësimit të tyre.

Në rastin e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore, kemi vëzhguar se miratimi i rregullave e politikave të BE-së ka qenë selektiv dhe me hope gjatë periudhës së tranzicionit të hershëm. Shpesh ajo është ndjekur nga tradita vendase ose nga rregullat e organizatave të tjera ndërkombëtare. Pasi u ishte afruar perspektiva e besueshme për anëtarësim, politikat e tyre publike konvergjuan me modelet e BE-së, me përjashtim të atyre çështjeve, në të cilat BE-ja ka kompetenca të dobëta ose rregulla të papërcaktuara.

Shpenzimet e brendshme të panevojshme nga qeveritë e vendeve kandidate kanë qenë pengesa kryesore për kushtëzimin efektiv të këtyre vendeve. Lidhur me kushtëzimin politik liberalo-

demokratik, këto shpenzime kanë qenë penguese për sistemet e reja politike, ku ruajtja e pushtetit ka qenë e lidhur me praktikat dhe institucionet jodemokratike. Ka qenë ofertë e besueshme e tërheqëse anëtarësimi në BE, por ajo nuk mund të kthehej në llogaritje përfitimi.

Në këtë vijë logjike, argumentet e studimit janë bazuar në përballjen e prirjeve të mëdha duke vepruar në këtë mënyrë së bashku, duke u përpjekur në “imponimin” e vlerave dhe të normave që evropianët janë përpjekur të promovojnë në identitetin e Shqipërisë. Në anën tjetër, ato mund të vëzhgoheshin si përpjekje për të zbutur politikat ekzistuese nëpërmjet harmonizimit të procedurave, në mënyrë që të bëjnë të mundur realizimin e integritit të tyre në BE.

Ku qëndron Shqipëria sot në implementim e procesit evropian? A ka qenë e është ajo e gatshme? Cilat janë përpjekjet e strategjitë e BE-së për të realizuar me sukses implementimin e procesit të integritit të vendit tonë?

Në këtë proces të gjatë evropianizimi, atë çfarë i ka shoqëruar qeveritë shqiptare ka qenë e është politika e jashtme, e shoqëruar nga toleranca e kompromisi, edhe pse herë pas here ngjyrat politike të brendshme janë karakterizuar nga mungesa e seriozitetit. Pavarësisht notave negative të ardhura nga ndërkombëtarët, Shqipëria ka shënuar progrese të larta. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Associmit ka treguar progresin e rëndësishëm në rrugën e implementimit të procesit integruar.

Përgatitjet për anëtarësim në BE dhe negociimi kanë qenë e janë procese të ndërlidhura, ku secili është i dallueshëm dhe ka ndjekur një logjikë të vetën. Përgatitjet për anëtarësim kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit tonë, si edhe me përafrimin e sistemit tonë me normat e BE-së, duke u përpjekur të veprojmë si vetë vendet anëtare të BE-së.

Një nga sfidat evropiane që shtrohet sot përpara elitës politike shqiptare, shoqërisë civile dhe të gjithë popullit në kuadër të plotësimit të standardeve e kriterëve evropiane ka qenë e është plotësimi i tyre për hapjen e negociatave që nga mometi i marrjes së statusit të vendit kandidat. Sfidat e realizimit të procesit evropianizues të vendit tonë, si për çdo shtet kandidat për t'u pranuar në BE janë të lidhura me detyrat e strategjitë e mundshme për marrjen apo dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë. Vendet fqinje jemi të mendimit se sot janë në një udhëkryq si rezultat i situatave politike e ekonomike të brendshme të këtyre shteteve.

Në këtë vështrim nuk do të ketë më “Big Ban”, për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe aktualisht BE-ja ka hartuar strategji të reja lidhur me ecurinë e procesit për çdo vend kandidat të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Procedura për anëtarësimin në institucionet e BE-së është sa komplekse, aq dhe dinamike. Kjo ka bërë të mundur që procedura e aplikimit të fillojë me paraqitjen e kërkesës për anëtarësim nga vendi aplikues.

Menjëherë Këshilli ia përcjell Komisionit duke i kërkuar një Opinion /Avis, nëse vendi aplikant është i gatshëm për hapjen e negociatave. Ky vlerësim normalisht kalon nëpërmjet dy planeve: politike e teknike, të cilat kalojnë si një çështje pa debat në mbledhjet e Këshillit (Progres Raporti i Komisionit Evropian, 2009).

Përveç aspekteve teknike të procesit, rëndësi thelbësore kanë reformat e marra nga Qeveria Shqiptare, të cilat janë vlerësuar si “thembra e Akilit” për procesin e integritimit. Vlerësimet në çdo fundviti nga Komisioni Evropian kanë paraqitur problematike në procesin integruar të Shqipërisë. Më kryesore kanë qenë mos realizimi i shtetndërtimit (reformat institucionale), korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Në këtë vlerësim në dinamikën e procesit integruar është vënë re që kjo problematikë është kthyer në një problem serioz për Shqipërinë. Progresi është bërë në disa fusha kryesore:

- në hartimin e ligjeve;
- strategjive;
- planeve të veprimit;
- për krijimin e strukturave të institucioneve të reja.

Nga ana tjetër, moszbatimi i legjislacionit si problemi më kryesor i evidentuar, ka zhvlerësuar pjesën më të madhe të këtyre arritjeve. Vlerësimet e dhëna nga Komisioni Evropian të fokusuar në mos realizimin e Kriterëve të Kopenhagenit kanë mbetur e mbeten shqetësim për axhendën e qeverive të vendit.

Element i rëndësishëm në këtë proces ka qenë edhe realizimi i plotësimit të Pyetësorit (*Progres Raportin e Komisionit Evropian, 2009*) nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ky proces është

zhvilluar në mënyrë diskrete dhe konfidenciale, sipas çdo prioriteti të institucionit përkatës. Në kuadër të kësaj ecurie, Qeveria Shqiptare ka dërguar dokumentacionin me përgjigjet specifike. Komisioni Evropian ka përgatitur Opinionin me vlerësimin përkatës dhe ka pasqyruar, nëse vendi kandidat ka qenë i gatshëm për të filluar procesin e negociatave, pasi të jetë vendosur në mënyrë unanime nga të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Politika e ndjekur nga BE ka marrë shkas nga rezultatet, si edhe nga rrethanat që janë ndeshur në fushën e politikës apo ndërtimit të institucioneve.

Nga këndvështrimi krahasues ndër vite, ajo që vihet re në kuadër të këtij procesi evropianizimi apo procesi demokratik Shqipëria në disa fusha specifike është karakterizuar nga notat pozitive. Rruga e ndjekur nga Komisioni, sipas orientimeve të bëra nga Këshilli për dhënien e statusit kandidat, vetëm në ndonjë rast të veçantë është hedhur poshtë, si rezultat i situatave gjeopolitike apo ndonjë rasti tjetër. Ajo që e identifikon rastin shqiptar ka marrë shkas si rezultat i problematikave që janë ndeshur në fushën e dialogut politik apo në mos ndërtimin e institucioneve demokratike.

Krahasuar me strategjitë e ndjekura nga BE-ja në rastet e shteteve të tjera, rekomandimi për aprovimin e marrjes së statusit kandidat nga shteti ynë ka qenë identifikuar me një rast të vecantë, i cili do të realizohej vetëm ndërmjet tolerancës midis paleve politike në mënyrë që të rekomandohej nga BE-ja hapja e negociatave për anëtarësim.

Rastet e vlerësimit nga Komisioni Evropian, ndër vite, kanë qenë të ndryshme dhe kemi nga ato raste si me shtetet : Greqia, Sllovakia (*hapjes së negociatave me Greqinë në vitin 1976*), etj., të cilat në vitet e tyre si vende candidate kanë marrë vlerësime negative nga Komisioni dhe janë parë sigurisht më përparësi duke iu dhënë mundësinë e plotësimit të kriterëve përkatës, deri në momentin e anëtarësimit të plotë të tyre.

Skenar tjetër në vlerësimin e Komisionit ka qendruar, kur i është dhënë mundësia për marrjen e statusit, por jo hapjen e negociatave. Janë vlerësuar reformat e bëra nga shteti përkatës, si në politikën e brendshme, ashtu dhe në atë rajonale.

Situata aktuale për Shqipërinë sipas vlerësimeve negative të Komisionit sigurisht që janë një “tërheqje veshi” për shqiptarët në kryerjen e reformave demokratizuese, i është shtuar edhe kriza e gjatë politike, e cila ka bërë që modeli evropian për Shqipërinë të jetë specifik, krahasuar me modelet e aplikuara tek shtetet e tjera.

Kemi tashmë vlerësimin jo pozitiv, por kemi edhe vlerësime progresi apo gjysëm progresi për vendin tonë. Në të njëjtën kohë, kemi vlerësimin e ri për ta kaluar këtë periudhë tranzitore, deri në marrjen e statusit të vendit kandidat.

Dinamika e 12-të detyrave për shtetndërtimin në Republikën e Shqipërisë ka qenë një nga sfidat më problematike për palët politike. Ajo ka qenë e lidhur me funksionimin e duhur të Kuvendit, të zgjedhjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, standardeve për funksionimin e gjyqësorit, luftën kundër krimit të organizuar, respektimin e të drejtave të pronësisë, të grupeve vulnerabël, përmirësimin e trajtimit të personave në paraburgim. Këto dhe kritere të tjera e kanë shoqëruar këtë proces të gjatë të integritetit të Shqipërisë.

Analiza që kemi shtjelluar më mësipër na ka lënë të kuptojmë se qëndrimet kritike për mos realizimin e të gjitha kriterëve apo në mos implementimin e reformave për institucione demokratike në vendin tonë, mbetet detyrë e rëndësishme. Është e nevojshme të gjenden mekanizmat e duhur midis grupeve partiake në mënyrë që ato të gjejnë së bashku çelësin e suksesit për të realizuar procesin e integritetit evropian.

Rëndësia e procesit integruar është e lidhur me gjetjen e urave bashkëpunuese midis të gjitha palëve të interesuara në këtë proces. Zhvillimi kulturor dhe arsimor i shoqërisë, sipas të gjitha standardeve të sotme evropiane ka qenë dhe është një model suksesi. Skenarët e zgjidhjes së këtij ngërçi të gjatë politik në vendin tonë kanë qëndruar te vullneti politik i drejtuesve politikë, të majtë e të djathtë dhe jo tek justifikimet mbi raportet vjetore të BE-së, pasi verdikti tyre është thjesht konkluzion i veprimeve tona.

Në rrafshin e argumenteve të mësipërme sot procesi i evropianizimit të Shqipërisë dhe modeli evropian po ndjekin një qasje tjetër që nga momenti, kur Shqipëria ka fituar statusin e vendit kandidat (qershor 2014), pasi Komisioni Evropian ka vlerësuar progresin politik dhe institucional

të kryer. Komisioni Evropian, në kuadër të këtyre progreseve, ka vendosur udhërrëfyes prioritetesh, në mënyrë që procesi evropianizues të shkojë përpara drejt hapjes së negociatave.

Qëndrimi i organizmave ndërkombëtare në rrafshin e këtyre prioritetëve ka qenë i vendosur se, nëse Shqipëria nuk i plotëson këto reforma hapja e negociatave do të ishte një proces i vonuar. Një ndër kushtëzimet evropiane ka qenë reforma institucionale, prandaj në fokus të punimit tonë është vënë analiza e procesit dhe për këtë kemi intervistuar ekspertët e huaj dhe shqiptarë. Kjo na ka ndihmuar për evidentimin e progresit apo regresit e bërë për përmirësimin e kapaciteteve profesionale në institucionet e ndryshme të vendit tonë.

Rruga drejt Bashkimi Evropian është e sigurtë, pasi vlerat e saj si organizatë janë përfshirë, brenda çdo shteti që ka qenë i gatshëm për t'u përballur me sfidat ekonomike e politike që BE-ja ka përcaktuar për atë. BE-në duhet ta shikojmë si një strehë ku vlerat tona si komb ndërthurren dhe na identifikojnë me të njëjtat vlera, si shtetasit evropianë.

Pavarësisht argumenteve të mësipërme, Shqipëria ka bërë një rrugëtim të gjatë e progresiv në kuadër të procesit të evropianizimit. Përmirësimet dhe reformat e ndërmarra janë tregues pozitivë kundrejt kritikave evropiane në rrafshin e plotësimit të standardeve. Është treguar se, kur ekziston dëshira dhe bashkëpunimi, suksesi është i sigurtë. Për aq kohë, sa mekanizmat e suksesit janë gjithmonë në dorë të klasës politike, të qeverive dhe të qytetarëve atëherë e ardhmja e të gjithë qytetarëve shqiptarë do të jetë më e mirë dhe procesi evropianizimit më i lehtë për t'u realizuar.

4.5 Efikasiteti dhe performanca e institucioneve koordinuese në procesin e integrimit evropian në Republikën e Shqipërisë

Për koordinimin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Qeveria Shqiptare ka ngritur një numër organesh koordinuese e drejtuese, të cilat kanë për detyrë në kuadër të procesit të integrimit evropian. Të gjitha institucionet e vendit kanë për mision të plotësojnë e të realizojnë performancën e reformave në nivel kombëtar dhe në atë ndërkombëtar. Në rrafshin e kësaj sfide të përbashkët, disa prej institucioneve kanë funksion më teknik në këtë proces, sikurse është Ministria e Integrimit Evropian, e cila ka bërë të mundur koordinimin e procesit me institucionet e tjera të linjës, për të përafruar legjislacionin vendas me atë të Bashkimit Evropian, hartimin e politikave të integrimit, bashkërendimin e ndihmave financiare të akorduara nga Bashkimi Evropian, si edhe për informimin e publikut për këtë proces të rëndësishëm.

Ministria e Integrimit Evropian, ka monitoruar përgatitjet e institucioneve shqiptare dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të stabilizim - asociimit. Ajo ka bashkërenduar, ka monitoruar dhe ka raportuar për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, të cilat kanë dalë nga takimet e përbashkëta me Bashkimin Evropian, në nivele të ndryshme. Ajo ka bashkërenduar punën dhe ka ndihmuar ministrinë e linjës me institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit.

Në këtë proces koordinimi me Ministrinë e Integrimit janë përfshirë edhe institucionet e tjera si Komitetit Ndërminstrior për Integrimin Evropian (KNIE) Komiteti të Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE) për drejtimin, monitorimin dhe koordinimin e realizimit të angazhimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në nivel politik dhe administrativ, si edhe GNP(grupet ndërministrorë të punës), të cilat kanë pasur për qëllim të realizonin bashkëpunimin dhe komunikimin ndërinstitucional në nivelin teknik, me synimin për të zbatuar angazhimet në kuadrin e dokumenteve të politikave për integrimin evropian.

Punimi ka sjellë në vëmendje edhe rëndësinë që kanë pasur këto struktura institucionale për ecurinë e procesit evropian. Ato kanë krijuar mundësinë e monitorimit të zhvillimeve dhe të problematikave që kanë hasur këto institucione. Gjithashtu, kemi konkluduar me rezultate të

matshme nga të dhënat sasiore e cilësore që janë analizuar, si edhe kanë qenë objekt i shtjellimit e i analizës në çështjet në vijim.

4.5.2 Rezultatet mbi monitorimin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian (KKIE)

Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që është ngritur pranë Kuvendit të Shqipërisë. Ai ka nxitur dhe ka garantuar bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike e shoqërisë civile, si edhe ka siguruar rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integrimit (Vendim KKI,2015)

Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian është një institucion i ri i ndërtuar në gjashtë mujorin e fundit të vitit 2015, i cili ka ardhur si një nismë, jo vetëm ndërkombëtare, por edhe kombëtare e Qeverisë së Shqipërisë. Ky është institucion në nivel legjislativi për krijimin e koordinimit institucional dhe balancimin e vendimmarrjeve të procesit të integrimit midis forcave politike. Ky institucion sot ka rol të rëndësishëm për ta çuar përpara procesin e integrimit evropian dhe për të krijuar mekanizmat e duhura që bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të jetë më i suksesshëm.


Gjatë vëzhgimit që i kemi bërë funksionimit të këtij institucioni, kemi vërejtur e konstatuar se qëllimi i tij kryesor, përveç bashkëpunimit legjislativo-ekzekutiv, në rrafshin e prioriteteve evropiane, ka qenë sfida e madhe që ky institucion të shërbejë si urë lidhëse për ta çuar Kuvendin e Shqipërisë drejt Parlamentit Evropian. Ai siguron diskutim të vijueshëm për politikat e integrimit evropian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, nga shoqëria civile dhe nga aktorë të tjerë të interesuar.

Nga ecuria që ka pasur ky institucion kemi konstatuar se mënyra e organizimit ende nuk ka marrë formën e duhur, por ajo që ka mbetur si risi në ecurinë e procesit ka qenë pjesëmarrja e shoqërisë civile, e cila përherë të parë ka qenë pjesë vendimmarrëse në institucionet kombëtare për të nxitur ecurinë e procesit të integrimit. Rëndësia që ka opinioni i shoqërisë civile ka bërë të mundur që ky institucion të funksionojë mbi bazën e profesionalizmit dhe ka bërë të mundur që vendimmarrjet të jenë në shërbim të qytetarëve.

Duke analizuar indikatorët sasiorë dhe cilësorë për monitorimin institucional, kemi arritur në përfundimin se nxitja e këtij institucioni kundrejt institucioneve të tjera ka bërë të mundur angazhimin më të madh nga ministrinë përkatëse.

Në kuadër të kësaj qasjeje të ndjekur nga shteti ynë aktualisht, duke ndjekur edhe modelin kroat për ndërtimin e institucioneve monitoruese për dinamikën e zhvillimit të procesit evropian është ndërtuar Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian. Modeli kroat ka ndjekur një koordinim horizontal që ka nënkuptuar bashkëpunimin ndërmjet pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv. Në mënyrë që të pasqyrojmë rolin funksional të veprimtarive të qeverive përkatëse, si edhe të institucioneve të ndryshme të shtetit, analiza jonë është përqëndruar te intervistat me fokus grupet, për të evidentuar opinionin e tyre mbi procesin e këtij institucioni që është i sapokrijuar në Shqipëri. Nga intervistat kemi arritur në disa konkluzione, si më poshtë:

Grafiku 1. Ecuria e Këshillit Kombëtar të Integrit Evropian për periudhën 2015



Burimi:SPS.V20


Nga grafiku i mësipërm vërejmë se 60% e të intervistuarve janë të mendimit se roli i këtij institucioni të krjuar për monitorimin e procesit të integrit ka funksionuar pozitivisht. Vetëm 40% janë të mendimit se roli i saj nuk është ende produktiv dhe se ai mund të dështojë, si në Republikën e Kosovës apo në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë.

Duke parë funksionimin e këtij institucioni, edhe në vendet e tjera të rajonit si një qasje orientuese e BE-së për të ndihmuar koordinimin drejt një qasjeje horizontale midis institucioneve, ka treguar se impakti i organizmave ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve institucionale për “qeverisje të mirë”, po ecën drejt suksesit.

Pyetjes sa i rëndësishëm është ngritja e këtij institucioni për ta çuar përpara procesin e integritit?

I janë përgjigjur punonjës të niveleve të ndryshme të Administratës Publike. Kjo pyetje është përqendruar më shumë te Ministria e Integritit Evropian dhe Ministria e Punëve të Jashtme, si dy institucione kyçe, të cilat e kanë vlerësuar koordinimin lidhur me çështjet më të rëndësishme të realizimit të reformave në vendin tonë.

Grafiku 2: Koordinimi Institucional i Këshillit Kombëtar të Integritit




Burimi:SPS.V20

Nga përgjigjet e specialistëve është evidentuar se 30% e tyre kanë theksuar që koordinimi me institucionet e pavarura apo me shoqërinë civile ende nuk është në nivele të larta, pasi informacioni prej tyre ka ardhur me vonesë dhe nuk ka përfshirë opinionet e tyre. 70% e tyre, kanë mendimin se koordinimi e funksionaliteti i këtij institucioni, edhe pse sfida është e madhe për këtë institucion. Deri tani ka pasur pak zhvillime në veprimtarinë e këtij institucioni, por ai

ka ndikuar për të shtyrë reformat më përpara dhe specialistët e fushës të bëhen më përgjegjës në realizimin e reformave e koordinimi mes institucioneve të jetë i suksesshëm.

Pyetjes: A jeni të mendimit se roli i Këshillit Kombëtar të Integrimit European (KKIE) po funksionon si një model suksesi?

Grafiku 3:KKIE funksionon si model suksesi




Burimi: SPSS.v.20

Nga grafiku i mësipërm, ka dalë në pah nga të intervistuarit :

- 90% e tyre janë të mendimit se ky model po funksionon mirë për koordinimin midis institucioneve;
- Vetëm 10% e intervistuesve janë të mendimit se mund të ndiqnim modele të tjera: modelin gjerman dhe jo atë kroat. Ata janë shprehur se modelet perëndimore mund të ndihmonin më shumë nxitjen drejt realizimit të reformave.

Pyetjes: A mendoni se avantazhet institucionale të modelit kroat për Këshillin Kombëtar të Integritetit Europian(KKIE) do të arrijnë të krijojnë kapacitetet e duhura për të integruar Kuvendin e Shqipërisë në Parlamentin Evropian?

Grafiku 4: Kapacitetet për Kuvendin e Shqipërisë me Parlamentit Evropian



Burimi: SPSS.v.20

Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur në këtë mënyrë: 60% e specialistëve janë të mendimit se ky institucion do të krijojë kapacitetet e nevojshme për ta integruar Kuvendin e Shqipërisë me Parlamentin Evropian;

-Vetëm 20% e të intervistuarve janë të mendimit se reformat nuk janë implementuar të plota, sipas kushtëzimeve evropiane. Ata janë shprehur se integrimi i Kuvendit të Shqipërisë me Parlamnetin Evropian është ende një sfidë e madhe e këtij institucioni.

Pyetja : A synon KKIE të përpunojë rekomandime për institucionet?

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid Po	10	100.0	100.0	100.0

Burimi: SPSS.v.20

Kësaj pyetje i janë përgjigjur të gjithë pozitivisht, duke argumentuar se ky institucion po arrin të përpunojë rekomandimet ndërkombëtare. Ai ka nxitur institucionet shqiptare drejt implementimit të reformave. Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian është një institucion që po konsolidohet, duke përfshirë edhe rolin e shoqërisë civile në përmirësimin e procesit integruar.

Në këtë mënyrë, vëmendja është kthyer tek roli që ka shoqëria civile në përmirësimin e reformave. Një çështje tjetër e rëndësishme që mbulon KKIE janë funksionet e saj, është rëndësia që ka ajo në “Procesin e Berlinit”, një nismë e re ndërkombëtare për të përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor në një bashkëpunim rajonal të përbashkët.

4.5.3 Rezultatet e monitorimit të strukturave koordinuese për procesin e integrimit evropian: MIE, KNIE, KKNIE DHE GNP


Minsitria e Integrimit Evropian merr pjesë në veprimtaritë e grupeve të punës, të ngritura nga institucione të tjera shtetërore, për hartimin e programeve të ndryshme për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ajo shkëmben të dhëna, organizon takime periodike në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar. Ajo ka trajnuar stafin e ministrive të linjës dhe të institucioneve të tjera në funksion të procesit të integrimit evropian. Ministria e Integrimit Evropian në marrëdhëniet me të tretët:

- a) bashkërendon punën për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e integrimit evropian;
- b) propozon ngritjen e grupeve teknike të punës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që kanë rrjedhur nga procesi i integrimit evropian;
- c) kërkon nga ministrinë e linjës dhe nga institucione të tjera qendrore përgatitjen e paraqitjen në afatet e caktuara të dokumenteve, në funksion të procesit të integrimit evropian;
- d) njofton organet përkatëse të Bashkimit Evropian për përafrimin e akteve normative vendase me ato të Bashkimit Evropian;
- e) përgatit dhe paraqet raporte për procesin e integrimit evropian në Komitetin Ndërmnistor të Integrimit dhe në Komitetin e Koordinimit Ndërinstitucional për integrimin evropian.(VKM nr:946,2013)

Duke analizuar përgjegjësitë e funksionimit të këtij institucioni kemi konstatuar se gjatë monitorimit të këtij institucioni nga takimet me drejtues drejtorie të rëndësishme, koordinimi ndërinstitucional nuk ka qenë gjithmonë i suksesshëm.

Grafiku1: MIE në koordinimin Institucional



Burimi: SPSS.v.20

Të dhënat që dalin nga ky grafik dhe nga argumentet bindëse të mara nga specialistët tanë janë në një situatë ku:

- 30% e tyre janë të mendimit për mos përgjegjësin e stafeve që janë përgjegjëse për të ndihmuar në reformat e përbashkëta. Ka munguar harmonia dhe reciprociteti në marrëdhëniet midis strukturave të ndryshme të disa drejtorive apo në raportet institucionale midis stafeve të administratës publike (në nivel drejtorie, në nivel sektori, në nivel specialisti).
- 60% e të intervistuarve janë të mendimit se koordinimi i punës së MIE me institucionet e linjës ka qenë bashkëpunim i ndërsjellë e konstant, ku dëshira e përbashkët për të realizuar reformat ka qenë sfida që të gjitha drejtoritë janë përpjekur ta realizojnë.

Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit janë ndërtuar disa struktura ndërministrrore për realizimin e angazhimeve të ndërmara nga kjo Marrëveshje. Janë ngritur: Komiteti Ndërministror për Integrimin Evropian (KNIE) dhe Komiteti i Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE), të cilat kanë ndihmuar për drejtimin, për monitorimin dhe për koordinimin e realizimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, në nivel politik dhe administrativ. Secili prej tyre ka funksionet e veta specifike.

- ***Komiteti Ndërmistror për Integrimin Evropian (KNIE)***


KNIE është organ që drejtohet nga Kryeministri dhe në rast të mungesës së tij nga Ministri i Integrimit Evropian, si edhe nga një përfaqësues nga secila ministri. Përgjegjësia e saj qëndron pikërisht në drejtimin dhe miratimin e politikave kombëtare në kuadër të strategjisë së Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, roli i tij është të miratojë edhe Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;

- Të krijojë mekanizmat e duhur orientues për fazat e integrimit evropian dhe të drejtimit të negociatave për pranimin në Bashkimin Evropian;
- Në kuadër të këtyre kompetencave dhe jo vetëm të tyre, roli i KNIE nga vëshgimet që kemi realizuar në disa takime të ministrive, me individë të cilët janë kompetentë për veprimtarinë koordinuese të këtij institucioni kemi konstatuar se ky institucion nuk ka funksionuar rregullisht, mbledhjet nuk kanë qënë të rregullta, ashtu sikurse janë të përcaktuara në rregullore , jo më pak se 1 herë në tre muaj. Nga dokumentacioni që kemi mbledhur dhe intervistat që kemi zhvilluar me ekspertë të fushës është theksuar se nuk ka pasur mbledhje të shpeshta për arsye të axhendës së ngjeshur që ka procesi i integrimit.(VKM,2014)

Pyetjes: Sa produktiv ka qenë KKNIE dhe a ka qenë bashkëpunues me institucionet e tjera?

Grafiku 2: Efikasiteti i KNIE me institucionet e tjera.



Burimi: SPSS.v.20

Nga të dhënat e grafikut të mësipërm, dhe nga të dhënat e ekspertëve është konstatuar se ky institucion nuk ka respektuar gjithmonë rregulloren e mbledhjeve të takimeve me një axhendë specifike e bashkëpunuese me institucionet e tjera, sikurse janë ato të pavarura, akademike, e OJF-të.

-66% e të intervistuarve janë të mendimit se ky institucion ka treguar bashkëpunim me institucionet e tjera dhe ka marrë herë pas herë opinionin e tyre për ta çuar përpara zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;

-25 % e opinionit të specialistëve ka theksuar se jo të gjitha institucionet e shtetit kanë pasur bashkëpunim me Komitetin Ndërmintor për Integrimin Evropian (KNIE).

- **Rëndësia dhe ecuria e Komiteti i Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE).**

Në analizën që u kemi bërë institucioneve është marrë gjithashtu në vlerësim edhe roli e misioni që ka organi i KKNIE. Ai drejtohet nga Ministri i Integritit dhe, në rast mungese, nga zëvendësministri apo Sekretari i Përgjithshëm, si edhe nga përfaqësues të institucioneve, të cilët janë në varësi të Kryeministrit e të ministrave dhe kanë përgjegjësi në:

a. monitorimin e koordinimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe të rekomandimeve të dokumenteve strategjike të procesit të integritit evropian, të zbatimit të kërkesave dhe udhëzimeve të KKNIE;

b) raportimin në KNIE për veprimtaritë e procesit të integritit në Bashkimin Evropian;

c) drejtimin e procesit të përditësimit të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;

d) përfaqësimit e Shqipërisë në Komitetin e Stabilizim Asociimit BE – Shqipëri;

dh) vlerësimin, finalizimin e dokumenteve dhe të raporteve të përgatitura në kuadër të takimeve të Komitetit dhe Nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit;

e) vlerësimin e ndikimit në financat publike të buxhetit të shtetit nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit;

ë) vlerësimin e ndikimit të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire* ;


f) Vlerësimin e prioriteteve të programit komunitar IPA, ecurinë e projekteve të financuara nga programet e asistencës së Bashkimit Evropian dhe projektet e financuara nga donatorë të tjerë, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. (Projekturdhër:46,2009).

Në kuadër të funksionalitetit që ka ky institucion për të koordinuar sa më mirë bashkëpunimin ndërinstytucional dhe për të parë, nëse fokus-grupet janë aktorët dominantë në mirë-funksionim të procesit, janë përfshirë si:

a.në riformatimin e Planit Kombëtar të Integritetit;

b.në përfshirjen e projekteve IPA.

Grafiku 3: Përfshirja e fokus grupeve në KKNIE




Burimi: SPSS.v.20

Nga sa ilustruhet më sipër, kemi vënë re se përfshirja e këtyre fokus-grupeve në strukturat e mësipërme ka arritur suksesin e vet. Rreth 20% të stafëve akademike e universitare kanë dhënë opinionin e tyre për përmirësimin e reformave arsimore në kuadër të projekteve të ndryshme të financuara nga fondi IPA.

Rëndësi e veçantë u është dhënë institucioneve të pavarura për të krijuar mekanizmat e duhur që të ndryshonin problematikat e konstatuara. Vëmendje e veçantë në vitet e fundit, duke iu referuar edhe sugjerimeve të ndërkombëtarëve e duke parë edhe zhvillimet në rajon, i është dhënë përparësi përfshirjes së shoqërisë civile. Rreth 30% e saj nëpërmjet strukturave të tyre janë përfshirë për të qënë pjesë e vendimmarrjeve në proces. Në përmjet tyre janë gjendur mekanizmat e nevojshme për të sjellë sa më produktivitet në realizimin e reformave, si edhe për të arritur koordinim të suksesshëm ndër-institucional.

Një ndër pyetjet : “Për vlerësimin e prioriteteve të programit komunitar IPA dhe sa efikase kanë qënë projektet e shoqërisë civile në kuadër të procesit të integritetit e në shërbim të shoqërisë shqiptare? Kësaj pyetje i janë përgjigjur, si më poshtë:

Grafiku 4 :Shoqëria civile dhe prioritetet IPA



Burimi: SPSS.v.20

Nga grafiku i mësipërm, kemi konkluduar se për të arritur koordinimin e suksesshëm të këtij institucioni, si një nga prioritetet ka qënë vlerësimi i programit komunitar IPA. Për të matur efikasitetin e këtij programi kemi marrë në shqyrtim rëndësinë që ka roli i shoqërisë civile, për efikasitetin që ka ajo nëpërmjet projekteve. Sa kanë ndikuar këto projekte në përmirësimin e kapaciteteve të duhura për strukturat qeveritare.

Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur specialistë të ndryshëm të administratës publike dhe, sikurse është paraqitur edhe në grafikun e mësipërm, ka dalë qartë se roli i shoqërisë civile në vend ka qenë shumë i vogël, rreth 8.3% në realizimin e prioritetëve.

Projektet e realizuara nga programi IPA kundrejt përfitimit të qytetarëve kanë qenë në nivel mesatar, pra nuk ka qenë shoqëria apo institucionet që kanë përfituar nga këto projekte.

Niveli i projekteve të realizuara ka qenë në masën 66.7%, tregues i mjaftueshëm në shërbim të studiuesve për të evidentuar problematikat që janë konstatuar ndër vite.

KKNIE, për realizimin e funksioneve të tij, ka ngritur Nënkomitetet dhe Grupet Ndërinstitucionale të Punës në nivel teknik të përbërë nga nëpunës civilë, për kapitujt e Acquis communautaire dhe që kanë përfaqësuar Shqipërinë në Nënkomitetet e Stabilizim-Associmit.

• **GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS(GNP-të)**

Kanë pasur për qëllim të realizojnë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërinstitucional në nivel teknik. Ato kanë për synim zbatimin e angazhimeve në kuadrin e dokumenteve të politikave për integrimin evropian, konkretisht:

- mbikqyrin zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- kontribuojnë në përgatitjen e takimeve të Komitetit të MSA-së dhe Nënkomiteteve si edhe ndjekin dhe zbatojnë rekomandimet që jepen në këto takime;
- bashkë me Ministrinë e Integritimit Evropian, koordinojnë rishikimet vjetore të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020 në kapitujt përkatës, garantojnë zbatimin e Planit Kombëtar me planin vjetor të punës të Qeverisë, si edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020), si edhe strategji të tjera kombëtare/sectoriale;
- koordinojnë dhe mbikqyrin procesin e përafrimit të legjislacionit, duke përfshirë respektimin e afateve të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (2014- 2020);


- koordinojnë dhe garantojnë shpërndarje në kohë të *acquis* të BE-së ndërmjet ministrive të linjës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, si edhe shërbejnë si forum për zgjidhjen e debateve ndërministrore për shpërndarjen e *acquis*;
- monitorojnë periodikisht zhvillimet në lidhje me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë propozimet për legjislacion të ri, legjislacionin e miratuar rishtas, si edhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian;
- informojnë rregullisht stafin përkatës në ministritë e linjës, shërbimet e ekspertëve pranë kuvendit të Shqipërisë, si edhe autoritetet e tjera përgjegjëse për ndryshimet, identifikojnë prioritetet strategjike dhe nevojat në lidhje me procesin e integritimit evropian për të hartuar e formuluar propozime për asistencë nga BE-ja e donatorë të tjerë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe departamenti përgjegjës pranë Këshillit të Ministrave, si edhe hartojnë dhe i japin rekomandime Komitetit të Koordinimit Ndërinstitucional për Integritimin Evropian (KNIE).

Secili grup kryesohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për kapitullin përkatës dhe koordinohet nga drejtori i Njesisë së Integritimit Evropian të kësaj ministrie. Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian përbëhen nga përfaqësues të Kryeministrit, ministrive të linjës, të institucioneve të tyre të varësisë dhe të institucioneve publike sipas fushës së *acquis* të BE-së. Pavarësisht nga kapitulli i *acquis*, përfaqësuesit e Ministrisë së Integritimit Evropian dhe të Ministrisë së Financave marrin pjesë në mbledhjet e të gjitha GNP-ve.(VKM,2015)

Në kuadër të përgjegjësi që ka ky organ për të përshpejtuar procesin teknik të integritimit evropian, në analizën monitoruese janë marrë në shqyrtim se sa funksionale është koordinimi i punës ndërmjet stafeve ministrorë dhe sa shpesh bëhet raportimi nga ministritë e linjës. Në analizën tonë sasiore e cilësore janë marrë në shqyrtim edhe arsyet se përse këto grupe ndërministrorë të punës, në gjithë këtë kohë, nuk kanë funksionuar siç duhet. Ato kanë sjellë vonesa në procesin e shqyrtimit të kapitujve në mënyrë që të përshpejtohet procesi i hapjes së negociatave.

Nga përgjigjet që kemi marrë nga stafet e disa ministrave dhe të kryeministrit lidhur me arsyet e mos funksionimit të GNP-ve dhe të mos raportimit të shpeshtë të institucionet përgjegjëse, ka qenë e lidhur me shkakun e ndryshimit të shpeshtë të stafeve të punës (GNP-ve).

Grafiku 5: Performanca e GNP



Burimi: SPSS.v.20

Nga të dhënat e mësipërme, kuptohet se bashkëpunimi i anëtarëve të grupeve të punës për të monitoruar, për të raportuar apo për të çuar përpara procesin e kapitujve të MSA-së ka pasur problematika. Arsyhet se përse ky organ nuk ka arritur rezultatet e veta ka qëndruar pikërisht te mos përgjegjësia e strukturave të brendshme ministrore, me ndryshimet e shpeshta të anëtarëve, në mënyrë që procesi ndërinstytucional të shkonte përpara.


-Rreth 60% e stafeve në të gjitha ministrinë e linjës kanë nënvizuar se ka pasur vijimisht ka një ndryshime të anëtarëve të grupeve të punës (GNP-ve) e kjo është shoqëruar me mospasur në realizimin e reformave.

Nga përgjigjet, të cilat i kemi marrë në mënyra të ndryshme si : nga intervistat, nga mbledhja e dokumentacionit mbi veprimtarinë e grupeve të punës dhe nga opinionet e grupit kombëtar e ndërkombëtare mbi ecurinë e këtyre organeve kemi vërejtur se vetëm 30% e anëtarëve në të gjitha grupet e punës ndërministrrore nuk kanë ndryshuar. Pavarësisht, mos ndryshimit të tyre specialistët kanë theksuar se edhe në këto raste ka pasur ngërçe e problematika nga ana e anëtarëve për ta çuar përpara procesin.

Një nga mekanizmat nxitës, që kam mendimin se është me rëndësi për funksionalitetin e përgjegjësi që anëtarët duhet të kenë, është nxitja që zëvendësministrat përkatës duhet të ushtronin mbi grupet e punës, në mënyrë që të shmangeshin vështirësitë, të cilat sjellin humbjen e kohës dhe pengojnë suksesin e procesit.

Faktor tjetër i rëndësishëm në raportimin për monitorimin e institucioneve, ka qenë konsideruar ndërveprimi me Komiteti Ndërmintor për Integrimin Evropian (KNIE). Në vazhdim janë interpretuar dhe krahasuar rezultatet me pyetjet e tipit të hapur.

Grafiku 6: Ndërveprimi mes GNP-ve dhe KNIE



Burimi: SPSS.v.20

Nga rezultatet e grafikut janë evidentuar nëse marrëdhëniet ndërmjet dy organeve kompetente për ta çuar përpara procesin e integritetit kanë pasur bashkëpunim të suksesshëm. Nga përgjigjet, është theksuar se bashkëpunimi dhe raportimi i GNP-ve edhe pse ato kanë shfaqur problematik, përsëri niveli i suksesit ka qenë në masën 90%. Nga qëndrimi i një grupi të caktuar ekspertësh, prej 10%, të cilët kanë theksuar se jo gjithmonë raportimi ka sjellë rezultate bashkëpunimi midis dy institucioneve.


Kjo ka vërtetuar edhe hipotezën e studimit tonë se, nëse elitat kanë arritur të kontrollojnë procesin dhe realizojnë reforma institucionale të suksesshme, do të arrihet të ndërtohet shteti demokratik. Kërkesat bashkëkohore ndikojnë në rritjen e produktivitetit drejt institucioneve evropiane.

Një çështje e rëndësishme që është vëzhguar në studimin tonë ka qenë ajo që është e lidhur me dinamikën e ecurinë e procesit të punës së GNP-ve, sepse problematika e konstatuar nga formati metodologjik ka sjellë herë pas here vonesa në ecurinë e procesit. Në këtë mënyrë, të

intervistuarve tanë si pjesëtarë në këto grupe ndërinstitucionale të punës i kemi pyetur, nëse kjo ka sjellë vështirësi në procesin e mbylljes së kapitujve përkatës të MSA-së?

Pyetja: Sa shpesh ndryshon metodologjia e punës dhe sa shpesh keni bërë trajnime?

Grafiku 7: Rëndësia Metodologjike dhe ecuria trajnuese e GNP-ve



Burimi: SPSS.v.20

Pyetjes së mësipërme nga përgjigjet e punonjësve të niveleve të ndryshme që janë të përfshirë në këto grupe pune janë konstatuar problematika që ata kanë ngritur për cilësinë e funksionimit të grupeve të punës. Metodologjia e punës së tyre ka ndryshuar gati në 60% të rasteve, kur puna ka qenë drejt përfundimit. Kjo ka sjellë vonesa e pengesa për specialistët e fushës, të cilëve u është dashur të fillojnë e të shqyrtojnë modelin metodologjik të ri për ta rifilluar punën. Ashtu si pasqyrohet edhe në grafik, del qartë se specialistët e fushave nuk marrin trajnim nga MIE, e cila është përgjegjëse për shtyrjen e procesit.

- 40% e rasteve, të specialistëve që bëjnë pjesë në këto grupe pune janë të pa trajnuar.

MIE, ka trajnuar vetëm koordinatoret, të cilët janë kanë rrokur nivelin prej 30%, edhe pse efikasiteti i punës ka qenë i përqëndruar tek hartuesit (specialistët).

Të dhënat e specialistëve të intervistuar kanë nënvizuar se ky ka qenë factor që ka sjellë konfuzion për ecurinë e brendshme të procesit.

Fakti se puna e bërë nuk ka qenë përcjellë tek ndërkombëtarët ashtu sikurse është kryer sepse këto dokumente janë përkthyer nga vetë specialistët e fushës dhe jo nga përkthyesit, çka ka sjellë konfuzion e paqartësi në përdorimin e termave teknike.

KAPITULLI V

RAST STUDIMI: NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE SHQIPTARE, KRAHASUAR ME MODELIN KROAT, NJË MODEL SUKSESI DREJT STRUKTURAVE EVROPIANIZUESE

5.1 Vlerësimi i përgjithshëm i ndihmës ekonomike të institucioneve ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve institucionale.

BE-ja ka qenë e kufizuar në kontrollin dhe në kushtëzimet e ndihmave ekonomike, të cilat në përgjithësi janë aplikuar në bashkëpunim me donatorë të tjerë të huaj. Kur ka qenë e nevojshme, BE-ja ka ushtruar presion mbi autoritetet shqiptare rreth mirëadministrimit për ndihmat ekonomike.

Në kuadër të zgjerimit për Ballkanin Perëndimor që në vitin 2000, BE-ja ka qenë një nga donatorët më të rëndësishëm që kanë çuar përpara përpara ndërtimit të institucioneve, duke e parë atë si përparësi. Pas rënies së shtetit në vitin 1997 BE-ja dhe SIGMA, kanë hartuar programin që kishte të bënte me reformën në administratën publike, por kanë bashkëpunuar edhe me donatorë të tjerë aktivë të tilla si : Banka Botërore, PNUD, BERZH, USAID etj. Në ndërtimin e institucioneve dhe në hartimin e reformës në administratën publike kanë ndikuar edhe marrëveshjet bilaterale që qeveria e Republikës së Shqipërisë ka nënshkruar me disa qeveri evropiane.

Zgjerimi i BE-së, ka krijuar shpresa të mëdha drejt ndryshimit, të cilat mund të shoqërohen nga masa të ndryshme, të cilat duhej të mbështeshin nga të dy partitë politike me spektër politik të gjerë, si edhe nga publiku i gjerë.

Këtu mund të shtrohen pyetjet: A mund të nxitë BE-ja, interesin e aktorëve të ndryshëm për të kontrolluar shtetin? Si janë përdorur instrumentet e zgjerimit për mbështetjen e reformve administrative? Çfarë ka pritur BE-ja nga reformat e ndryshme që janë zhvilluar në administratës publike?

Administrata publike ka qenë vijimisht çështje e brendshme e shteteve anëtare të BE-së. Në të njëjtën kohë, administratat publike kombëtare duhet të zbatonin direktivat dhe rregulloret e BE-së, në mënyrë të tillë që qytetarët evropianë të gëzonin të drejtat e dhëna atyre nga Traktatet e BE-së, pavarësisht nga vendi të cilit i përkisnin; Ato do të justifikonin interesat e BE-së dhe punonjësit e administratës publike duhej të pasqyronin në veprimtarinë e tyre cilësi të larta profesionale, çka qenë paraparë edhe në tekstin e Traktatit Evropian Kushtetuese.

Përfitimet ishin të lidhura me kushtet e BE-së, e në mënyrë të vecantë me avancimin e anëtarësimit dhe të ndihmave ekonomike. Do të siguroheshin stimuj shtesë për aktorët vendas në përputhje me kërkesat e BE-së. Përveç kësaj BE-ja ka disponuar edhe një gamë të mjeteve për të monitoruar fazat e reformave të kryera, sipas objektivave e synimeve të caktuara.

BE-së në përgjithësi i kanë munguar modelet të përbashkëta institucionale për rreformimin e administratës publike në vendet anëtare të saj (Olsen 2003: 513 F). Nga fazat e hershme të zgjerimit me vendet e Evropës Qendrore e Lindore, BE-ja e kuptoi se kapacitetet administrative e vendeve të Ballkanit kanë shfaqur nota kritike për sigurimin e transparencës dhe zbatimin veçanërisht efektiv të reformave në rritje të *acquis communautaire* në vendet candidate (Verheijen 2002: 248).

Objektiv i rëndësishëm i BE-së që në fillimet e veprimtarisë së saj ka qenë

Përmirësimi sistematik i kapaciteteve profesionale të administrës publike. Ajo i ka orientuar të gjitha vendet që kanë dalë nga regjimet komuniste se zhvillimet demokratike dhe përmirësimi i jetës ekonomike në vend është i lidhur ngushtë me cilësinë e administratës publike. Kriteret e Kopenhagenit kanë përfshirë referenca implicite për kriteret e nevojshme administrative dhe për këtë dukuri BE-ja ka hartuar edhe kriteret që do të bënin të mundur realizimin e zgjerimit të tij me vende të tjera candidate.

SIGMA, e cila ka ndihmuar për përgatitjen e Administratës Publike në Hapësirën Publike Evropiane ka përpunuar disa kriteret referuese për vlerësimin e kapaciteteve të administratës publike në vendet candidate. Në përgjithësi, kërkesat e BE-së kanë këmbëngulur në rregullat e përgjithshme, të tilla si:

- a) miratimi i ligjeve të shërbimit civil për të garantuar pavarësinë;

- b) krijimin e sistemit të karrierës;
- c) Hartimin e reformave dhe organizimin e trajnimeve që do të ndikonin në cilësinë e administratës publike. (Fournier 1998: 113; Verheijen 2002: 250).

Kërkesat e BE-së, në përgjithësi kanë përforcuar rrugën e modernizimit të shtetit në hapësirën evropiane.

Goetz ka vënë theksin te “perspektiva evropiane e anëtarësimit dhe efektet e tij janë të lidhura me reformat e mëdha e kualitative që duhet të bëheshin me vendet ishkomuniste drejt modernizimit të saj. Objektivi ka qenë krijimi i administratës publike, në mënyrë që ata të veprojnë në të ardhmen e tyre si “lojtarë efektivë” në sistemin e BE-së”. (2001: 1037). Komponentët e reformës së administratës publike, siç është identifikuar nga SIGMA, janë përfshirë në vlerësimin vjetor të progresit të vendit kandidat.

Kriteret e administratës publike janë zbatuar në mënyrë selektive për identifikimin e fushave problematike të vendeve përkatëse, si rast pas rasti (Kochenov 2005: 18-20). Përveç kësaj, përbërësit e identifikuar nga SIGMA, janë orientuar prej udhëzimeve më shumë, sesa prej këshillave specifike. Ato duhet të paraprijnë me reformat e kërkuara, prandaj kriteret administrative mund të konsiderohen se përfaqësojnë një qasje të përgjithshme të ndërtimit të institucioneve. BE-ja nëpërmjet tyre është përpjekur të zgjidhë problematikat kryesore të çdo vendi, nëpërmjet procesit individual.

5.2 Instrumentet kushtëzuese dhe fazat e transformimi në Shqipëri.

Në rastin e Shqipërisë, BE-ja ka qenë shumë e vetëdijshme për realitetin e shtetit të dobët dhe në mënyrë të veçantë të administratës shtetërore. Në fillim të negociimit për një marrëveshje të re kontraktuale, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), është konsideruar si hap i rëndësishëm drejt integritit në BE dhe Komisioni ka theksuar që në fillim pengesën që vinte për procesin e integritit nga kapacitetet e dobëta administrative.

Grupi i Nivelit të Lartë Drejtues, i cili ka qenë përgjegjës për identifikimin e reformave të nevojshme që ka vendi për të kryer përgatitjet për MSA-në, ka vënë në dukje se, kriteri i cilësisë për administratën publike I përcaktuar nga BE-ja do të shoqërohej me monitorim të vazhdueshëm të progresit që do të shënonte administrata publike, për t'u përgjigjur zhvillimeve e dinamikës së procesit evropianizues. Për këtë herë pas here nga BE, pra për përmirësimin e cilësisë nga administrata publike nga BE-ja janë kërkuar masa shtesë, për të mbajtur reformat në rrugën e duhur. Qeveria, nën vëzhgimin e BE-së, ka premtuar se do të zbatonte parimet kryesore të reformës prej e në bashkëpunim me strukturat ndërkombëtare (me BE-në).

Këto angazhime, të marra nga Qeveria e majtë nuk u vijuan më tej nga Qeveria e djathtë pas vitit 2005. Qeveria e djathtë braktisi propozimin e përgatitur nga qeveria e mëparshme për përmirësimin e disa dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil. Ajo shkoi në një fazë të dytë të zgjerimit të shërbimit civil, për përfshirjen e punonjësve më shumë në sektorin publik.

Në këtë periudhë, pra në vitet 2006-2007 Qeveria ka nxjerrë një akt nënligjor për të transferuar institucionin kryesor përgjegjës për menaxhimin e reformës në Administratën Publike, pra Departamentin e Administratës Publike - nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Koha tregoi se ky veprim ishte i nxituar, jofunksional dhe binte ndesh me mirëfunksionimin e Administratës Publike në institucionet e ndryshme të shtetit. (Elbasani, 2009:17)

Reforma në administratën publike ka qenë e mbetet përparësi e qeverive, në mënyrë që procesi i integritit të kalonte pa vështirësi fazat e veta të zhvillimit dhe të përfitonte nga statusi i vendit kandidat dhe për të vijuar më tej hapjen e negociatave e më pas drejt anëtarësimit të plotë në BE. Në kuadër të këtij procesi, reforma në administratën publike ka bërë të mundur

përmirësimin e saj nga pikëpamja e bazës institucionale, duke miratuar në vitin 2013 Ligjin e ri të Shërbimit Civil e që ka hyrë në fuqi në shkurt 2014.

Në rrafshin e kriterit të cilësisë në administratën publike BE-ja ka kërkuar të përmirësojë tregun e brendshëm të hapësirës evropiane, në mënyrë që anëtarët e rinj, nga momenti i aderimit të kishin kapacitet e nevojshme profesionale në administratën publike. Vendi kandidat duhet të plotësonte procedurat e kërkesat sistematike të BE-së nëpërmjet rritjes e përmirësimit të punës në administratën publike.

Kërkesat institucionale të BE-së kanë pasur të bënë pikërisht me kapacitetet profesionale për të përshtatur *acquis communautaire*, ku efektshmëria, produktiviteti e funksionaliteti i administratës publike do të bënte të mundur të realizoheshin me suksese e hap pas hapi orientimet, objektivat, e përcaktuara nga BE nga vendi kandidat. Ajo që është shtruar si sfidë për anëtarët e rinj, ka qenë pikërisht reformimi apo përmirësimi i disa institucioneve ekzistuese, si edhe krijimi i disa institucioneve të reja në disa raste të domosdoshme.

Kriteret institucionale të përcaktuara nga BE për tu bërë pjesë e saj, kanë kërkuar edhe disa shtesa, të cilat lidheshin me parimet e Kopenhagenit, për krijimin e institucioneve të qëndrueshme që do të siguronin demokracinë. Këto kriterë që janë të lidhura me dimensione të ndryshme të reformave që do të kryesish në administratën publike do të bënin të mundur të arriheshin parimet e përgjegjshmërisë, të transparencës dhe të efikasitetit. Në këtë mënyrë, do të bëhej e mundur që të realizohej edhe në vendin tonë një administratë publike me kahje evropiane dhe e suksesshme.

Për reformimin e administratës publike në vendet candidate BE-ja nuk ka pasur ndonjë model specifik që të zbatohet nga administrata publike e vendit kandidat, por ajo është nisur nga treguesit cilësor në vendet anëtare të saj dhe mbi këtë bazë ka dhënë orientime e ka përcaktuar kriterë e standarte për përmirësimin e kapaciteteve profesionale në vendet candidate, si domosdoshmëri për zhvillimin me sukses të procesit të integritit evropian të tyre.

Transformimi i politikave të brendshme të shtetit shqiptarë, drejt procesit të integritit evropian ka kaluar nëpërmjet disa fazave që nga momenti, kur vendi ynë ka pranuar të bëhej palë bashkëpunuese me institucionet ndërkombëtare.

Ndryshimet sistematike dhe të domosdoshme për transformimin e shtetit ishin të lidhura me reformimin e institucioneve të shtetit tonë. Teoria e transformimit (Andorka, 1993; Elster, 1998; Goetz, 1995; Merkel, 1994; Nunberg, 1999b) na ka treguar plotësimi i standardeve të reja nga administrata publike për vendet aspirante (Batt dhe Ęolczuk, 1998) është e lidhur me shtetndërtimin (Nunberg dhe Barbone, 1999: 7) dhe me ndryshimet e nevojshme e sistematike (Merkel, 1999).

Ndryshimet sistematike në administratën publike ishin mëse të domosdoshme, sepse ajo duhej të zhvishej nga parimet ideologjike të sistemit komunist dhe tashmë duhej t'u përgjigjej kërkesave të reja që buronin nga sistemi demokratik e në mënyrë të vecantë nga kriteret e standardet e procesit të integritit evropian të vendit. (König, 1993; Hesse, 1997).

Axhenda e ristrukturimit të administratës publike ka përfshirë dy drejtime:

- a) Drejtimin pragmatikë e teknike;
- b) Drejtimin menaxheriale e profesional

Këto drejtime do të luanin rol të rëndësishëm për formimin e administratës publike që t'u përshtatej zhvillimeve të reja demokratike në vendin tonë.

BE-ja nuk ka qenë e bindur dhe ka pasur edhe vërejtjet e veta për kapacitetet profesionale të vendeve kandidate, për implementimin dhe zbatimin e *acquis communautaire*. Transformimi i administratës publike ka qenë dhe mbetet i vështirë, por i domosdoshëm, sepse ka qenë dhe është i lidhur me proceset e integritit evropian të vendit tonë në BE, ka qenë i lidhur me demokratizimin e jetës politike, ekonomike, sociale, ligjore e arsimore të vendit.

Në aspektin e procesit të transformimit të vendit tonë drejt fazave të "evropianizimit të tij" mund ta identifikojmë këtë proces, si proces që ka qenë i lidhur me zgjerimin e me thellimin e marrëdhënieve me BE-në. Në tabelën e mëposhtme po pasqyrojmë disa faza të cilat kanë qenë të lidhura me procesin transformues të vendit tonë.

Analiza ka filluar duke e parë procesin evropian të vendit tonë, nëpërmjet një transformimi kompleks, si edhe të fazave nëpër të cilat ky proces ka evoluuar.

Fazat e Shqipërisë për një transformim kompleks

Fazat (1992-2016)	Fundi i komunizmit (1992-1997)	Demokrati e vonuar (1997-2003)	Para-antarësimi (2003-2016)
Fillimi procesit	Shtetndërtimi	Institucione në ndërtim	Anëtarëbashkëpunues
Probleme & sfida	Vlerësim të administratës	-Qeverisje e paaftë -Elita në tranzicion	Adoptimi i normave dhe ligjeve
Mekanizmat	Kontrollim të elitave	Reforma institucionale	Kushtëzimet

Burimi: Autori

1.Faza e fillimit të procesit

Momenti historik, kur vendit tonë ju dha mundësia për t'u ndihmuar nga ana ekonomike nga vendet e BE-së dhe që më pas u shoqërua me transformime të brendshme politike. Ishte e rëndësishme të evidentoheshin problematikat, si edhe të përcaktoheshin sfidat më emergjente, sepse ishin të nevojshme që vendi ynë të fillonte nisjen e procesit të integritimit evropian, proces i vështirë, kompleks dhe që kërkonte transformime të thella në të gjitha fushat e jetës.

2.Faza e dytë shoqërohet me procesin shtetndërtues

Procesi i shtetndërtimit në vendin tonë është shoqëruar me marrëdhëniet e tij me vende të ndryshme të BE-së. Në këtë periudhë historike është bërë e mundur të krijohet zona e tregtisë së lirë, është vendosur dialogu i institucionalizuar politik, si edhe është ofruar rruga që duhet ndjekur drejt anëtarësimi në strukturat e Bashkimit Evropian. Në kuadër të marrëveshjeve të veçanta midis BE-së dhe Shqipërisë janë krijuar mekanizmat e nevojshme për zbatimin dhe për monitorimin e institucioneve, si edhe për të kaluar më pas drejt fazës së partneriteti

institucional. (Lippert 1998; Rupp 1999). Sfidë e rëndësishme në këtë fazë ishte edhe mënyra e përfshirjes së elitave profesionale në institucione për krijimin e institucioneve me punonjës të kualifikuar.

Negociatat për Administratën Publike kishin për synim të realizonin pjesët e *acquis communitaire* që lidheshin pikërisht me këtë strukturë të rëndësishme të shtetit shqiptarë. Ajo do të luante rol të rëndësishëm në procesin dinamik të integritetit të vendit në strukturat e BE-së do të ndihmonte për transformimin e madh demokratik që do të kryhej hap pas hapi në institucionet e ndryshme të vendit, në pushtetin qendror dhe atë vendor. Gjithashtu, në kuadër të procesit të integritetit evropian shteti shqiptar ka krijuar institucione të përbashkëta bilaterale me BE-në.

3.Faza e tretë: Demokraci e vonuar në vend

Transformimi i sistemit politik, ekonomik, social, ligjor etj. nuk ka qenë i lehtë për të realizuar standartet e përcaktuara nga BE-ja. Sfidë e kësaj faze ka qenë e lidhur me paaftësinë e qeverisë për të zbatuar reforma të thella demokratike. Kjo periudhë historike për vendin tonë ka qenë e shoqëruar nga mungesa e elitave intelektuale e politike, të cilat nuk kanë treguar profesionalizëm, por ishin thjeshtë individë që ishin të mbështetur nga politika.

4. Faza e katërt: Paraanëtarësimi - bazuar në përshtatjen e institucioneve

Krijimi i sistemit të ri politik ishte i lidhur me transformimin e institucioneve të shtetit, nga institucione me pikëpamje ideologjike komuniste drejt krijimit të institucioneve të reja me prirje e pikëpamje që buronin nga sistemi i ri demokratik.(Hirschmann, 1997: 30; Merkel, 1999:135.). politikbërësit e rinjë janë përballur me idetë politike midis të vjetrës dhe së reë dhe kjo ka sjellë që përfaqësuesit e klasës së re politike të vendit duhej të ndryshonin strategjinë e zhvillimit të vendit, nga traditat historike drejt modeleve të “importuara” të BE-së. (Brunner 1995; Merkel 1999: 469-84.5) Ashtu si në rastin e përgatitjes së kapaciteteve profesionale në institucionet publike, procesi i integritetit evropian të vendit është vlerësuar si një proces i lidhur me dy nivele:

- a. në nivel evropian që i referohet një evolucioni të veçantë për secilin vend, është i veçantë sistemi qeverisës;

- b. përgatitjen e strukturave të reja, të cilat duhet të bashkëvepronin me strukturat e BE-së, të cilat formonin nivelin e dytë.

Një qasje tjetër që ka shoqëruar procesin e administratës publike ka qenë tipologjia e impaktit të procesit, I cili ishte bazuar kryesisht tek:

1. **Varësia në burimet** - që ka treguar sistemin evropian të qeverisjes, si një sistem I mundësive politike, i cili ka krijuar mundësinë për shpërndarjen e burimeve ekonomike ;

2. **Përshtatja institucionale**-ku aktorët kombëtarë kanë miratuar dhe kanë përvetësuar rregulla e praktika të reja. Drejtimi i dytë ka përdor teoritë e organizatave për ndryshimin e institucioneve, të cilat po i ilustrojmë më poshtë, nëpërmjet tabelës:

	<i>Institucionalizimit racional</i>	<i>Institucionalizimit sociologjik</i>
Niveli i analizës	I. Institucionet evropiane ushtrojnë presione mbi institucionet dhe aktorët kombëtarë	II. Institucionet evropiane të ndikojnë në ndërtimin e identiteteve dhe interesave të aktorët kombëtare dhe trans-nacionale
	III. Institucionet evropiane ushtrojnë presione në institucionet kombëtare dhe aktorët përballen me kufizimet institucionale apo mundësitë, aktorët reagojnë përmes ndërveprimit strategjik	IV. Përshtatja normative dhe njohës i aktorit në përgjigje të ndryshimeve institucionale

Burimi: Tipologjia e kërimit të impaktit të integritit evropian Jacquot / Woll (2003)

Modeli i varësisë institucionale i ka trajtuar drejtuesit e institucioneve nga pikëpamja e shërbimeve, si edhe nga realizimi i orientimeve të ndryshme. Këtu nuk kanë qenë e përjashtuar mundësia e preferencave sepse punonjësit e administratës publike janë përpjekur të mbijetojnë dhe në këtë mënyrë është penguar zhvillimi , si edhe është vonuar krijimi i institucioneve të reja demokratike, sipas praktikave, kriterëve, standardeve të BE-së.

5.3 Kushtëzimet evropiane për administratën publike shqiptare.

Veprimtaria e Komisionit Evropian për reformimin e administratës publike, ka qenë e lidhur ngushtë me rritjen e cilësisë profesionale në shërbimin civil. Ajo ka qenë bazuar në zbatimin e parimeve e standardeve evropiane nga administrata publike e vendit kandidatë. Koncepti I Hapësirës Administrative Evropiane (HAE) është zhvilluar në fund të viteve 1990 nga SIGMA në emër të Komisionit Evropian (SIGMA nr 23 dhe 27). Ajo ka vlerësuar se administrata publike, në të gjitha nivelet e sistemit të Bashkimit Evropian të qeverisjes ka mishëruar parime themelore të tilla, si :

- sundimi I ligjit dhe i sigurisë;
- arsyet ligjore dhe parashikueshmërinë;
- hapjen dhe transparencën;
- llogaridhënien ligjore;
- Efektivitetin.

Çdo parim, përfshin profile të ndryshme si :

- a) Administrimin;
- b) neutralitetin politik,
- c) paanshmërinë,
- d) integritetin profesional,
- e) trajtim të drejtë, të barabartë të stafit të administratës publike.

Në kuadër të prioriteteve të procesit të integritetit evropiane të vendit, ajo që është konsideruar si prioriteti më i rëndësishëm ka qenë e mbetet përmirësimi I nivelit të profesionalizmit të punonjësve të administratës publike.

Ndikimi i faktorit politik në karrierën profesionale në sistemin e administratës publike ka penguar vlerësimin real të nënpunësve civil, shkallën e cilësisë së tyre profesionale dhe kjo ka ndikuar në cënimin e kriterit të performancës etë meritokracisë. (Matei, L, 2006)

Shumica e shteteve evropiane kanë zgjedhur modelin e karrierës, të lidhur me traditën, një sistem të caktuar politik, mënyrën që ka qenë i lidhur me mënyrën e të menduarit dhe kulturën e shërbimit civil të tyre kombëtar.

Në kuadër të prioritetëve evropiane, ajo që ka qenë konsideruar si modeli më i mirë i zgjedhur, për përmirësimin e punës së institucioneve tona që ato t'u afroreshin gjithënjë e më mirë strukturave të BE-së ka qenë e mbetet rritja e nivelit të profesionalizmit. Ndikimi i faktorit politik në karrierën profesionale në sistemin e administratës publike të ishte gjithënjë e më shumë sa më i vogël, e të shkonte drejt shuarjes dhe e vetmja premisë në funksion të sistemit të përherëshëm të vlerësimit të nënpunësve civil të ishte e të vijoje të jetë mbi bazën e kriterit të performacës e të meritokracisë. (Matei, L, 2006)

Shumica e shteteve evropiane kanë zgjedhur modelin e karrierës, i cili ka qenë i lidhur me traditën me mënyrën e të menduarit dhe me kulturën e shërbimit civil kombëtar. Në kuadër të reformës së shërbimit civil ka qenë e nevojshme që në shtetet kandidate, në kuadër të prioritetëve evropiane, si edhe të procesit të integritetit evropian veprimtaria kryesore duhej të bazohej te krijimi i sistemit të rekrutimit i bazuar mbi meritën profesionale. Në administratën publike duhej të kryeheshin konkurrenca të hapura, duke vlerësuar e respektuar formimin bashkëkohor të aplikantit dhe rekrutimet duhej të ishin të pavarura nga ndërhyrjet apo presionet politike. Ka munguar zbatimi i rregullave, i procedurave përkatëse, të cilat edhe pse ishin të parashikuara në aktet normative, ligjore, e nënligjore.

Në shumicën e rasteve punësimet në institucionet e administratës publike janë kryer me ndërhyrjen e partive politike që kanë qenë ose janë në pushtet. Shërbimi civil duhej të kryente më mirë problematikën që lidhej me punësimin, me menaxhimin e pagave, si edhe me veprimtaritë e ndryshme trajnuese dhe kualifikuese të punonjësve. Ajo që nënvizojmë, është prirja se kriteret e standardet e zbatuara në shërbimin civil janë larg me parimet evropiane. Sistemi i pagave nuk ka qenë në funksion të përmirësimit të punës në institucionet e administratës publike. Në fund të çdo viti punonjësit e shërbimit civil nuk janë vlerësuar mbi bazën e treguesve profesional, por mbi bazën e vlerësimeve subjektive nga drejtues të niveleve të ndryshme.

Kriteret e standardet e BE-së , nuk kanë parashikuar që të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian të kenë një kornizë të vetme institucionale. Shumëllojshmëria e kornizave institucionale midis shteteve anëtare të BE-së ka treguar se zgjidhjet e ndryshme institucionale janë realizuar edhe nga struktura të ndryshme. Pra, strukturimi i administratës publike veprimtaria e saj nuk mbështetet te forma e kornizes, por te përmbushja e detyrave që janë pjesë e integritetit evropian. Fusha e veprimtarive të parimeve evropiane për administratën publike janë përfshirë në menaxhimin e shërbimit civil.

Krijimi i sistemit të rekrutimit të shërbimit civil i cili duhej të përfshinte konkurrimin e hapur, rekrutimi të kryhej sipas meritës, mekanizma të standardizuara, shqyrtim dhe përzgjedhje e depolitizuar, në mënyrë që të promovoheshin parimet e transparencës. (Matei, L, 2006)

Shkalla e niveleve të institucionalizmit ka ndikuar, ka luajtur e luan rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e profesionalizmit të shërbimit civil. Në qoftë se rregullat, zbatimi dhe përvetësimi i tyre janë në harmoni, atëherë institucionet janë të qëndrueshme dhe, më pak të kontestuara. Profesionalizmi në shërbimin civil ka qenë e mbetet i lidhur me bashkëveprimin e faktorëve ndërkombëtarë e kombëtarë.

Bashkëpunimi duhej të ndihmonte për shqyrtimin e strukturave si edhe duhej të pengonte politikëbërësit në ndërhyrjet e tyre për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil. Bashkëveprimi i faktorit kombëtar me atë ndërkombëtar duhej të ishte veçanërisht i rëndësishëm në krijimin e kushteve të favorshme për krijimin e administratës publike me kahje evropiane.

5.3.1 Rezultatet e vlerësimit sasior e cilësor nga ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbi procesin e reformave gjithëpërfshirëse në administratën publike shqiptare

Kriteret e standardet institucionale për integrimin në BE, padiskutim që kanë kërkuar mënyrën më të mirë të realizimit të reformave. Vendi kandidat do të gjykohej mbibazën e kriterëve të përmbushura ose jo.

Modeli evropian që kishte propozuar BE-ja për përmirësimin e institucioneve do të fokusohet, kryesisht mbi kapacitetin administrativ me qasje horizontale, e cila duhej të shtrihej në të gjithë administratën publike. BE-ja nuk ka pasur model standard për shtetkandidate, por është fokusuar në disa parime bazë siç janë, konkretisht:

- Përgjegjësia;
- Transparenca;
- Efikasiteti.

Veprimtaritë e BE-së për përmirësimin e administratave publike joefektive janë ende në proces. Presionet e BE-së ka dhënë impakt në miratimin e ligjeve të reja të akteve të ndryshme nënligjore, por ndërhyrjet politike kanë penguar procesin normal, pra krijimin e administratës publike sipas normave e kriterëve evropiane. Reformat kanë qenë të vështira, gati në të gjitha vendet ishkomuniste. Analiza jonë ka hequr paralele midis dy shteteve, njëri që është tashmë vend anëtar, Kroacia dhe tjetri që ende aspiron të bëhet pjesë e strukturave evropiane, pra vendi ynë, Shqipëria.


Reformimi i sistemit të shërbimit civil ka qenë vëzhguar, monitoruar dhe është pasqyruar në raporte të ndryshme të BE-së dhe Komisionit Evropian.

Punimi im ka pasqyruar përpjekjet e mia për monitorimin e këtij procesi. Nëpërmjet analizës cilësore e sasore që kemi zhvilluar me grupet e interesit, si edhe me ata që janë prekur drejtëpërdrejtë nga reformimi i administratës publike në vendin tonë kemi arritur në mendimin se reformimi i saj ka qenë i pjesshëm, me hope, jo transparent, me trysni të fortë të partive politike ndaj punonjësve të administratës publike. Nuk ka pasur raporte profesionale edhe midis

strukturave të brendshme të drejtorive në veçanti e të administratës publike në përgjithësi pra në nivel dikasteri etj.

Nga analiza që u kemi bërë kriterëve të zgjerimit të BE-së, kemi arritur në mendimin se jo gjithmonë ato janë realizuar ashtu sikurse ato janë orientuar e parashikuar. Lidhur me orientimin për depolitizimin e decentralizimin e administratës publike kemi konstatuar se lidhur me këtë kriter evropian, të intervistuarit e të anketuarit në institucionet e Republikës së Shqipërisë kanë dhënë këto opinione:

Grafiku 1 : Depolitizimi dhe decentralizimi sipas opinionit të specialistëve të administratës publike(AP).




Burimi: SPSS.v.20

Në grafik pasqyrohet se faktori ndërkombëtar, edhe pse ka vendosur kriterë të rëndësishme për realizimin e reformës, vërehet se 91.7% e të intervistuarve janë shprehur se nuk është bërë asnjë gjë.

Pyetja 1 e pyetësorit, e cila u është drejtuar specialistëve të Administratës Publike dhe që u është kërkuar të japin opinionet e tyre nga momenti i marrjes së statusit kandidat të Shqipërisë në kuadër të **prioriteteve për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në, pra a ka bërë progres Qeveria Shqiptare për reformën e Administratës Publike?** Lidhur me këtë pyetje specialistët janë përgjigjur me tone sa pozitive, aq edhe negative dhe kjo pasqyrohet grafikisht.

Grafiku2 : Progresi i qeverisë shqiptare 2013-2015



Burimi: SPSS.v.20

Në grafik është pasqyruar se:

- a) 66.7% e të intervistuarve mendojnë se kjo reforme ka pasur sukses;
- b) 25% janë të mendimit se nuk janë realizuar reformat.

Pra, arrihet në përfundimin se BE-ja në kuadër të përgjegjësive të saj ka arritur të influencojë drejt progresit të reformave në administratën publike.

Zbatimi i këtyre politikave për krijimin e institucioneve demokratike publike ka treguar edhe anët e forta e të dobëta. Qasja për realizimin e reformave kahje horizontale në sektorë të ndryshëm publikë do të krijonte mundësinë që të forcoheshin shtyllat e shtetit e të shkohej hap pas hapi drejt demokracisë së konsoliduar.

Reformimi i institucioneve është analizuar në dy drejtime:

- 1) vertikale;
- 2) horizontale.

Reformimi në drejtimin vertikal ka pasqyruar se detyrat politike dhe autoriteti administrativ është realizuar nëpërmjet të njëjtit pozicion hierarkik, pra specialist shëf, e drejtor. Reformimi me drejtim horizontal është përqëndruar tek institucionet ekzistuese, të cilat janë ndarë në njësi më të vogla apo të reja, të cilat të fokusuar te organizatat ekzistuese ndahen në njësi më të vogla apo organizata të reja, të cilat janë themeluar në të njëjtin nivel hierarkik.

Duke iu referuar modelit kroat për përmirësimin e institucioneve, siç ka qenë krijimi i institucioneve të reja koordinuese të procesit të integrimit evropian, si Këshilli Kombëtar për integrimin evropian etj. Kemi konstatuar se monitorimi mbi ecurinë dhe zhvillimin e procesit

evropian drejt qasjes së koordinimit horizontal ka nënkuptuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet qeverisë, institucioneve dhe shoqërisë civile.

Për këtë gjë kemi realizuar analiza të cilat kanë qenë të përqëndruara tek intervistat me fokus-grupet. Ato kanë dhënë opinionin e tyre mbi procesin e reformave institucionale, të cilat kanë qenë e janë sfidat në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Nga intervistat që kemi realizuar kemi konstatuar ndarje opinionesh, duke iu referuar opinionit kombëtar (identifikuar me stafet që mbartin statusin e nënpunësit civil) dhe opinionit ndërkombëtar (identifikohet me përfaqësuesit ndërkombëtar të organizatave ndërkombëtare në shqipëri) kemi nxjerrë disa konkluzione pas kemi intervistuar punonjësit e Ministrisë së Integritimit dhe Ministrisë së Jashtme.

Intervistat tona janë përqëndruar tek roli dhe rëndësia që ka institucioni më i ri, i krijuar brenda Kuvendit të Shqipërisë si institucioni që do të monitorojë procesin e integritimit evropian dhe do të krijojë kapacitetet e nevojshme për ta përfshirë edhe Kuvendin e Shqipërisë brenda strukturave të Parlamentit Evropian.

Institucioni I ngritur I cili ka funksionuar edhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor, sic është rasti kroat ka qenë I suksesshëm. Ai ka ndihmuar në funksionimin e procesit integruar , por në disa shtete të tjera si Serbi e Mali i Zi roli i tij, ka qenë i dështuar. Për këtë opinionin që ndajnë punonjësit e administratës publike për këtë institucion. Pyetjes: ***Çfarë mendoni për rolin që luan Këshilli Kombëtar të Integritimit Evropian ?***

Grafiku 3: Rëndësia e KKIE nga specialistët e MIE/MJ



Burimi: SPSS.v.20

Në diagramë vërejmë se:

- 60% e të intervistuarve kanë mendimin se roli i këtij institucioni të krjuar për monitorimin e procesit po funksionon pozitivisht;
- 40% mendojnë se roli i tij ka qenë aspak produktiv.

Duke parë funksionimin e këtij institucioni edhe në vendet e rajonit, një qasje orientuese e BE-së për të ndihmuar koordinimin horizontal midis institucioneve kemi arritur në mendimin se impakti i organizmave ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteve profesionale për qeverisje të mirë, ka bërë progres.

Në procesin e integritimit evropian të vendit reformat që lidhen me administratën publike si edhe me fushat ku vepron ajo kanë ndikim të veçantë tek *acquis cummunautaire*, pra vendet candidate duhet të zbatojnë legjislacionin përkatës. Qëllimet dhe reformave në sistemin e administratës publike janë të lidhura me zbatimin e politikave që do ti afronin vendet candidate me praktikat me standardet e vendeve të BE-së. Pra, në fushat ku ndikimi i administratës është i madh si konkurrenca, mjedisi, telekomunikacionet, politika, shkenca dhe hulumtimet, etj, vendi kandidat për tu bërë pjese e BE-së duhet të ndjekë zbatimin e reformave në këto fusha me qëllim që të harmonizohet deri në atë nivel që janë vendeet anëtare të Bashkimit Evropian. (225).

Në këtë mënyrë punimi im, duke u ndalur tek prioritetet ndërkombëtare ka pasqyruar një tablo të përgjithshme të situatës në vite të administratës publike, përmirësimin e reformimin e saj për të përballuar sfidat e procesit të integritimit evropian.

Jemi përpjekur të analizojmë e të pasqyrojmë trajektoren e fazave të reformave në disa institucione publike të vendit tonë, duke u përqëndruar në dy drejtimet:

- a) analiza sasiore;
- b) analiza cilësore.

Duke pasur në vëmendje edhe konceptet e pikëpamjet e shfaqura nga specialistët e administratës publike ashtu edhe nga ekspertët ndërkombëtarë.

Për këtë, për të marrë rezultatet e nevojshme, jemi fokusuar në mënyrë të veçantë mbi ecurinë e mbi ndikimin e procesit të evropianizimit për ngritjen e kapaciteteve të duhura profesionale e shtetndërtuese. Gjithashtu, kemi realizuar edhe intervista e pyetësorë për të marrë edhe mendimin që kanë pasur punonjësit e niveleve të ndryshme. Përpunimi të dhënave është realizuar nëpërmjet metodës sasiore e cilësore të integruara Brenda njëra-tjetrës.


Pyetjes: A mendoni se impakti ndërkombëtar ka qenë i domosdoshëm për implementimin e reformave?

Kësaj pyetje, punonjësit e administratës publike, i janë përgjigjur të gjithë në mënyrë positive. Ata e kanë parë impaktin ndërkombëtar si faktorin më dominant dhe më të rëndësishëm për përmirësimin e situatës në institucionet e shtetit shqiptarë. Në këtë mënyrë kemi arritur në konkluzionin se ka qenë e rëndësishme që Shqipëria, vendi i izoluar dhe me institucione të prapambetura, krahasuar me vëndet e tjera të rajonit, momentalisht ka zhvilluar proces pozitiv, edhe si rezultat i ndikimit ndërkombëtar për të çuar përpara reformat.

Opinionit i ekspertëve të Organizmave Ndërkombëtare: e shikojnë këtë proces si detyrë të brendshme të shtetit dhe kanë kërkuar që Qeveria Shqiptare apo qytetarët shqiptarë të mos e shikonin procesin për të realizuar qëllimet evropiane, por për të realizuar ndërtimin e shtetit të tyre, për të pasurpërfitime gjithënjë e më të mira.

Pyetjes: A mendoni se ndikimi i modelit kroat do të jetë një model i suksesshëm për administratën shqiptare?

Grafiku 4 : Rëndësia e modelit institucional kroat



Burimi: SPSS.v.20

Grafiku i mësipërm tregon se:

- 66.7% kanë mendimin se institucionet e shtetit shqiptar mund ta marrin modelin kroat, si një model suksesi në rajon. Reformat e ndërmarra nga Kroacia në disa sektorë kanë qenë shumë produktivë dhe evoluimi i procesit të integritimit evropian të vendit ka qenë më i shpejtë;
- 25% e tyre kanë mendimin se ky model është ballkanik dhe ka problematikat e veta; Këta mendojnë se modeli gjerman, është modeli më i mirë evropian dhe më i suksesshëm.

Duke analizuar opinionet e parashtruara më sipër jemi të mendimit se procesi dhe sukseset e integritetit evropian të vendit nuk varet nga shteti që mund të meret si shembull, si model, por nga mënyra e zbatimit të reformave, si edhe nga dëshira e mirë që kanë të gjitha palët e interesuara në këtë proces.


Është e rëndësishme të theksohet krijimi i institucioneve të shtetit tonë demokratik mbi baza të forta juridike dhe që nuk do të krijojë problem në procesin e aderimit.

Pyetja: A është realizuar rekrutimi i punonjësve të niveleve të ndryshme në institucionet e administratës publike nëpërmjet kriterit të meritokracisë?

Kësaj pyetjeje punonjësit e administratës publike të vendit tonë dhe ekspertët ndërkombëtare janë përgjigjur, si më poshtë:

- **Opinionet e punonjësve të administratës publike :**

Grafiku 5 : Rëndësia e rekrutimit me meritokraci/pa meritokraci



Burimi: SPSS.v.20

Duke u ndalur te kjo diagram theksojmë se procesi i rekrutimit të punonjësve në administratën publike ka qenë procesi më i kritikuar. Ky proces, ndërvite nuk ka qenë bazuar mbi meritokracinë, prandaj intervistuesit kanë theksuar se :

- 58.3% nuk janë zbatuar kriteret e meritokraci;
- 41.7% kanë menduar janë zbatuar kriteret;

Pra, kemi arritur në mendimin se procesi i rekrutimit në institucionet e administratës publike në pushtetin qendror nuk kanë qenë plotësisht në zbatim të kushtëzimit evropian për reformimin e

administratës publike, për të punësuar në këtë administratë njerëz me formim të kënaqshëm profesional e larg ndikimeve të presionit të partive politike.


Intervistuesit, janë të mendimit se Ligji për Shërbimin Civil ka ndikuar dhe ka dhënë shtysë pozitive në procesin e rekrutimit.

Disa janë të mendimit se rekrutimi i punonjësve të rinj është kryer me aplikimin online gjë që e ka rritur më shumë transparencën e procesit. Ajo që kemi nënvizuar është se edhe zbatimi i Ligjit për Shërbimin Civil është cënuar si rezultat i njohjes e lidhjeve familjare, politike të cilat kanë shmangur e anashkaluar profesionalizmin që duhet të kenë punonjësit e administratës publike.

Testimi ka qenë i bazuar në kriteret e përshkrimit të vendit të punës, por rekrutimi nuk ka qenë cilësor për arsye të mungesës së aplikantëve nga jashtë sistemit. Në këtë mënyrë i gjithë procesi i pranimit të punonjësve të rinj, por edhe i karrierës është vënë në dyshim. Drejtuesit e administratës publike kanë theksuar se janë respektuar kriteret, por nga të intervistuarit e nga monitorimi që kemi realizuar në disa institucione kemi arritur në mendimin se përzgjedhja e punonjësve të rinj nuk është kryer në zbatim të kriterëve e të standardeve të parashikuara, të cilat kanë qenë orientuese edhe nga strukturat e BE-së.

Opinio i ekspertëve ndërkombëtarë.

Grafiku 6 : Rëndësia e përzgjedhjes me meritokraci/pa meritokraci



Burimi: SPS.v.20

Në grafikun e mësipërm kemi pasqyruar se:

- përzgjedhja e punonjësve në administratën publike është kryer mbi bazën e meritokracisë. Për këtë janë shprehur 60% e të intervistuarve;

- 40% e të intervistuarve janë të mendimit se nuk janë zbatuar kriteret e meritokracisë.

Opinionin ndërkombëtar është bazuar mbi monitorimin e procesit. Ekspertët ndërkombëtar kanë kërkuar respektimin e kriterëve e të procedurave të parashikuara edhe në legjislacionin përkatës. Ata kanë qenë të mendimit se në këtë mënyrë procesi i reformimit apo i përmirësimit të administratës publike në vendin tonë të mos dështojë dhe aderimi i ardhshëm i Shqipërisë të mos përballet me të papritura.

Pyetjes: A respektohet kodi i etikës profesionale nga stafet e administratës?

Sipas opinionit të dhënë nga punonjësve të administratës publike, etika në institucionet e administratës publike në përgjithësi është respektuar.

Një pjesë e të intervistuarve janë të mendimit se etika si kriter i nevojshëm për mirëfunksionimin e administratës publike nuk është zbatuar dhe në disa raste edhe është cënuar.

Grafiku 7 : Kodi i etikës nga punonjësit e DAP



Burimi: SPSS.v.20

Kësaj pyetje i janë përgjigjur se:

- 58.3% e punonjësve e kanë respektuar etikën profesionale;
- 41.7% nuk e kanë respektuar;


Ky është tregues i qartë që ka karakterizuar punonjësit e administratës publike. Nga të dhënat e të intervistuarve kemi arritur në mendimin se ka munguar bashkëpunimi midis punonjësve të niveleve të ndryshme të administratës publike dhe kjo natyrisht është shoqëruar me dobësi të

theksuara në veprimtarinë e kësaj administrate. Gjithashtu nga opinionet e të intervistuarve kemi arritur në përfundimin se opinioni ndërkombëtar ka qenë shumë kritik për nivelin e etikës profesionale të manifestuar nga punonjësit e administratës publike.

Pyetjes: A është realizuar sistemi i ri i pagave në administratën publike?

Nga përgjigjet që kanë dhënë të intervistuarit kemi arritur se sistemi i pagave i zbatuar në administratën publike nuk ka qenë funksional. Ai nuk ka ndikuar në rritjen e cilësisë së profesionalizmit, në shmangien e formave korruptive. Nga intervistat që u kemi marrë punonjësve të institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë si: Delegacioni i BE-se dhe OSCE, kemi arritur në mendimin se skema e zbatimit të sistemit të pagave në administratën publike është bazuar mbi preferencën e klaneve, si edhe nuk respektohet transparenca e nevojshme.

Grafiku 8 : Sistemi i ri i pagave



Burimi: SPSS.v.20

Grafikët, paqyrojnë një tablo ku të anketuarit në mënyrë unanime kanë mendimin se ky proces ende nuk është i konsoliduar.

Duke hequr paralele me zbatimin e sistemit të pagave për administratën publike në Kroaci kemi arritur në mendimin se kjo ka qenë një nga reformat më të suksesshëme që qeveria e këtij vendi ka realizuar për përmirësinë e cilësisë së stafeve, për rritjen e kapaciteteve profesionale në nivel evropian. Ata e kanë parë zbatimin e sistemit të pagave si një metodë për të motivuar punonjësit dhe për të evituar format e ndryshme të korrupsionit në administratën publike. Nga përvoja kroate kemi nxjerrë konkluzionin se respektimi i sistemit të pagave ndikon në përmirësimin e

sistemit të karrierës në administratën publike. Sistemi i pagave gjithashtu ndikon edhe në zbatimin e legjislacionit përkatës në institucionet e ndryshme të shtetit shqiptarë.

Në qendër të punimit tonë kanë qenë edhe strategjitë e reja evropiane për zhvillimin e procesit të integritetit evropian të vendeve të Ballkanit, ku shtetet janë të përfshirë në një process të përbashkët sikurse është procesi i Berlinit. Për këtë janë intervistuar edhe punonjësit e dy ministrive koordinuese të procesit, sic janë: Ministria e Integritetit Evropian dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë

Pyetja: Cili është roli juaj si institucione të administratës publike për rolin e “Procesit të Berlinit”?

Opinion kombëtar, pra ai I dhënë nga punonjësit e intervistuar të administratës publike është se ky është një process politik, prandaj do të jenë qeveritë përkatëse ato që do të bëjnë të mundur zbatimin e reformave në këtë.

Përfaqësuesit ndërkombëtar kanë mendimin se Procesi I Berlinit është sa politik, aq edhe teknik. Ata e drejtojnë vëmendjen te ndërtimi I institucioneve te profesionalizmi I punonjësve dhe që në këtë mënyrë ecuria e procesit të jetë e garantuar. Nga deklaratat e z. Junker, president I Komisionit Evropian kupton se nuk do të ketë zgjerim të mëtejshëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Nisma e Re e Procesit të Berlinit sipas këndvështrimit, të prof.Bieber e ka konsideruar këtë iniciativë politike dhe si një fazë e re drejt zgjerimit të BE-së. Johann Sattle e ka vlerësuar procesin duke i parë vendet e Ballkanit si interesante e tërheqëse për të vazhduar procesin e reformave, e në kuadër të tij janë akorduar edhe fonde për sektorë të ndryshëm institucionalë.

Pyetjes: Si e shikoni rolin e organizatave ndërkombëtare në procesin e integritetit evropian?

Kësaj pyetje punonjësit e administratës publike të vendit tonë (opinion kombëtar) i janë përgjigjur se roli i tyre është pozitiv dhe ndikon në zbatimin e mëtejshëm të reformave Konstruktiviteti që luajnë organizatat ndërkombëtare ka ndikuar në përmirësimin e institucioneve të Shqipërisë dhe në mënyrë që të rritet funksionaliteti i tyre.

Nga intervistat që kemi realizuar me përfaqësuesit ndërkombëtarë në vendin tonë, ata janë shprehur se janë përpjekur që t'i sjellin reformat evropiane sa më pranë zhvillimeve aktuale shqiptare, në mënyrë që kapërcimi i vështirësive të zhvillimit të vendit të jetë më i lehtë. Në analizën e tyre është theksuar se ka roli i tyre si institucione ndërkombëtare, është i përkohshëm, për atë kohë sa vetë institucionet e Shqipërisë të krijojnë kapacitete të qëndrueshme dhe konstruktive.

Pyetjes se: çfarë modeli po zbatojnë Organizatat Ndërkombëtare nëpërmjet reformave në Shqipëri?

Kësaj pyetjeje, duke iu referuar opinionit kombëtar, të intervistuarit janë të mendimit, se si rezultat i punës që ato kryejnë në institucione të ndryshme të shtetit shqiptar etj., kanë ndikuar në qasjen e modeleve dhe në implementimin e tyre për realizimin e demokracisë funksionale.

Opinionin ndërkombëtar, për këtë pyetjeje është i mendimit se nuk ka model fiks, se ata po përpiqen të drejtojnë institucionet e shtetit tonë të ndjekin lëvizjen horizontale e në këtë mënyrë, sipas tyre, implementimi i reformave ka për të qenë më produktiv e funksional.

Pyetjes: A janë elitat politike shqiptare pjesë vendimmarrëse në këtë proces evropianizimi?

Kësaj pyetjeje i kemi kushtuar rëndësi të veçantë, sepse ajo lidhet edhe me vërtetimin e hipotezës sonë që në krye të punimit. Duke iu referuar opinionit kombëtar, pra mendimit të shprehur nga punonjësit e administratës sonë publike, kemi arritur në mendimin se elitat shqiptare, stafet akademike, universitare e intelektuale janë lënë jashtë përfshirjes në procesin e reformimit evropian të institucioneve të administratës publike.

Opinionin ekspertëve ndërkombëtarë i transmetuar nëpërmjet intervistave e pyetësorëve është se roli dhe ndikimi i botës akademike e universitare në procesin e integritetit evropian të administratës publike është i domosdoshëm e në disa aspekte edhe vendimtar.

Ata e kanë vlerësuar këtë pjesëmarrje si element të rëndësishëm për funksionimin e procesit. Kjo duhej të ishte qasja që duhej t'i orientonte institucionet tona të shoqëria civile, të stafet akademike, të intelektualë të fushave të ndryshme, të cilët duhet të ishin pjesë aktive e këtij procesi delikat e të rëndësishëm për të ardhmen demokratike të vendit.

Faktori ndërkombëtar ka vënë norma kushtëzimi për realizimin e procesit dhe kjo shumë mirë shikohet tek roli që ka marrë Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian. Ai ka përfshirë përherë të parë në këtë proces focus- grupet e sipërpërmendura.

Duke parë performacën e institucioneve, në rrafshin e reformave evropianizuese, objektivi kërkimor i studimit është marrja e përvojës dhe e produktivitetit që sjellin grupet e interesit në këtë proces.

Nga intervistimi dhe anketimi që u kemi bërë një numri të caktuar punonjësish të administratës publike për pyetjen :

“A janë institucionet shqiptare demokratike dhe a promovojnë ato transparencë e demokraci”? Në përgjigje të kësaj pyetjeje ka rezultuar se:

- 10 43% e tyre deklarojnë mungesë transparence të zhvillimeve politikëbërëse e në kuadër të reformave integruese evropiane;
- 11 34% e të anketuarve deklarojnë se jetojnë me institucione jodemokratike, sesa demokratike;
- 12 Vetëm 20 % e intervistuesve nga ndërkombëtarët mendojnë se institucionet shqiptare janë drejt një procesi modernizimi, por kushtëzimet evropiane për të implementuar reformat janë ende pjesë e procesit.

Shqipëria e ka kaluar procesin e tranzicionit. Është e rëndësishme të përfshijë dhe të informojë perceptimin që ka te qytetarët procesi i integritetit evropian. Perceptimi i qytetarëve për nivelin e demokratizimit është se në vendin tonë është zbatuar, deri tani një regjim hibrid.

Në përgjigje të pyetjes :

13 A kemi Institucione të besueshme dhe me kapacitete profesionale?

Nga të intervistuarit ka rezultuar se niveli i besueshmërisë tek institucionet është i dobët, sepse mënyra e funksionimit të tyre nuk është gjithmonë në harmomi e në kohezion me rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Gjithashtu, edhe ndërkombëtarët, ende japin opinione skeptike lidhur me mirëfunksionimin e institucioneve.

Një nga pyetjet që u është bërë intervistuesve ndërkombëtarë, ashtu edhe ajo që ka të bëjë me punonjësit e administratës publike, për procesin e rekrutimit në administratën publike, mbi vendosjen e kriterëve të përzgjedhjes, si zbatohen ato, si realizohen konkurset, si një nga prioritetet që Shqipëria duhet të plotësojë.

Nga monitorimi dhe intervistimi i stafeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe sipas progres-raportit të Nëntorit 2015, i cili thekson progresin e bërë nga Shqipëria. Në kuadër të reformës, vërejmë se, edhe pse vlerësimet në baza strukturore janë pozitive, ende ky proces ka vlerësimin e vetë, si rezultat i komenteve nga të intervistuarit, të cilët kanë theksuar se procesi i rekrutimit në administratën publike është një qasje top-down dhe se ndikimi politik mbetet ende i pranishëm në përzgjedhjen e punonjësve të të gjitha niveleve të administratës publike(drejtues/p.sektori /specialist etj.).

Dinamika e zbatimit produktiv të procesit të reformimit të administratës publike, ka treguar se procesi ende nuk ka arritur të krijojë institucione të qëndrueshme. Me venien në zbatim të ligjit të ri të nënpunësit civil, kriteret e përzgjedhjes, edhe pse janë vendosur, sipas pozicionit të fushës, intervistuesit janë shprehur se nuk ka transparencë të detajuar për zhvillimin e konkurseve. Gjatë seancës së intervistës komunikimi është thjesht formal, tepër teorik dhe jo me kasuse, se si një aplikant profesionist duhet ta zgjidhë situatën për pozicionin e punës që ka aplikuar.

Realizimi i konkurseve ka elementë të transparencës, por nuk është i detajuar kundrejt aplikantit, sepse nuk janë justifikuar arsyet e pikëve që ai ka fituar. Në këtë mënyrë, ende ky proces, edhe pse ka progres, ka dinamikë zhvillimi, krahasuar me modelin e rekrutimit që është përdorur në administratën publike në vitet e para të tranzicionit ka qenë jo cilësor, jo produktiv dhe jo sipas kërkesave të procesit të integritetit evropian të vendit, ku reformimi i administratës publike duhej të përbënte një nga përparësitë themelore.

Aktualisht, kemi një model horizontal më evropian, por që ende ka nevojë për përmirësime të rëndësishme. “Punësimi në administratën publike vazhdon të jetë korruptiv dhe në zyrat e shtetit punësohen persona të paarsimuar e pa përvojë. Problem i theksuar i administratës shqiptare mbeten edhe emërimet nepotike. Edhe pse ka ligj për rritjen e cilësisë së të punësuarve në zyrat e

shtetit, punësohen ata që kanë dhënë para ose janë të rekomanduar nga njerëz të pushtetit (Raporti i Liderit të Evropës Juglindore për zhvillim dhe integritet, SELDI) korrik, 2016

Duke iu referuar raportit të fundit të Komisionit Evropian mbi ecurinë e realizimit të prioritetëve shqiptarë, në kuadër të procesit integrues, ku monitorimi ndërkombëtar, ashtu sikurse edhe monitorimi që unë kam realizuar mbi institucionet, është vënë theksi se impakti ndërkombëtar për implementimin e këtyre sfidave është shoqëruar me mekanizma të ndryshme, por sërish kemi mungesë të profesionalizmit dhe mungesë depolitizimi të përzgjedhjes për të rritur kapacitetet profesionale e rritjen e cilësisë së institucioneve.

Një nga pyetjet që u është drejtuar përfaqësuesve të delegacioneve ndërkombëtare në Tiranë, si përfaqësueses së Delegacionit Evropian dhe përfaqësuesve të trupës diplomatike të OSCE, “Nëse mendojnë se a kanë impakt të mjaftueshëm tek përfaqësuesit e institucioneve shqiptare që të bëhet i mundur implementimi i reformave nga pala shqiptare”?

Përgjigjja e tyre ka qënë në mënyrë diplomatike dhe e rezervuar. Ajo çfarë shprehte mesazhi i tyre ka qënë i përqendruar se në përgjithësi reformat janë detyrë e padiskutueshme e institucioneve shqiptare dhe misioni ndërkombëtar është vetëm për të monitoruar këtë proces. Ky mesazh, të lë të kuptosh se përfaqësuesit shqiptarë mbeten kokëfortë dhe aspak tolerantë për të përmirësuar klimën e bashkëpunimit për të mirën e një kauze të përbashkët dhe se shembulli kroat, si një model suksesi në rajon, edhe pse po përpiqet shumë për t’u modeluar nga qeveria shqiptare, mbetet ende i vështirë të vihet në zbatim.

Në përgjigjet e ndërkombëtarëve mbi pyetjen se : Çfarë mendoni, nëse elita politike, profesionale e intelektuale shqiptare ka vullnet të plotë për të plotësuar reformat?

Përgjigjet e tyre, edhe për këtë pyetje, kanë qënë diplomatike, por ndonjëherë edhe të drejtëpërdrejta e shumë kritike lidhur me përfshirjen e elitave shqiptare, ku nuk përfshihen vetëm qeveritarët, por edhe stafet akademike, kërkues shkencorë, studentë dhe intelektualë të tjerë. Sipas opinionit ndërkombëtar, këto grupe nuk janë të përfshira në proces dhe se ka qënë shumë sipërfaqësore pjesëmarrja e tyre.

Sipas Znj.Vllahutin., e cila citon rastin kroat në momentin, kur vendi i saj ka qënë në proces të ngjashëm, me të cilin është përballur Shqipëria e vijon edhe sot. Ajo ka theksuar se qeveritarët

kroatë, kur erdhën në pushtet, vendosën që këtë proces ta çojnë përpara për të mirën e qytetarëve të tyre. Ata krijuan të gjitha hapësirat e nevojshme për të gjitha grupet e përfshira në këtë proces, gjë të cilën ajo e ka parë si shumë të vakët në implementimin e reformave evropianizuese në Shqipëri.

Duke iu referuar pyetjes së më poshtme, e cila u është drejtuar, si përfaqësuesve të politikës shqiptare, ashtu edhe atyre ndërkombëtarë, pra : Nëse janë ekspertët shqiptarë në të njëjtin nivel me ekspertët ndërkombëtarë apo ka dallime?

Kësaj pyetje i janë përgjigjur në këtë mënyrë :


20% e përfaqësuesve ndërkombëtarë, të cilët mendojnë ende se institucionet shqiptare kanë nevojë për asistencë ndërkombëtare. Ata, ende gjejnë vështirësi në bashkëpunimet me stafet e institucioneve tona. Një nga arsyet e kësaj problematike ka rezultuar, si rrjedhim i impaktit politik që ka pasur rekrutimi i punonjësve jo mbi baza të meritokracisë.

Po ashtu, nga përgjigjet e punonjësve të niveleve të ndryshme në institucionet tona të administratës publike :

14 30% e tyre janë shprehur, se edhe pse për rritjen e kapacitetve dhe të cilësisë profesionale të administratës publike janë investuar fonde për trajnimin e stafeve, ende ndjehet nevoja e ekspertizave ndërkombëtare apo e shkëmbimeve të eksperiencave të stafeve të institucioneve shqiptare me ato të vendeve perëndimore, në mënyrë që ato të marrin të gjithë ekspertizën e nevojshme;

15 10 % e ekspertëve të pavarur të intervistuar, janë janë të mendimit se ekspertët shqiptarë, të cilët janë produkt i universiteteve ndërkombëtare dhe që janë në Shqipëri, mund të zëvendësojnë shumë mirë ekspertët ndërkombëtarë, pasi profesionalizmi i tyre është në nivele të larta. Kjo analizë sasiore dhe cilësore është paraqitur nëpërmjet këtij grafiku:

Grafiku 9: Niveli i cilësisë Profesionale



Burimi: SPSS.v.20

Një nga pyetjet që është vlerësuar me interes është : Nëse bashkëpunimi midis stafeve të administratës publike është produktiv?

Nga përgjigjet që kanë dhënë punonjësit e administratës publike kanë dalë në pah se shpesh kjo ka përbërë problematikë për bashkëpunimin dhe ecjen e procesit. Duke iu referuar të dhënave të modelit kroat, bashkëpunimi ndërmjet stafeve të niveleve të ndryshme të institucioneve të administratës publike për ecjen përpara të procesit të integritetit evropian, është mbështetur mbi bazën e besimit të ndërsjellë dhe tolerancës.

Një tjetër pyetje që është adresuar gjatë intervistës është se : A kemi një produktivitet të administratës publike në mënyrën e funksionimit dhe të koordinimit ndërmjet institucioneve?

Nga përgjigjet e dhëna ka konkluduar se :

16 58% e punonjësve të administratës publike janë ende skeptikë për efikasitetin e reformave dhe përmirësimin profesional të punonjësve. Ata besojnë se këto janë vendimmarrje të rëndësishme që duhet të ndërmerren nga politikëbërësit dhe ekspertët, si edhe nga grupet e interesit që përfshihen e përfitojnë në këtë reformë.

Nga përgjigjet e dhëna, ka rezultuar se :

17 ¼ e të anketuarve kanë mendimin se qytetarët duhet të jenë më të përfshirë në këtë proces, për të kuptuar më mirë transformimin që ndodh në hartimin e ligjeve të reja apo riformatimin e institucioneve. Nëse qytetarët dhe grupet e interesit nuk janë të përfshirë, ky është një proces që do të marrë kohë në implementimin drejt qytetarëve dhe kjo do të japë pasoja tek procesi evropianizimit;

18 18% e ekspertëve dhe politikëbërësve kanë besuar se kjo vendimmarrje duhet të bazohet mbi besimin tek ekspertët që merren me këtë çështje. (opinion i ndërkombëtarëve)

Ka qenë me interes përgjigjja që është dhënë për pyetjet se : Ngritja e një sistemi demokratik dhe kushtëzimi ndërmjet reformave, a ka sjellë rezultate në procesin e evropianizimit? A kanë ndikuar këto në procesin e shtetndërtimit të suksesshëm?

Lidhur me këto pyetje janë përgjigjur të intervistuarit se :

19 47% kanë mendimin se ende mungojnë elementë të rëndësishëm për ndërtimin e sistemit demokratik, sikurse janë efikasiteti dhe transparenca, prandaj sistemi demokratik është ende i paplotësuar;

20 65% e të anketuarve janë përgjigjur se kriteret e kushtëzimet evropiane për realizimin e reformave shpesh nuk kanë pasur ndikimin e duhur për të realizuar në mënyrë cilësore e demokratike procesin e evropianizimit, edhe pse ka progres, por ende në stad minimal.

5.3.2 Përpunimi i të dhënave sasiore e cilësore mbi standardizimin e ekspertizës profesionale në institucionet publike shqiptare.

Vendi ynë ka bërë përpjekje të mëdha për institucionalizimin e procedurat që do të duhej të zbatoheshin për të siguruar rekrutimin e punojësve të rinj, bazuar në meritokracinë profesionale dhe sipas kërkesave të ligjit për shërbimin civil.

Kërkesat themelore të tilla si : shpallje e detyrueshme e vendeve të lira, të cilat janë aplikuar në të gjithë vendin, procedurat themelore të provimit, si edhe e drejta e ankimimit kundrejt rezultateve e vendimeve të përzgjedhjes, kanë ekzistuar e ekzistojnë edhe në të gjitha vendet e tjera të rajonit. Aktualisht, ajo që po ndodh me procesin e rritjes së kapaciteteve profesionale në institucionet e administratës publike në vendin tonë, jemi të mndimit se është bërë ende shumë pak.

Organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Komisionin Evropian, në mënyrë aktive kanë nxitur krijimin e institucioneve të rekrutimit me meritë gjatë dekadës së fundit. Ata kanë qenë të suksesshëm në përhapjen e procedurave formale për të gjitha vendet, edhe në qoftë se ndikimi i tyre ka ndryshuar me kalimin e kohës. Treguesit e institucioneve nuk kanë qenë të përsosura dhe të pafavorshme, si rezultat i kushteve të brendshme politike, kushteve ekonomike e sociale. Ajo, praktikisht e ka pasur të pamundur për të gjeneruar rezultatet e meritës nëpërmjet mënyrës së organizimit të institucioneve.


Një nga përparësitë kombëtare për të rritur nivelin profesional të punonjësve, ka qenë shqyrtimi i mekanizmave nxitëse, cka do të bënte të mundur orientimin drejt përzgjedhjes sa më profesionale të stafit, në mënyrë që të rritej niveli i punonjësve me formim të lartë profesional dhe t'u afrohej ekspertëve ndërkombëtarë.

Nga intervistat e realizuara me stafet e administratës publike, është vëzhguar se punonjësit për shkak të ndryshimeve politike kanë kryer lëvizje në drejtori të ndryshme, duke u angazhuar përsëri nga fillimi me çështje dhe problematika të ndryshme.

Një ekspert i fushës nuk qëndron për të rritur nivelin profesional në atë drejtori që është rekrutuar dhe ka pranuar detyrat që i janë ngarkuar, por në situata të caktuara politike ka bërë lëvizje paralele në sektorë të ndryshëm. Kjo ka sjellë problematikë, si në rritjen e kapaciteteve

profesionale të stafeve të niveleve të ndryshme, ashtu edhe në bashkëpunimin ndërministror. Ja si pasqyrohet kjo grafikisht më poshtë:

Grafiku 10 : Kategorizimi i profesionalizmit të stafeve



Burimi: SPSS.v.20


Nga grafiku del qartë se në institucionet tona, nuk ka drejtori, sektorë apo njësi specifike që stafet e emëruara të jenë përgjegjës në punën e tyre, sipas kualifikimeve që janë diplomuar. Ata e zhvillojnë veprimtarinë, sipas ndryshimeve të brendshme strukturore ministrore nga një drejtori në tjetrën, apo nga një sektor në tjetrin.

Duke analizuar vlerësimin mbi ndarjen e nivelit të profesionalizmit, kemi vërejtur se :

- 21 30% e specialistëve kanë theksuar se janë përpjekur të qëndrojnë në sektorët që i përshtaten profilit të tyre, pavarësisht ndryshimeve të ndryshme strukturore që janë bërë;
- 22 30% e të intervistuarve janë shprehur se rritjen e tyre profesionale e kanë zhvilluar në sektorë të përafërt;
- 23 40% janë shprehur se profesionalizmi i tyre ka qenë miks, sepse emërimet e tyre kanë ndryshuar nga një sektor në tjetrin për arsye politike.

Pyetjes se: ***Cili është niveli i profesionalizmit në institucionet tona të administratës publike?***

Grafiku 11: Niveli i përgjithshëm i profesionalizmit



Burimi: SPSS.v.20

Ky grafik, ka pasqyruar përgjigjet e pyetjeve që u janë bërë një kategorie të caktuar të intervistuarish për reformën në administratën publike, si edhe për të parë, nëpërmjet këtij grafiku panoramën e përgjigjeve. Kjo ka qenë e lidhur me pritshmëritë që ky fokus-grup ka pasur.

Duke parë se rritja e profesionalizmit ka qenë një nga reformat më të rëndësishme në institucionet publike. Edhe pse përmirësimi institucional ka pasur progresin e vet, ajo çfarë mbetet ende për t'u përmirësuar është pikërisht orientimi nga ana e DAP-it që kualifikimi i punonjësve të administratës publike të jetë në vijë paralele me emërimet dhe jo me pozicione gjithëpërfshirëse, sepse kjo gjithmonë ka për të sjellë pengesa në rritjen e specialistëve të fushave specifike në vend. Ajo gjithmonë do të kërkojë ndërhyrjen e ekspertëve ndërkombëtarë në çështjet kyçe.

Është e rëndësishme tërheqja e ekspertëve shqiptarë, të cilët japin ekspertiza ndërkombëtare e kjo duhet të jetë në fokus të prioriteteve shtetërore, duke nxitur një sistem pagash të një niveli pagesash më të lartë, ose në formë honorarësh për tërheqjen e përfshirjen e tyre në administratën publike.

5.4 Tranzicioni i institucioneve kroate drejt përsosjes në strukturat evropianizuese.

Administrata publike ka pësuar transformim të thellë nga shpërbërja e regjimit socialist në Kroaci. Reformat në fushën e administratës publike kanë qenë shumë të gjera dhe komplekse. Reformat, në sektorin publik kroat, kanë qenë problem i vazhdueshëm në axhendën e klasës politike, të nëpunësve civilë dhe të publikut të gjerë.

Shpesh reformat janë parë, janë trajtuar si të buta, në kundërshtim dhe madje të pasuksesshme, pavarësisht nivelit të lartë të vëmendjes së dedikuar, investimeve financiare dhe kohës të konsumuar. Sipas Koprić, reformat që kanë synuar rritjen e kapaciteteve administrative, kanë dështuar për shkak të një kuptimi shumë të ngushtë të aspektit organizativ, funksional, si edhe për çështjet personale politike të përfshira.

Kroacia ka një sistem dynivelesh për administrimin e pushtetit:

- a. administratat e qeverisjes qendrore;
- b. administratat e qeverisjes vendore.

Institucionalisht, sektori publik është përbërë nga entitete të ndryshme që kryejnë funksionet themelore të shtetit, duke përfshirë qeverinë qendrore dhe vendore, agjencitë e tyre dhe organet e personat e tjerë juridikë të themeluara e të financuara kryesisht nga shteti.

Në terma më të gjera, sektori publik përfshin, jo vetëm ekzekutivin, por edhe veprimtari ose shërbime me interes të përbashkët, marrëdhëniet e biznesmenëve midis qeverisë dhe autoriteteve lokale, financave publike, të mirave publike dhe të shtetit ligjor. Rrjedhimisht, sistemi është shumë kompleks, i cili patjetër që e bën më të ndërlikuar për t'u menaxhuar.

Funksionet e kryera nga subjekte të ndryshme kanë ndryshuar dhe nuk kanë qenë vlerësuar pasojat e menjëhershme e afatgjata të reformave të sektorit publik.

Një çështje tjetër, të theksuar në raportin e progresit, ka qenë mungesa e koordinimit në "niveleve politike dhe teknike". Edhe pse iniciativat e programet e reformës do të kishin mundësi për të qenë më mirë të koordinuara, nëse do të administrohej nga një qendër (supozohet

Ministria e Administrimit), projekte të rëndësishme do të ndikonin në proces dhe në cilësi të performancës.

Duke u ndalur te Kroacia, se si ajo u administrua nga një organ i posaçëm, i krijuar dhe nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të qeverisë, si edhe nga Zyra Administrative Qendrore e Shtetërore për Kroacinë. Sektori publik në Kroaci është zhvilluar për të kënaqur nevojat publike, si edhe për të kryer funksionet themelore të shtetit.

Fusha e veprimtarisë së administratës publike ka qenë shumë e gjerë e komplekse. Përkufizimet ligjore ndërkombëtare e kroate të sektorit publik nuk janë përcaktuar në mënyrë uniforme. Hapi i parë i nevojshëm për të vlerësuar reformat e sektorit publik të ndërmarra në dy dekadat e fundit ka qenë krijimi i sistemit për klasifikimin e institucioneve të ndryshme të organeve qeveritare dhe të subjekteve kuazi-autonome, të cilat do të dallonin subjektet :

- së pari, nga funksioni;
- së dyti, nga mënyrat e përshtatshme të qeverisjes.

5.4.1 Kushtëzimet evropiane në administratën publike kroate.

Institucionet kroate kanë kërkuar të rritnin kapacitetet profesionale administrative, në kuadër të marrëveshjes së stabilizim- associmit, e nënshkruar nga Kroacia në vitin 2001 dhe që hyri në fuqi në vitin 2005, duke u përpjekur për realizimin e standardeve. Vështirësitë që kishte identifikuar Komisioni Evropian për ecurinë e Kroacisë mbi Implementimin e reformës së administratës publike, nuk ishte vetëm parakusht i procesit të integritit evropian, por gjithashtu nevojë emergjente për të rritur ekonominë dhe zhvillimin e vendit si vend kandidat.

Për të arritur këto sfida, autoritet kroate vendosën të forcojnë bashkëpunimin për të arritur efikasitetin e për të ulur korrupsionin, në drejtësi dhe në administratën publike, në mënyrë që të arriheshin standardet evropiane.

Dobësitë në administratën publike kroate janë zbuluar tashmë në procesin e para-anëtarësimit, si një nga pengesat më të rëndësishme të reformave të avancimit. Njëkohësisht me evropianizimin,

ishte edhe kërkesa e qytetarëve për një administratë publike të modernizuar, efikase, transparente dhe në rritje.

Në këtë mënyrë, procesi i anëtarësimit mund të ndihmojë në tejkalimin e boshllëqeve ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve. Duke synuar përmirësimin e kapacitetit institucional të administratës publike, BE-ja, si rregull, ka transferuar ekspertizë të huaj në formën e trajnimit të programeve edukative dhe të ndihmës teknike, si aspekte të ligjit kombëtar të shërbimit civil.

Lidhur me strukturat administrative në vend janë shqyrtuar (psh përkufizimi i shërbimit publik dhe marrëdhëniet e punësimit, kriteret e rekrutimit, kontrollit dhe kompetencës, çështjet në menaxhimin e personelit, kohën e punës, vlerësimin e stafit etj.

Në përgjigje të detyrimeve të MSA-së, Kroacia ka krijuar kornizën e nevojshme ligjore për reformat e kërkuara institucionale. Ligjet e reja për shërbimin civil janë miratuar në tetor të vitit 2005 dhe kanë hyrë në fuqi që nga 1 janari 2006. Në këtë mënyrë, administrata kroate ka kërkuar sistem të pavarur të emërimeve të shërbimit publik dhe për këtë ka krijuar sistemin e vlerësimit të performancës individuale të punës, si edhe për të përcaktuar kriteret të qarta për zhvillimin e karrierës, e cila deri më tani, nuk ka qenë e dobishme.

Kushtëzimet e BE-së në Administratën Publike janë të lidhura me katër grupe kriteresh :

1. Kërkesa e parë ka ardhur nga procesi i integritetit evropian për administratën shtetërore, e cila ka lidhje me “Kriteret e Kopenhagenit”, në vitin 1993, të cilat, ndër të tjera kanë theksuar se stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë lidhet me sundimin e ligjit, si edhe me miratimin e legjislacionit të Komunitetit Evropian (i ashtuquajturit *acquis communautaire*), që nënkupton nevojën për institucione efektive të administratës publike.

Në këtë mënyrë, Bashkimi Evropian ka identifikuar dobësinë e institucioneve shtetërore në shtetet Qendrore dhe Lindore (EQL) Evropiane, si një nga pengesat kryesore në rrugën e pranimin, duke përcaktuar forcimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet ndërtimit të institucioneve, si një nga para-kriteret e pranimin.

Termi “ndërtimi i institucioneve” është prezantuar në vitin 1997 në kontekstin e zgjerimit drejt Evropës Qendrore dhe Lindore, duke kërkuar rritjen e kapaciteteve institucionale në mënyrë që të përmbushë kriterin e tretë të Kopenhagenit, duke u fokusuar në transpozimin e *acquis communautaire* të BE-së (Dimitar Bechev and Svetlozar Andreev, 2005)

2. Kriteri i dytë, i përcaktuar në takimin e Madridit, ka qenë e është i lidhur me transpozimin e *acquis* në legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e tij në efektivitetin e strukturave administrative e gjyqësore të vendeve aplikante.

Me fjalë të tjera, në mënyrë që të aderojnë në BE, vendet aplikante janë pyetur për mundësinë që kanë për të forcuar kapacitetin e tyre administrativ. Në këtë mënyrë, BE-ja ka krijuar kapacitetet administrative të nevojshme, si një parakusht thelbësor i anëtarësimit. Dikush mund të thotë se krijimi i kushteve të Madridit në kriteret e para-pranimit të përbënin bazën për krijimin e besimit të ndërsjellë të kërkuar nga anëtarësimi në BE, si kapacitetet funksionale administrative, të cilat do të lejonin zbatimin e *acquis communautaire*. Kjo kërkesë është përsëritur në forma të ndryshme dhe në kushtet strikte në dokumentet pasuese zyrtare të BE-së që merren me çështjen e zgjerimit (European Council, 2000).

3. Komponenti i tretë i kriterëve të para-pranimit administrativ ka të bëjë me parime që përbëjnë Hapësirën Administrative Evropiane (SIGMA Papers (1998) HAE.

HAE mund të përshkruhet si:

"Kontakti konstant ndërmjet nëpunësve civilë të shteteve anëtare dhe Komisionit, kërkesa për të zhvilluar dhe për të zbatuar *acquis communautaire* në standarde të besueshme në të gjithë Bashkimin Evropian, shfaqjen e një sistemi evropian të drejtësisë administrative, me vlera themelore të përbashkëta të administratës publike dhe me parimet "(OECD,)

“Sipas Francisco Kardona, parimet kryesore për administratën evropiane i kanë ndarë grupet në katër kategori, konkretisht :

1. Kategoria e parë, sundimi i ligjit, përcaktohet në termat e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së veprimeve dhe vendimeve administrative. Kjo kategori i është referuar parimit të ligjshmërisë. Ajo është kundërshtar e arbitraritetit në vendimmarrjen publike dhe për nevojën e respektimit të pritjeve legjitime të individëve.

2. Parimi i dytë është hapja dhe transparenca. Ai ka për qëllim sigurimin e shqyrtimit të shëndoshë të proceseve administrative e rezultateve. Rëndësia e tij lidhet me zbatimin e rregullave të paracaktuara.
3. Parimi i tretë lidhet me përgjegjshmërinë e administratës publike ndaj organeve të tjera administrative, legjislative e gjyqësore. Ka për qëllim sigurimin e respektimit të sundimit të ligjit.
4. Së fundmi, parimi i katërt nënkupton efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe efektivitetin publik për arritjen e qëllimeve të politikave të përcaktuara në legjislacionin që zbaton (Francisco Kardona).
5. Bashkëpunimi administrativ midis shteteve anëtare ka ndikim në aspektin e marrëdhënieve sociale, zhvillimin e metodave, qasjeve të përbashkëta dhe për shpikjen e instrumenteve të reja. Me fjalë të tjera, e drejta komunitare ndikon në parimet themelore, në procesin e hapjes, deri te karriera dhe e kushteve të punës për nëpunësit civilë në të gjitha shtetet anëtare. Ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në marrëveshjet institucionale, proceset, standardet e përbashkëta të shteteve anëtare administrative dhe për vlerat e shërbimit civil. Ajo kontribuon në krijimin e hapësirës së përbashkët evropiane administrative.

Ndërtimi i institucioneve është dhënë si përparësi e lartë në disa procese të zgjerimit paraardhës. Veçanërisht u theksua me forcë gjatë procesit të zgjerimit të fundit që i lejoi vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të bashkohen me BE-në në vitin 2004. Vendeve kandidatë të asaj kohe iu kërkua të zhvillojnë administratat e tyre për të arritur nivelin e besueshmërisë së Hapësirës Evropiane Administrative dhe për të arritur pragun e pranueshëm të parimeve të përbashkëta, të procedurave dhe të marrëveshjeve strukturore administrative.

Përveç kësaj, kandidatët u pyetën për zgjerimin më të fundit, jo vetëm për të arritur një standard minimal të cilësisë dhe të besueshmërisë së administratës publike, por edhe për të arritur nivelin mesatar të ardhshëm të cilësisë së administratës publike të shteteve anëtare (OECD, “European Principles”, cit. 3.) Këshilli i Stabilizim-Associmit (Këshilli SA) ndërmjet Bashkimit Evropian

dhe Kroacisë ka vënë në dukje se Kroacia vazhdon të përmbushë kriteret politike, por se përpjekjet e qëndrueshme të mëtejshme janë të nevojshme në fusha të rëndësishme të tilla si :

- a. reforma e sistemit gjyqësor;
- b. reforma e administratës publike;
- c. lufta kundër korrupsionit dhe masave për të garantuar lirinë e medias.

Kroacia kishte nevojë të forconte strukturat administrative dhe gjyqësore që ishin të nevojshme për zbatimin efektiv të *acquis*. Këshilli SA ka theksuar se Kroacia e kishte të nevojshme për të realizuar qasje strategjike për *acquis*, shtrirje një hap përpara dhe për të zhvilluar strategjitë e përshtatshme gjithëpërfshirëse, të cilat duhet të përfshinin të gjitha reformat e nevojshme në drejtim të harmonizimit të legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale e institucionale për zbatimin dhe përmbushjen e *acquis* përkatës. (European Council, 2006).

Reforma e administratës publike në periudhën e paraanëtarësimit nuk ka të bëjë me rregullime të vogla në strukturat ekzistuese, por ajo kërkon reformë gjithëpërfshirëse, plotësisht të vërtetuar nga qeveria. Zyrtarët publikë në Kroaci ishin paralajmëruar nga BE-ja se reformat sektoriale kërkojnë për anëtarësim në BE. Ato vetëm mund të kenë sukses, në qoftë se një numër i sistemeve të përgjithshme kanë qenë të vendosur, siç duhet deri te:

- a. Kapacitetet për planifikimin e politikave në të gjithë sektorët;
- b. Koordinimin ndërministror;
- c. Vendimmarrja e qeverisë;
- d. Shërbimi civil, rregulloret për menaxhimin e burimeve njerëzore, me procedurat adekuate buxhetore dhe mekanizmat e përgjithshme të kontrollit financiar "(Jacques Wunenburger, 2004)
- e. Reforma e administratës publike është edhe parakusht thelbësor për një pjesë integrale të reformave fiskale që synojnë sjelljen e ekuilibrit të ardhurave të përgjithshme të qeverisë dhe të shpenzimeve. Reforma e sistemit të shpërblimit për nëpunësit civilë përbën një komponent të rëndësishëm të reformës fiskale, por edhe vendos bazën për shërbimin civil, të bazuar në meritë. Reformat e thella institucionale dhe organizative janë të nevojshme për të arritur objektivin final.

Së fundi, zbatimi i suksesshëm i *acquis* nga pozicioni i vendit kandidat që aspiron të bëhet shtet anëtar është i pavlefshëm pa struktura funksionale horizontale të qeverisjes dhe të sistemeve të tilla, si :

- Procedurat për veprime administrative;
- Mekanizmat për të siguruar se performanca e nëpunësve civilë është në përputhje me standardet e BE-së (Ivan Koprić, 2003);
- Marrëdhëniet BE - Kroaci janë intensifikuar vetëm pas ndryshimit të qeverisë në vitin 2000, pavarësisht faktit se Integrimi në Bashkimin Evropian ka qenë në mënyrë të qartë prioritet në programet e të gjitha qeverive kroate, që kur vendi fitoi pavarësinë e tij në 1991. Government of Republic of Croatia, 2003-2007).

Në margjinat e Samitit të Zagrebit në nëntor të vitit 2000, u hapën negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe me Kroacinë. Më pak se një vit pas kësaj, në tetor të vitit 2001, MSA-ja është nënshkruar. Procesi i ratifikimit në vendet anëtare u mbyll në shtator të vitit 2004. MSA përfundimisht ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2005, së bashku me Protokollin 7 në zgjerimin (Interim Agreement, 2001)

Kroacia paraqiti kërkesën për anëtarësim në BE, më 21 shkurt 2003. Aspiratat e Kroacisë për anëtarësim në BE u konsoliduan në qershor të atij viti, kur Këshilli Evropian i Selanikut përsëriti vendosmërinë e tij për ta mbështetur plotësisht e në mënyrë efektive integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai deklaroi se "vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëhen pjesë integrale e BE-së, pasi ato të plotësojnë kriteret e vendosura".

Në mënyrë të ngjashme, zyrtarët dhe institucionet e BE-së kanë deklaruar se "me kusht që Kroacia adreson sfidat e jashtëzakonshme dhe zhvillon kapacitetet e duhura administrative, bisedimet duhet të vazhdojnë me një ritëm të qëndrueshëm. Ato duhet të çojnë, sa më shpejt në përfundimin se të gjitha kriteret janë përmbushur, negociatat do të përfundonin në kohën e anëtarësimit të Kroacisë në Bashkimin Evropian ".(European Parliament, Croatia, 2006).

Opinionin u shoqërua nga Partneriteti Evropian për Kroacinë. 18 listat e përparësive afatshkurtëra dhe afatmesme për përgatitjet e Kroacisë për integrimin e mëtejshëm në Bashkimin Evropian, të identifikuara në Opinionin, shërbyen si një listë kontrolli për ta matur progresin. Vendimi i Këshillit mbi parimet, prioritetet dhe kushtet e përmbajtura në Partneritetin Evropian me

Kroacinë (19) përshkruan domosdoshmërinë për përmirësimin e mëtejshëm në performancën e administratës publike.

Ndër prioritetet afatshkurtra, vendit iu kërkua që të ndërmarrë hapa fillestare për të siguruar përdorimin e procedurave transparente për rekrutimin, promovimin dhe për të përmirësuar menaxhimin e burimeve njerëzore në të gjitha organet e administratës publike, në mënyrë që të siguronte përgjegjshmërinë, hapjen dhe transparencën e shërbimit publik.

Si përparësi afatmesme : vendi ishte i detyruar që të vazhdojë procesin e ndërtimit të institucioneve drejtpërdrejt relevante me acquis. Ai duhet të zbatojë reformat dhe të përmirësojë efektivitetin e administratës publike në përgjithësi. Për këtë ishte e nevojshme që :

Së pari, si shtet potencial anëtar i BE-së, Kroacia duhet të kishte kapacitete të mjaftueshme administrative për të përmbushur detyrimet e ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;

Së dyti, shpenzimet publike duhet të ishin në atë mënyrë që të arrihej huamarrja dhe qëndrueshmëria fiskale;

Së fundmi, gjendja e punëve në administratën publike kërkonte përmirësimin e menaxhimit të politikave dhe të koordinimit të saj.(Marija Pejčinović-Burić ,fjalim 30)

Koncepti i qeverisjes së mirë është pranuar gjerësisht nga të gjitha nivelet e qeverisjes, si edhe është mbështetur nga shoqëria civile kroate. Ajo ka promovuar hapjen, pjesëmarrjen, përgjegjësinë, efektivitetin dhe koherencën. Doktrina e qeverisjes së mirë ka bërë thirrje për forcimin e kapaciteteve të politikave në administratën publike. Ajo ka theksuar se rezultate të mira mund të arrihen nëpërmjet bashkëpunimit, plotësimit dhe harmonizimit të kërkesave të qytetarëve e të vetëqeverisjes lokale dhe / ose qeverisë qendrore (Kopric, 2005)

Ivan Koprić ka sugjeruar se reforma e administratës publike kroate duhet para së gjithash të arrijë në zhvillimin administrativ, duke u bazuar në modelin tradicional Weberian, të një administrate publike të organizuar, të mirëdokumentuar, të paanshme, etike, profesionale dhe efikase.

Vetëm më pas do të jetë në gjendje të aplikojë reformat e modernizimit të orientuara e të frymëzuara nga doktrinat e menaxhimit të ri publik dhe të qeverisjes së mirë që "synojnë drejt rezultateve të orientuara të buxheteve, krijimin e agjencive autonome ekzekutive dhe ndarjen e tyre nga detyra të politikave (të cilat mbahen në kuadër të ministrive), kalimi nga marrëdhëniet e personelit drejt statusit dhe kontratës së punës, etj (Kopric, cituar, 3)

Si rrugë ndërmjetëse të reformave, Koprić ka mbrojtur të ashtuquajturat "reforma të minimizuara", të cilat "...përpiqen për të ngushtuar sferën publike dhe për të zgjeruar sferën e iniciativës private me reduktim radikal të administratës publike", të cilat janë të orientuara drejt modernizimit të administratës publike. Është pikërisht ky lloj i reformës që është zbatuar në shumicën e vendeve të kontinentit evropian. (Compare Christopher Pollitt and Geert Bouckaert, 2001)

Shumica e ndryshimeve që pretendojmë, duhet që në administratën publike të formojnë fuqinë punëtore më të motivuar dhe të aftë mbi bazën e shërbimit civil. Në vijim, do të merret me analizën për të krijuar mjetin për tërheqjen dhe për mbajtjen e stafëve të kualifikuara, veçanërisht në pozita të larta drejtuese, të cilat janë ende të përcaktuara politikisht në Kroaci. Koprić numëron, në vijim, fushat prioritare për reformimin e administratës publike në Kroaci:

1. racionalizimin e administratës publike;
2. forcimi i kapaciteteve institucionale;
3. deburokratizimin;
4. orientimi drejt rezultateve, transparencës dhe hapjes;
5. decentralizimi.

Bindja jonë se këto ndryshime mund të ishin të arritshme, përforcohet nga Ligji i ri për Shërbimin Civil, i cili është miratuar në vitin 2006 dhe ka hyrë në fuqi, më 1 janar 2007. Kritikant kryesorë që janë drejtuar kundër këtij ligji janë se ai ka lënë shumë çështje kritike për t'u zgjidhur nga zbatimi i legjislacionit, çka ishte e nevojshme, nëse ligji do të kishte efekt pozitiv dhe për të arritur zbatimin e plotë e të duhur.

5.4.2 Ndërtimi i profesionalizmit bazuar në meritokracinë në Kroaci, si model suksesi

Qeverisja e mirë është e lidhur edhe me shërbimin civil efektiv. Patrick Keuleers ka evidentuar disa kërkesa në shërbimin civil që duhet të përmbushen, në mënyrë që të shërbejnë si parakusht i qeverisjes së mirë. Ajo duhet të jenë efikase e produktive në ofrimin e shërbimeve, duhet të jetë shumë profesionale dhe e aftë për të ofruar këshilla të mira teknike për qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike. Nënpunësit civilë duhet të mbështetin praktikat administrative të drejta e transparente dhe duhet të jenë të përgjegjshme për qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre. (Patrick Keuleers, 2004)

Si pjesë të kriterëve që duhet të përmbushen nga ana e sistemit të shërbimit civil në lidhje me një shërbim të profesionalizuar civil dhe kualifikimin e fuqisë punëtore të saj, Keuleers konsideron se zyrtarët shtetërorë duhet të jenë të gatshëm për të punësuar individët më të kualifikuar që disponon në çdo nivel, në bazë të një procesi rekrutimi të drejtë, transparent, ruajtjen e praktikave konkurruese të pagave që do të nxitin klimën motivuese për punonjësit e shtetit.

Kjo është thelbësore për të siguruar edhe mbështetje të fortë në drejtim të trajnimit të duhur dhe të zhvillimit në të gjitha nivelet.(Patrick Keuleers, 2004)

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit dhe me shtetet e reja anëtare të BE-së, Kroacia është dalluese për shkak të përmasave të mëdha dhe koston që ka administrata publike. Shpenzimet totale për paga e administratës publike janë pothuajse një e treta e të gjitha shpenzimeve, e cila e rendit Kroacinë në krye të shpenzimeve të pagave të sektorit publik në vendet e Evropës Qëndrore e Lindore, përveç Malit të Zi.

Keuleer bën dallimin ndërmjet dy qasjeve kryesore, për të përcaktuar vlerësimin e punësimit individual në nivelin e pagave të shërbimit civil duke i ndarë :

- 1) “sistemi i renditjes personale” ose sistemi i “man-in-rank”;
- 2) “sistemi pozicionimit” ose sistemi “job-ranking” i emertuar si sistemi i karrierës, ku paga është vëtëm e lidhur me përshkrimin e vendit të punës.

Ky vlerësim bazohet tek klasifikimi i kategorisë së punësimit dhe paguhet mbi bazën e karakteristikave kryesore të backgroundit individual. Sistemi i dytë, "sistemi pozicioni"

(sistemi gradave në punë") është një sistem i pagave, i themeluar në bazë të vlerësimeve të punës dhe në këtë mënyrë është fokusuar në përmbajtjen e vendeve të punës dhe jo në karakteristikat personale të punës. Ky mban 66 korniza legislative kroate për pagat e shërbimit civil dhe zbaton sistemin e pagesës, lidhur me kualifikimet akademike e kohëzgjatjen e punësimit brenda administratës.

Nëpunësit civilë në kategori që korrespondojnë me kompetencat aktuale të nëpunësve civilë. Këto kategori janë të ndara në klasat që përfaqësojnë nivelet e arsimit në vend dhe formacionet me rritjen e rregullt të pagave bazuar në vjetërsi.

- 3) Si rezultat, një sistem i ri i pagave për shërbimin publik ka qenë e projektuar dhe për këtë është hartuar ligji i ri për pagat e Shërbimeve Publike dhe Punësimit (World Bank).

Megjithatë, ajo që ka kaluar deri tani është se sistemi i ri, përbën normën, kushtin e shpërblimit për punonjësit e pushtetit vendor. Qeveria ka miratuar masën zbatuese në paga në përputhje me Ligjin e Ri për Shërbimin Civil, në mënyrë që të krijojë staf e nevojshëm profesionalizues dhe të eliminojë politizimin në shërbimin civil. Në kuadër të kushtëzimeve evropiane ajo çfarë shikohet si sukses nga shteti kroat është fakti se mënyra e implementimit të legjislacionit në institucione është realizuar me sukses.

Implementimi i reformave kombëtare, sikurse ishte statusi i nëpunësit civil, duke i ngritur kapacitetet profesionale e institucionale në nivel evropian ka krijuar kushtet për të çuar vendin drejt anëtarësimit në BE.

Vendi ka punuar për realizimin e reformave duke harruar kushtëzimet europiane, por duke i parë problemet si sfida e brendshme për të realizuar reformat e duke u bazuar në principet e demokracisë funksionale.

5.5 DALLIMET DHE NGJASHMËRITË E REFORMAVE INSTITUCIONALE MIDIS DY VENDEVE

Kroacia dhe Shqipëria, me prejardhje të ndryshme historike në ndërtimin e cilësisë institucionale, kanë kaluar nëpër faza të ndryshme dhe të ngjashme drejt procesit të integritetit evropian. Kroacia ka zhvilluar reformën e administratës publike, pasi fitoi pavarësinë në vitin 1991 dhe ka vazhduar konsolidimin me procesin e evropianizimit që u shoqërua me procesin e modernizimit. Të njëjtat procese të ndërtimit të institucioneve filluan në Shqipëri, pas rënies së regjimit socialist, ku institucionet u karakterizuan nga një numër problemesh në sektorin publik.

Faza e parë kroate : Administrata shtetërore, kaloi nëpër një numër të ndryshimeve të shpeshta, të konceptuara keq dhe zhvilloi riorganizimin, i cili u karakterizua nga vullnetarizmi politik. E njëjta situatë ishte në Shqipëri, pas viteve '90, kur qeveria u pasua nga institucione të dobëta.

Orientimi i BE-së për vendet, në këtë fazë, u pasua nga kapaciteti i dobët i administratës publike për të hartuar dhe udhëhequr me cilësi të lartë politikat publike afatgjata (politika arsimore, politika ekonomike, politika sociale, politikat e zhvillimit të administratës publike, politikën e decentralizimit, etj). Politikat publike janë kryer nën ndikimin e tepruar të konstelacioneve politike, pa pjesëmarrjen e mjaftueshme të nëpunësve civilë, qytetarëve dhe ekspertëve të fushave të ndryshme.

Faza e dytë e Kroacisë dhe e Shqipërisë, karakteristikat e reformave të asaj periudhe ishin:

- 24 Niveli i pamjaftueshëm i profesionalizmit të personelit administrativ dhe politizimit të shërbimeve administrative;
- 25 Hapësira për parimet administrativo-teknike, ekspertizën dhe profesionalizmin ishin të kufizuara;
- 26 Vlerat demokratike politike u shtypën, ndërkohë që ligji u konsiderua si instrument i thjeshtë i politikës;
- 27 Mungesa e koordinimit ishte kompensuar nga, ad hoc e ndërhyrjeve politike arbitrare;

- 28 Sistemi politik administrativ ishte i mbyllur dhe i burokratizuar, i mbushur me një klimë që pengonte transparencën në qeverisjen e vendit;
- 29 Ligji i parë sistematik ku administrata publike është rregulluar në shtetin kroat ka qenë ligji “Për Sistemin e Administratës Shtetërore” i vitit 1993. Ai ka përcaktuar rolin e funksionin e ministrive, të institucioneve administrative e shtetërore, departamentet administrative të qarkut, si edhe të organeve të administratës shtetërore.


Kjo fazë e motivimit nga ana e BE-së ka qenë e dukshme në të dy vendet për të sjellë ndryshimet në të gjitha nivelet e sistemit administrativ territorial, nga niveli i modelit ndërkombëtar në atë kombëtar. Megjithatë, procedura e emërimit për pozitat udhëheqëse në organet administrative ka qenë vetëm një pjesë e politizimit të administratës publike, politizim që ka dekurajuar punën profesionale të nëpunësve civilë të paanshëm politikisht dhe të mirëarsimuar. [Kopric,2003:13]. Një qasje nga lart-poshtë, pa iniciativën e nëpunësve civilë në të gjitha nivelet, nuk mund të jetë një forcë e vërtetë lëvizëse e modernizimit administrativ.

Faza e tretë e procesit të evropianizimit kroat është shoqëruar nga legjislatura, e cila filloi të harmonizojë dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale më shumë se tre vjet pas ratifikimit të saj. Kushtetuta ka transferuar përgjegjësinë për një pjesë të rëndësishme të çështjeve publike tek njësitë lokale dhe rajonale.

Ky proces i evropianizimit, për të zbatuar standardet e BE-së, u karakterizua nga konsolidimi i demokracisë dhe i decentralizimit të vendit. Kroacia e ka arritur këtë sfidë përmes zbatimit të kapaciteteve profesionale e administrative dhe sot ka shanset e hyrjes në administratën e hapësirës evropiane.

Në të kundërt nga Kroacia, rruga shqiptare drejt evropianizimit, në fazën e implementimit të BE-së është ende e gjatë, si pasojë e problematikave të ndryshme të institucioneve, të cilat ende janë të shoqëruara nga korrupsioni dhe nga mungesa e stafit të përzgjedhur pa meritokraci.

Edhe pse Shqipëria ka filluar të zbatojë statusin e ri për shërbimin civil për rekrutimin, ende mbetet rrugë e gjatë për Shqipërinë, për të përballuar sfidat dhe t’u bërë pjesë e hapësirës administrative të BE-së. Qasja lart-poshtë e evropianizimit dhe qasja horizontale ka ndikuar tek të dy vendet për të transferuar procesin e tyre të politikave, nga vend kandidat drejt vendit anëtar. Kjo skemë krahasuese është përpjekur për ta ilustruar atë që është shtjelluar më sipër:



Skema e mësipërme paraqet ndikimin që kanë kushtëzimet evropiane për përmirësimin e kapaciteteve shtetndërtuese, në mënyrë që të arrijnë qasjen horizontale për përmirësimin institucional të shteteve që aspirojnë apo që janë pjesë e BE-së.

Kroacia, ka ndjekur modelin e qasjes horizontale, me qëllim për të bërë ndarjen midis politikës dhe administrimit, ndarjes së shërbimit civil dhe punonjësve.

Qasja horizontale ka pasur për qëllim se si shërbimi civil duhet të përmirësohet, duke pasur parasysh disa nene brenda ligjit të statusit të shërbimit civil, sikurse ka qenë skema, orët e punës, pagesat, honoraret etj.

Duke parë se si është e krijuar administrata midis dy shteteve, kostatojmë se ajo është formuar më shumë midis origjinës politike të qeveritarëve të saj, sesa ka qenë e bazuar në kriteret e profesionalizmit.

Po të shikojmë analizën e bërë, edhe në kapitujt e mësipërm, kostatojmë se Kroacia, këtë prioritet e ka ndryshuar ndërmjet tërheqjes së individëve të mirarsimuar në Evropën Perëndimore, duke krijuar kapacitetet e duhura, për krijimin e mundësive dhe të hapësirave të nevojshme që këta të diplomuar në universitete dhe shkolla të larta në Evropë, SHBA etj. të riktheheshin në vendin e tyre të origjinës dhe për t'iu bashkuar punonjësve të administratës publike të vendit të tyre.

Në Shqipëri, nga intervistat me stafet e ekspertëve në institucionet e administratës publike, është theksuar se niveli i profesionalizmit është ende i dobët dhe përzgjedhja e punonjësve të niveleve të ndryshme të administratës publike ende kryhet nëpërmjet nepotizmit dhe militantëve politikë, dukuri që ka ndikuar në rezultate të dobëta për funksionimin cilësor e produktiv të administratës publike.

Sistemi i rekrutimit të Kroacisë është gjithashtu i decentralizuar në masë të madhe. Njoftimet për punë, të përgatitura dhe të lëshuara nga institucioni i rekrutimit janë të reklamuar në faqen e internetit të Ministrisë së Administratës Publike.

Komitetet, të paktën tre persona duhet të jenë të përfshirë e ku një përfaqësues duhet të jetë nga Ministria e Administrimit. Të gjithë kandidatët duhet të merren në provim të veçantë dhe të përgjithshëm, e ndjekur, e shoqëruar nga një intervistë. Provimi është përgatitur dhe administruar nga institucioni i rekrutimit. Ministria e Administrimit nuk “vendos” mbi procesin dhe kështu nuk ka asnjë rol në sigurimin e standardeve të përbashkëta në institucionet.

Në fund të procesit, ministrat mund të zgjedhin nga një person nga listat e shpallura për kandidatët e suksesshëm. Pushteti mund të delegohet nga ministrat te sekretarët e shtetit dhe drejtorët, por rekrutimi i tyre është i hapur e pa ndikimin e pushtetit politik.

Në kudër të kësaj situate, Kroacia ka bërë ndryshimet e saj në lidhje me standardet e rekrutimit. Ajo ka përzgjedhur për intervistë, vetëm ata individë që janë të suksesshëm, kanë formim të kënaqshëm profesional. Ata duhej të kishin fituar me sukses provimin teorik e kjo tashmë është kthyer edhe mënyrë rekrutimi në institucionet publike në vendin tonë.

KAPITULLI VI

KONKLUSIONE:

Punimi shkencor, i pasqyruar në kapitujt e mësipërm, ka përfshirë rezultatet e pritshme, të arritura nëpërmjet literaturës teorike, studimore dhe nga intervistat e target grupeve të ndryshme, të cilat kanë qenë të lidhura me këndvështrimin mbi impaktin ndërkombëtar në procesin e integrimit evropian të vendit tonë.

Jemi të mendimit se kërkimi shkencor nuk do të ishte i plotë, në qoftë se objektivi i studimit dhe përgjigjet e pyetjeve kërkimore nuk do të merrnin përgjigje, pra për të arritur në konkluzione dhe në rekomandime mbi bazën e një punimi të thelluar shkencor.

Në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor, u mendua që punim të shtrihej edhe në rrafshin krahasimor, pra të realizonim krahasimin midis dy vendeve në procesin e integrimit evropian dhe për këtë zgjodhëm : Kroacinë, si një vend tashmë pjesë e Bashkimit Evropian, i afërt me dinamikën e zhvillimit të shoqërisë, të historisë politike e ekonomike me vendin tonë.

Krahasimi me Kroacinë na ka ndihmuar për të pasqyruar produktivitetin e evoluimit të procesit të integrimit evropian në të dy vendet, edhe si pjesë e Ballkanit Perëndimor.

Arsyet e zhvillimit të punimit doktoral në këto dimensione janë shumë dhe për këtë i jemi referuar aktorëve të shumtë të përfshirë në studim. Është evidente se në periudhën e gjatë kohore të shtrirjes së studimit, përkatësisht të intervistave me grupe të interesuara në procesin evropianizimit, ndrojtja për të dhënë përgjigje rreth pyetjeve, aq më tepër pas bashkëbisedimeve dhe sqarimeve të arsyeve është e tejkaluar.

Megjithatë, çdokush e kupton dhe besoj se e ka të qartë se studimet e bazuara në metoda të tilla krahasimore e intervistuese, përmbajnë nivel të vogël subjektivizmi në përcaktimet e tyre. Me qëllim për ta paraqitur punimin tonë sa më aktual, larg ndikimeve subjektive, kemi aplikuar edhe metodologjinë studimore, sasiore e cilësore, për të monitoruar e matur disa nga parametrat e reformave të realizuara në vendin tonë në procesin e integrimit evropian.

Në kapitullin e parë, duke përshkruar instrumentet e hulumtimit kemi theksuar se me rëndësi ka qenë studimi i bërë në institucionet shqiptare dhe ato ndërkombëtare. Kujdes dhe vëmendje të veçantë i është kushtuar për ta sjellë studimin sa më koherent me zhvillimet politiko-juridike, duke analizuar koncepte teorike, përjasjet që do ta ndihmonin Shtetin tonë në përmirësimin e procesit integruar dhe në rritjen e kapaciteve profesionale e institucionale.

Së pari, rezultatet e tezave teorike të studiuesve më relevantë mbi problematikën e shtetndërtimit kanë qenë sfidat që gjatë historikut të vet, shtetndërtimi në vendin tonë nuk ka qenë përballur për t'i realizuar këto teza.

Së dyti, vlerësimi i monitorimit të institucioneve publike na solli në vëmendje se kriteri i kushtëzimeve evropiane është ende një nga përparësitë për t'u implementuar nga Shteti Shqiptar. Përcaktimi i strategjisë së para anëtarësimit, e ka avancuar statusin e kriterit administrativ në hierarkinë e kriterëve të zgjerimit. Rëndësia e krijimit të strukturave të nevojshme institucionale ka qenë parakusht për zbatimin efektiv të normave e standardeve të organizmave ndërkombëtare.

Rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit të plotë, ka qenë e lidhur me suksesin e negociatave, si edhe me suksesin kompleks të qeverisjes, i cili përfshiu institucionet shqiptare drejt standardizimit ndërkombëtar. Anëtarësimi ka kërkuar reformimin ose rrëzimin e disa institucioneve eksistuese, si edhe krijimin e institucioneve të reja që në disa raste kanë qenë të domosdoshme. Reforma e institucioneve ekzistuese ka qenë dhe mbetet proces tepër i vështirë dhe i gjatë.

Ende edhe sot, sigurisht që shumë institucione vazhdojnë të trajnohen në disa sektorë, por disa sektorë të tjerë kanë përparuar, por mund të ndodhë që procesi të mos përparojë si rezultat i gabimeve të bëra gjatë viteve.

Në këtë studim, kemi pasqyruar punën kërkimore si metodë produktive e frytdhënëse e bashkëpunimit institucional kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e juridiko-politike. Kemi trajtuar, shtjelluar teoritë, analizat dhe studimet kërkimore që kanë treguar e tregojnë përparësitë e tyre në procesin e evropianizimit, por edhe problematikën që paraqiten gjatë aplikimit të kushtëzimeve ndërkombëtare në procesin integruar të vendit tonë.

Monografia është përpjekur të vërtetojë pikëpamjet e idetë e mia dhe të teoricienëve të tjerë të fushës së studimit, se ndërtimi i shtetit shqiptar, i impaktuar nga modelet ndërkombëtare është një nga qasjet dhe sfidat më aktuale për ndërtimin e kapaciteve institucionale shqiptare në nivel evropian.

Në këtë studim, ka qenë e rëndësishme të pasqyrohej një vështrim i përgjithshëm teorik, i cili më pas ka ardhur duke u detajuar drejt çështjeve kryesore të problemit, të mbështetur në literaturën historike të vendit dhe të huaj, si edhe në burimet e intervistave e të internetit.

Këndvështrimet e shumë studiuesve, të cilët kanë shtjelluar se që në zanafillën e krijimit të shtetit, ka rezultuar së bashku me to, edhe krijimi i organizatave ndërkombëtare. Ato kanë inkurajuar zhvillimin e aftësitë bashkëpunuese midis shteteve dhe efektet që ato mund të kenë te anëtarët e rinj kandidatë në strukturat ndërkombëtare, në aftësinë e mënyrës së organizimit, duke ndikuar tek shtetet ndërtimin e përbashkët të institucioneve të ndryshme.

Vështrimi teorik i këtij punimi, ka sjellë e ka përcjellë rëndësinë që kanë këto qasje teorike në përmirësimin Shtetit në Shqipëri, sukseset që kanë arritur këto teori me kontributin e tyre duke u zbatuar në shumë shtete që hasin në të njëjtat problematika e zhvillime bashkëkohore.

Punimi është përqendruar më shumë në rëndësinë që paraqet ndërtimi i institucioneve, rritja e kapaciteteve profesionale të administratës publike, krahasimi me procesin e integritet evopian në Kroaci dhe në Shqipëri, si dy vende me afërsi të shumta në zhvillimin e tyre historik, politik etj., por që rruga e tyre ka qasje të ndryshme ndaj Bashkimit Evropian.

Informacionit statistikor, i cili ka qenë punë përbërëse e përditshme e reformave dhe që ka pasur e ka rëndësi të madhe, sidomos nga këndvështrimi social, intelektual e moral i procesit, i është kushtuar interesim e vëmendje e veçantë.

Në funksion të analizës dhe të shtjellimit të analizës cilësore të reformave në institucionet e administratës publike në nivel qendror, janë trajtuar në mënyrë të qartë dhe të përmbledhur konkretisht :

- Zhvillimi historik i ndërtimit të institucioneve shqiptare nga rënia e komunizmit deri në sfidat aktuale të para-anëtarësimit evropian;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar;

- Karakteristikat e bashkëpunimit;
- Sfidat bashkëpunuese;
- Mënyrat e organizimit të punës midis fokus grupeve;
- Teknikat e ndjekura evropiane dhe shqiptare;
- Strukturimi i detyrave të brendshme;
- Roli i stafëve të institucioneve të ndryshme dhe përmirësimi i cilësisë së rekrutimit të tyre;
- Monitorimi i institucioneve të reja të modeluara nga eksperiencia e vendeve anëtare më të reja të Bashkimit Evropian;
- Faktorë të tjerë të rëndësishëm, pa njohjen e të cilëve nuk mund të arrihej zbardhja e problematikës, në produktivitetin drejt mirëfunksionimit të institucioneve në Republikën e Shqipërisë.

Për të ofruar mënyrën e aplikimit sa më efektiv të bashkëpunimit midis institucioneve të Shtetit Shqiptar e atyre ndërkombëtare, kemi trajtuar edhe teknikën e diskutimit me përfaqësues të rëndësishëm, pjesë e procesit integruar evropian të Shqipërisë.

Kemi realizuar takime për të parë fokusin e vërshimit të shpejtë të ideve brainstorming, stimulimin dhe diskutimin për zgjidhjen e problemit si element i rëndësishëm për reflektimin dhe për rritjen e elitave intelektuale përfshirëse, të cilat kanë qenë aktive në bashkëpunim, si edhe teknika të tjera bashkëkohore, tashmë të njohura nga shoqëria jonë si “survey monkey” etj.

Shumë studiues, kanë konstatuar se asnjëherë nuk duhet ta mbivlerësojmë dhe të mendojmë se kjo është forma definitive për të arritur procesin shtetndërtues, nëpërmjet këtyre kushtëzimeve evropiane. Kjo rrugë e ndjekur, jemi të mendimit se është një nga mënyrat më efikase, më produktive, e cila e kombinuar me disa forma të tjera të brendshme nga Shteti Shqiptar, ka rezultuar se ka qenë më pozitive.

Në bazë të shtjellimeve teorike dhe analizave të rezultateve kemi arritur në disa përfundime të dobishme që kanë ndihmuar për zbardhjen e mangësive, por edhe për përparësitë që kanë ndikuar në zbatimin cilësor të implementimit të reformave dhe përfitimin që mund të modelonim nga shtetet e tjera, si nga Kroacia e konkretisht:

1. Rëndësia e qasjeve teorike të studiuesve për shtetndërtimet e suksesshme, ka sjellë krijimin e kapaciteteve të mira drejt implementimit të reformave. Analizat teorike kanë vërtetuar se grupet që duhet të përfshiheshin në këto procese janë tregues i lëvizjes popullore, intelektuale dhe akademike që, pas 25 vjetësh, kanë preferuar të bëheshin palë e procesit dhe të pranoheshin nga përfaqësuesit e qeverisë si palë partnere në zbatimin e suksesshëm të procesit.
2. Sensibilizimit të shoqërisë i kemi dhënë rëndësinë e nevojshme, për të kuptuar vlerat që kanë organizatat ndërkombëtare për të përmirësuar elementët e demokracisë së mirë e duke u dhënë mundësinë teknikave të duhura për të konsoliduar demokracinë shiptare.
3. Në disa kapituj, pasqyrimi i situatës politike, sociale, ekonomike e intelektuale ka lënë “shije” jo të kënaqshme, sepse janë parashtruar disa nga reformat mbi procesin e demokratizimit të vendit, të cilat janë njohur si mangësi dominuese të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë edhe në hapësirën ndërkombëtare. Nga vëzhgimi që kemi bërë, për të arritur demokraci të mirë, jemi të mendimit se ajo ka qenë dhe është e lidhur me modelin që ofrohet dhe me elementët që duhet të plotësojnë institucionet e ndryshme të vendit tonë. Për këto, kemi konkluduar se shtyllat ndërtuese janë :
 - a. Përgjegjëshmëria;
 - b. Transparenca;
 - c. Pjesëmarrja;
 - d. Konkurrueshmëria.
4. Kjo ka qenë arsyeja se përse ende këto dimensione janë lënë në harresë si mekanizma evropianë suksesi për procesin e përmirësimit të institucioneve tona.
5. Nën vizojmë se koncepti i demokracisë së mirë ka qendruar e qëndron në mbështetjen e institucioneve demokratike dhe në besimin se këto institucione janë sigurimet e vetme për lirinë e barazinë. Ka qenë i përhapur në çdo nivel social nga elitat e vendit, por rezultatet tona janë bazuar në realizimin e këtyre dimensioneve dhe në nivelin e demokracisë në institucionet tona të cenuara, çka ishte proces i pakonsoliduar.

6. Në punimin tonë kemi theksuar se të realizosh demokraci të mirë shpesh duhet nënkuptuar që të shohësh për mënyra të ndryshme, kur rregulli ligjor ka qenë i shtrembëruar, llogaridhënia e anashkaluar.
7. Procesi i integritit evropian të vendit ka qenë e është i lidhur edhe me momentin e pjesëmarrjes qytetare që mos të qëndrojnë indiferentë, mos të ndjehen më të kërcënuar, por të përballen me qeverinë e papërgjegjshme dhe jo të ndershme, kur realizmi i reformave nëpërmjet kushtëzimeve ndërkombëtare ka qendruar si sfida më e madhe për sensibilizimin e qytetarëve shqiptarë dhe ata si aktorët kryesorë të këtij procesi nuk kanë qenë pjesë përfshirëse për 25- vjet.
8. Gjithashtu, studimi ka identifikuar përkushtimin që kanë institucionet ndërkombëtare për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme institucionale, në mënyrë që Shteti Shqiptar të jetë aktor i rëndësishëm në hapësirën e administratës evropiane.
9. Në kuadër të reformave që e kanë karakterizuar politikën evropiane, mekanizmat impaktues që ajo është përpjekur të realizojë në vendin tonë janë të shumta, sepse vetë institucionet ndërkombëtare nuk kanë modele statike, por eksperiencia modelesh nga shtetet që kanë shpalosur të njëjtat problematika.
10. Një nga qasjet evropiane që është përpjekur të drejtojë vendin është qasja horizontale, si koordinim suksesi midis bashkëpunimit qeveritar dhe ndërinstitutional. Ajo ka qenë mbështetur në rezultatet për efikasitetin e modelit impaktues të organizmave ndërkombëtare, të cilat operojnë për rritjen e kapaciteteve shtetndërtuese shqiptare e po e drejtojnë vendin nga një qasjeje vertikale, drejt asaj horizontale.
11. Efektet e përdorimit të teknikave të BE-së për realizimin e një qeverisje të mirë shqiptare kanë qendruar pikërisht te mekanizmat direkte dhe indirekte institucionale.
12. Modeli evropian nëpërmjet mekanizmave të saj direkte ka qenë përqendruar pikërisht në kushtëzimet e ka dalë me konkluzione konkrete se përse arsyet e reformave institucionale në vendin tonë janë vlerësuar me indikatorët e vlerësimit pozitiv dhe negativ.

13. Në kuadër të rezultateve BE-ja ka qenë e detyruar të vendosë mekanizma indirekte për mënyrën e implementimit efektiv të reformave. Modeli i qeverisjes së mirë dhe mekanizmat evropianizuese për vendet kandidate janë realizuar kryesisht nëpërmjet kushtëzimit.
14. Veprimtaritë kryesore të BE-së janë bazuar në vendosjen e kushteve për anëtarësim, si edhe monitorimin e progresit të kandidatëve në përputhje me rrethanat. Modeli i qeverisjes së mirë dhe mekanizmat evropianizuese për vendet kandidate janë realizuar kryesisht nëpërmjet kushtëzimeve, në funksion të arritjes së një elite politike dhe përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.
15. Punimi ka pasqyruar rritjen e elitave në procesin vendimmarrës. Vendimmarrja e tyre nuk qëndron vetëm në nivel institucional, por edhe nëpërmjet sensibilizimit mediatik. Socializimi i qytetarëve si mekanizëm suksesi, ka bërë të mundur që këto reforma të shkojnë përpara.
16. Rëndësia e procesit integruar ka qendruar pikërisht në gjetjen e urave bashkëpunuese midis të gjitha palëve të interesuara në këtë proces. Shqipëria ka bërë rrugëtim të gjatë e progresiv në kuadër të evropianizimit.
17. Përmirësimet dhe reformat e ndërmarra, si edhe përfitimi i marrjes së statutit të vendit kandidat, sfidë që ka krijuar kushtet për të thelluar procesin e reformave.
18. Nga vëzhgimet tona sistematike, mbi ecurinë e procesit integruar si edhe nga progres raportet e Komisionit Evropian mbi zhvillimet aktuale kemi konstatuar evidentimin se rruga drejt Evropës është shumë e vështirë dhe niveli i kushtëzimeve ndërkombëtare ka qenë gjithmonë më i lartë e i “ashpër”.
19. Aspektet themelore ku kanë dalë konkluzionet e këtij punimi shkencor kanë qendruar tek rëndësia që ka përshatja e administratës publike shqiptare me atë të vendeve anëtare. Prandaj elementi i përballjes me zgjerimin e BE-së, sfidë kjo edhe e vetë politikës së re evropiane, e cila sot vjen me një strategji të re, sikurse është “Procesi i Berlinit” për vendet e Ballkanit

Perëndimor. Ai i ka vënë institucionet shqiptare me përballjen e përshtatjes me normat evropiane.

